

854-32

N 48

BIBLIOTEKA E RINISË



NË RRUGËN E HEROIZMIT

854-32
N°49

NË RRUGËN E HEROIZMIT

(Për moshën e mesme e të rritur shkollore)

40149 SHTEPIA
BIBLIOTEKËS

2865-

SHTEPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

Kur përmëndim këtë emën, na del përpara një ushtar i thjeshtë me trup mesatar, me dy sy të gjallë e të qeshun, i veshun me shije. Këndeje ne mund të nxjerrim se Hekurani ishte një ushtar i rregullt. Dhe jo vetëm i rregullt. Ai ishte edhe i gëzueshëm. Kjo vërehej në sytë e tij të zez e të shndritëshëm. Të lente përshtypjen e atyne njerëzve që janë shumë të kënaqun nga jeta. Vështirësitë nuk i përkulin këta njerëz, përkundrazi i bajnë ma të fortë e të qeshun.

Ka në botë njerëz që gjejnë kënaqësi kur u shërbejnë të tjerëve. Këtë nuk e bajnë kurrsesi pse u pëlqen të jenë të nënshtruem ndaj tyne. Përkundrazi Hekurani e kryente urdhnin, se e dinte që urdhni i komandantit asht urdhni i eprorit, asht urdhni i Partisë. Pra urdhni i komandantit asht i drejtë dhe duhet zbatue patjetër. Për ma tepër Hekurani kryente edhe punë, që nuk bahen me urdhna. Ai u vinte vazhdimisht në ndihmë shokëve të vet, të cilët nuk kishin të drejtë ta urdhnonin, mbasi edhe ata vetë ishin ushtarë të thjeshtë, si ai.

Hekurani ishte një ushtar, që ndjente krenari në kryemjen e detyrës dhe në ndihmën që u jepte shokëve. Të tillë tipe zakonisht duhen dhe simpatizohen nga të gjithë. Ai nuk ndryshonte nga të tjerët, nuk binte në sy dhe nuk bante, si të thuesh, mrekullina. Ai ishte baras me të tjerët. Ishte nga ata

ushtarë, që, po të pyesish shokët e tij apo eprorët, të përgjigjen: «Ah po, e njohim. Ishte djalë i mirë, i mrekullueshëm!»

Ushtar Hekurani lindi në prag të fitoreve të mëdha. Edhe shokët e tij ushtarë po atëhere lindën. Por dikush lindi në qytet, dikush në katund e ndonji në malësi. Hekuranit i ra të lindë në katundin Tozhar të lokalitetit të Terpanit. Pra, lindi në mal, lindi malësor si i ati dhe të parët e tij. Ai lindi në një kohë të çuditëshme, sa të egër dhe të vështirë, aq të bukur dhe heroike, lindi në prag të fitores ma të lavdishme të pullit tonë.

Si i gjithë Skrapari, edhe katundi Tozhar mori pjesë krejtësisht në Luftën Nacional-Çlirimtare. Luftime të rrepta u zhvilluen rreth e qark. Luftime shumë t'ashpra u banë edhe mbrenda në katund. Pati përpjekje grykë më grykë, bajonetë më bajonetë dhe jo vetëm një herë. Këto gjana ngjishnin gjatë operacioneve ditë për ditë, muej me radhë. Partizanët e Skraparit luftonin me tërbim e këto luftime banë që i gjithë Tozhari të digjej nga gjermanët e tradhëtarët. Ndër shtëpitë e katundit u dogj edhe shtëpia e Hekuranit. Ajo ngeli skelet, vetëm me mure të thata dhe dritare pa kapakë. Ndër përshtypjet e para të foshnjërisë Hekurani pat edhe shtëpinë e djegun, një shtëpi të shëmtueme e pa çati.

Hekuran Zenuni, i biri i Aliut dhe i Haxhiresë, lindi, pra, në prill të vitit 1944. N'operacionin e qershorit, edhe foshnja, si i tanë katundi, mori pyjet për të shpëtue nga furia e tërbueme e nazistëve dhe ballistëve. Pra, pagëzimi i parë i tij qe lufta. Dhe atmosfera e luftës i la të parat përshtypje. Për shem-

bull, lodrat e para të tij qenë fishekët e mauzerit, rripat dhe mbeturina të ndryshme armësh. Fjalët: partizan, gjerman, ballist, sulm, etj. qenë fjalët e para që mësoi nga goja e të mëdhenjve. Posa nisi hapat e para, mësoi të merrte një shkop e ta bante si pushkë. Me ate ai vriste armiqtë imagjinarë...

... Si kundër gjermanëve imagjinarë ashtu edhe kundër ballistëve, Hekurani ushqente një urrejtje të thellë fëminore. Urrejtja asht një armë e veçantë e të voglit. Ai e di se s'asht i zoti të luftojë, por ai ka zotësi t'imagjinojë. Në raste të tilla fëmija vete në një qoshe dhe gjithë urrejtjen e tij e kthen n'imagjinatë...

Urrejtja u rrit bashkë me Hekuranin. Dhe këto urrejtje e shtonin tregimet e babës, nanës dhe t'afërmve. Bisedat rreth luftës, rreth heroizmave ishin të ditës pse ishin ende të freskëta. Dhe episodet rreth luftimeve nuk kishin kurrë mbarim.

Sa bukuri kishte tek ato tregime! Sa heroizma kishin tregue partizanët gjatë luftës! Si nuk kishte pasë fatin edhe Hekurani t'ishte i madh n'atë kohë dhe të luftonte krah për krah me partizanët!

Me çlirimin e vendit katundi ra në qetësi. Tokat filluen të punohen përsëri. Njerëzia filluen të shërojnë plagët e mëdha, që kishin marrë nga lufta. Tashti puna kishte një kuptim tjetër, të ri. Bujqit e dikurshëm tashti po punonin tokat e tyre, të cilat i fituen me luftë.

Mbas çlirimit edhe baba i Hekuranit, xha Aliu, u ba me tokë të vetën. Kjo gja suell një përmirësim të dukshëm n'ekonominë e tij. Tashti katundarët e

dinin se e gëzonin vetë frytin e punës. Tokën ata e kishin dëshirue gjithmonë. Në fëmininë e parë Hekurani dëgjonte se si toka që punonte baba kishte qenë e agajt ballist. Dhe ky agaj i mirrte katundarit një pjesë të mirë të frytit të punës. Kjo i dukej e çuditëshme dhe e urrejtëshme. Ai dëgjonte edhe për sjelljet e egra të bejlerëve dhe t'agallarëve.

Tozhari asht vend malor me kodrina të veshuna me pyje e gjelbërim. Si një katund malor, ai ka ujna të rrëmbyeshëm, toka të varuna dhe parcela të rrethueme me gardhiqe e ledhe. Lagjet e Tozharit janë të vendosura nëpër kodra, larg njena tjetrës. Duhet disa orë të mira dhe kambë të forta për ta shetitë të gjithë Tozharin.

Natyrë e këtij vendi të ndjell krenari dhe burri. Atje përtej ngrihet madhnisht mali i Tomorrit, i cili të duket sikur u ban roje të gjitha katundeve përreth. Male të shikon syni kudo që të vërtitesh. Bile harron se edhe ti vetë je majë malit. Kjo natyrë sikur të fton të bisedosh për heroizma, për përpjekje dhe akte trimnie.

Në këtë ambient u rrit edhe Hekurani. U rrit në vorfni dhe katundin e tij zu ta dashunojë që kur nisi ta njohë.

Sa bukuri kishin mbramjet dimnore kur mblihdeshin njerëzit e shtëpisë dhe të lagjes së bashku e kalonin një pjesë të natës tue bisedue mbi ngjarjet e ditës. Mbramje të tilla zakonisht lenë një vrage të thellë sidomos në shpirtin e të vegjëleve. Hekurani i vogël ndigjonte nga goja e të mëdhenjve përralla të ndryshme, trimëni partizane, kangë heroike dhe shprehje të bukura e plot kuptim të gjuhës sonë. Atij i pëlqenin shumë, sidomos tregimet mbi luftën.

Xhaja i tij i tregonte bukur ngjarjet partizane. Ai kishte qenë vetë partizan dhe kishte marrë pjesë kushedi në sa beteja.

. . . Hekurani pat ndigjue shumë tregime, por një tregim i xhajës i kishte ngelë vazhdimisht si gozhdë në tru. Sa herë, kur gjindej vetëm, e rikujtonte të gjithë ngjarjen. Kishte dëshirë t'ua tregonte edhe fëmijëve, shokëve të vet.

Fëminia e Hekuranit nuk ka ndonji gja të veçantë. Ajo kaloi ashtu si edhe e të gjithë fëmijëve malësorë. E vetmja gja që e dallonte fëmininë e Hekuranit ishte shkolla. Të vegjlit e dikurshëm nuk kishin pasë shkollë. Shkolla atëhere quhej diçka si luks, që nuk mund ta kishin fëmijët e malësorëve. Tashti Hekurani, bashkë me kalamajtë e tjerë, binte nëpër balta, kalonte urën e prishun dhe, nëpër kodra e shtigje, gjurmonte të mbërinte shkollën atje afër Tërpanit.

Në shkollë veç shkrimit e këndimit mësoheshin edhe shumë përralla e histori të bukra. Edhe atje Hekurani ndigjonte se si kishin luftue partizanët për të zbutë anmikun nga Shqipëria. Tregoheshin bile edhe vendet ku ishin zhvillue luftimet. Ato vende nuk ishin larg. Tek ato vende Hekurani me shokë kishin kullotë delet dhe kishin lodrue kushedi sa herë. E pra mësuesi tregonte se aty ishin zhvillue luftime t'ëgra. «Populli me gra e fëmijë muerën pyllin, — thoshte mësuesi. — Në pyll, majë malit, fshatarët jetuen së bashku me kafshët e egra.»

Hekuranit atëherë i binte në mend se, siç i kishte tregue nanë Haxhireja, edhe ai kishte qenë atje si foshnjë e porsalindun.

Fryma e luftës nuk i ndahej Hekuranit ngado

që shkonte. Edhe lodrat, sado të thjeshta, kishin karakter luftarak. «Partizanët» luftonin kundër «gjermanëve». Gjermanët ishin anmiq imagjinarë, mbasi asnjë nga fëmijët nuk donte të bahej anmik nazist ose edhe ballist.

Vitet e shkollës fillore qenë vite të bukura, plot ngjarje fëminore, që i mbetën kujtim gjithë jetën. Kështu ishin, për shembull, shetitjet, takimet me fëmijët e shkollave të tjera, garat në mes të klasave, puna vullnetare dhe festat. Të mëdhejtë n'ato kohë shkonin vullnetarë nëpër hekurudha e aksione të tjera. Kur ktheheshin prej andej, tregonin për punën e madhe që zhvillohej në të gjithë vendin tonë. Tregonin për hekurudhën Durrës-Elbasan, Tiranë-Durrës, për fabrikat e para dhe për kombinatin e madh të bezes afër Tiranës.

Megjithëse Tozhari ishte larg, ushtima e ndërtimeve shkonte deri atje, shkonte deri te veshët e Hekuranit të vogël. Në mënyrë të pandërgjegjshme ai e ndjente se jetonte në një kohë revolucionari ku çdo gja e vjetër përmysej dhe çdo gja e re ndërtohej.

Hekurani nuk e kuptonte dot çfarë ishte kombinati i bezes. I kishin thanë se ai prodhon beze dhe pëlhura të bukura. Për këtë ai e donte shumë këtë kombinat edhe pse nuk kish idenë se si mund t'ishte. Ishin të shumtë atëhere ata që çuditëshin kur shikonin rininë që shkonte vullnetarisht të punonte për ndërtimin e kombinatit të ri.

Hekurani, si të gjithë moshatarët e tij, u rrit bashkë me pushtetin, me hallet, luftat dhe përpjekjet e pushtetit. Anmiku përpiqej me të gjitha mënyrat të prishte qetësinë e vendit, të ndalonte rit-

min e ndërtimeve, të mbillte mosbesim në popull dhe të fuste panik me anë të terrorit. Pra, krahas ndërtimeve, bahej një luftë e vazhdueshme dhe e egër për çfarosjen e bandave të ngeluna maleve dhe të diversantëve, që imperializmi hidhte herë mbas here tek ne. Përsëri si partizanët binin shokë të rinj në fushën e nderit tue krye heroizma kundër diversantëve. E këto heroizma shkonin gojë në gojë nëpër katund. Shkonin edhe në vesh të Hekuranit, i cili e shtonte gjithnji urrejtjen kundër anmikut.

Edhe në Tozhar filloi të flitej për nevojën e ngritjes së kooperativës. Kjo ishte gjithnji një ngjarje e re. Atij i vinte mirë që do të punonte së bashku me të gjithë shokët. Vetë fryma revolucionare me të cilën po rritej, e kërkonte një gjë të tillë. Në kolektivitet njeriu mund t'i ndihmonte ma tepër tjetrit, dhe jeta bahej ma e bukur, ma e gjallë. Tashiti ai e kishte krye shkollën fillore dhe fare mirë mund të bahej bari i kooperativës së re.

Kur u ngrit kooperativa, Hekurani, siç e kishte dëshirën, u emnue çoban. Që në fëmininë e njomë, ai kishte fitue një dashuni të veçantë për bagëtinë. Të vjetrit, kur e shikonin si kujdesej për delet, thonin: «Ky djalë do të bahet një çoban me vlerë». Dhe kryesia e kooperativës e kuptoi shpejt se Hekurani ishte me të vërtetë shumë i dobishëm në sektorin ku e kishin caktue. Bagëtime ai nuk u shmangej për asnjë ças, pyeste të vjetrit për kullotat, për sëmundjet dhe për detyrat që i delnin gjatë lindjeve. Mbrenda një kohe të shkurtën ai u ba një çoban me përvojë të duhun. Hekurani u ruhej shumë aksidenteve që kur i pat thye kambën një dem dhe dinte si t'u printe kafshëve.

Për meritat e tij të veçanta Hekurani u pranue n'organizatën e rinisë. Kjo ndodhi më 19 qershor 1962. Këtë datë Hekurani e mbante mend mirë, se për te kishte qenë një datë, që i kujtonte ngjarjen ma të randësishme të jetës së tij. Ai i mbante mend të gjithë të rinjtë, të gjithë shokët e tij të kooperativës që folën atë natë për te. Aty ai e pa veten si në pasqyrë dhe u gëzue shumë që të tjerët kishin një mendim shumë të mirë për të. Tek flisnin për meritat e tij, ai gati sa s'ngrihej e të thoshte se nuk ishte i tillë siç po e banin. Se mund të bante shumë ma tepër. Për shembull, nuk po interesohej të mësonte dhe të ngrihej nga ana kulturele. Kishte ngelë vetëm me ato katër klasë të shkreta. Vërtet ishte çoban, por edhe si bari duhej të kishte shkollë. Veç kësaj nuk luftonte sa duhet kundër disa të metave që shikonte në fshat dhe në kooperativë. Sikur stepej të kritikonte, sikur do t'i thoshin: «U bane ti të na shesish mend!» Dhe Hekurani nuk donte kurrsesi të dukej mendjemadh në katundin e tij.

Por edhe të metat duheshin luftue. Kështu thoshte Partia. Dhe Hekurani e kishte ndigjue Partinë. Ai kishte kritikue me forcë shumë të meta të kooperativës, pa marrë parasysh kush ishte fajtuer. Tashti ai priste t'i thoshin se ishte rrëfye pak mendjemadh. Jo vetëm nuk i thanë ashtu, por përkundrazi e lavduen guximin e tij. Hekurani u pranue me gëzim n'organizatën e rinisë. Ai u betue se do t'ishte një pjestar i denjë i kësaj organizate.

N'organizatën e rinisë Hekurani pa për së afërmi se çfarë detyrash i shtroheshin rinisë përpara. Megjithëse ai ishte një blegtor i thjeshtë i maleve të Skraparit, për te interesohej dikush. Interesohej

organizata e rinisë, e cila ngrinte zanin me forcë në mbledhjet e kooperativës. Rinia, si kudo, i vinte shpatullat punës për ngritjen e nivelit të jetesës në katund, për ndryshimin e zakonit të ndryshkun dhe të jetesës së prapambetun. Të rinjtë e Tozharit nuk dinin, nuk kishin shkollë të naltë, por ata ishin të pastër, bujarë dhe trima si baballarët e tyre, që banë luftën. Ata nuk njihnin djallëzi. Ishin të sigurtë dhe të dashtun. Nuk duronin t'i përçmonte kush, se nuk kishin shkollë dhe i donin me gjithë shpirt ata që silleshin të barabartë me ta.

Duheshin pjekë krahët e rinisë. Dhe këta krahë u poqën ngadalë bashkë me kohën. Vetë ngritja e kooperativës, puna së bashku, puna për ndërtimin e shkollës së re në Tozhar dhe hovi revolucionar i rinisë banë të përparojë edhe katundi i humbun atje në malet e Skraparit. Dashë e padashë ai eci me hapat e tij përpara. E tillë qe gjendja kur Hekuranin e thirrën të kryente shërbimin ushtarak.

Hekurani e priti me krenari thirrjen n'ushtri. I përcjellun nga prindët dhe shokët e fshatit, Hekurani u nis ushtar. Që në ditët e para, çdo gja u paraqit ndryshe përpara syve të tij. Ushtria iu çfaq me romantikën e saj të veçantë.

Hekuranin e çuen në repartin 4554, në një vend buzë kufinit. Atje ai shkoi bashkë me mjaft shokë moshatarë të tij. E këta shokë ishin nga skajet më të ndryshme t'atdheut. Hekurani kishte ndigjue për Gjinokastrën, Shkodrën, Kukësin e Peshkopinë, por tashti ai rrinte me shokë që ishin po nga këto kra-hina. Ata në bisedat e ndryshme tregonin për fushat e malet e tyre, tregonin për zakonet e ngjarjet e ndryshme të vendit të tyre. I ndigjonte që këndonin

dryshe. Bile ata të Peshkopisë dhe të Kukësit i binin një vegle me dy tela, që quhej çifteli dhe këndonin malësorçe. Ishte me të vërtetë një kënaqësi e madhe me i ndigjue. Po kështu tregonin ngjarje interesante dhe këndonin në mënyrën e tyre edhe ata të Sarandës, të Krujës, t'Elbasanit dhe të Gjinokastërës. Për çudi, të gjithë tregonin se baballarët e tyre kishin vujtë dikur nën bejlerët e agallarët, si ata të Tozharit. Tregonin se në vendet e tyre ishte zhvilluar luftë e rreptë kundër fashistëve dhe tradhtarëve ballistë ose zogistë. Tregonin për miniera, për qytete të reja, për kombinatë e kooperativa. Tregonin e tregonin... E sa për luftën, tregonte edhe Hekurani. Bile ndjente edhe një lloj krenarie që vendi i tij, Skrapari, kishte luftuar aq burrnisht.

Për Hekuranin të gjithë shokët ishin të mirë. E pra asnjëri s'i ngjante tjetrit. Secili ishte një botë në vete. Në sjellje, në shoqni ishin pothuaj si vëllazën. Për këta shokë Hekurani ishte gati të linte kryet.

Oficerët ishin njisoj si prind dhe si shokë njëherit. As nuk e kishte menduar Hekurani se eprorët e tij do të silleshin kaq shoqnisht me te! Në mësim, n'ushtrime, në lojë, në roje të kufinit e kudo, eprori i dukej shok, mbrojtës, mësues dhe vëlla. Për të tillë eprorë, si Hekurani ashtu dhe të gjithë shokët e tjerë, ishin gati të flijonin jetën.

N'ushtrinë tonë reparti asht një familje e vetme, një shtëpi e të gjithë antarëve. Pra hallet e repartit nuk janë vetëm të komandantit dhe t'eprorëve të tjerë. Ato janë halle për të gjithë, pra edhe për ushtarët. Për shembull, del nevoja të rregullohet një vendbanim ma i përshtatshëm për ushtarët. Ai i vjetri nuk i plotëson konditat dhe ka nisë të ba-

het i papërshtatshëm. Pra duhet ndërtue një kazer-
më e re. E në ndërtim punon njësoj si ushtari, si ofi-
ceri. Kështu ndodh që ushtari e udhëzon oficerin si
ta bajë murin, mbasi asht murator i specializuem.
Një punë e tillë të çon mallin e një familjeje, që ka
nisë të ndërtojë një shtëpi të re. Në te punojnë të
gjithë pjestarët e familjes me gaz dhe kangë në gojë.

Detyra e repartit asht të rrejë kufinin, të gjur-
mojë anmiqtë, shkelës të kufinit. Këtë detyrë ush-
tarët e dinë shumë mirë. Dinë ta thonë edhe në gju-
më dhe për te kanë dhanë shembuj të shkëlqyeshëm.
Ai që ka provue të shkelë kufinin tonë, e ka pague
shtrejtë.

Ushtria asht një detyrë, të cilën duhet ta kryejë
me nder çdo antar i Republikës popullore të Shqi-
pnisë. E kjo detyrë nuk asht aq e lehtë. Ushtria jonë
mbron fitoret tona, për të cilat ranë me mija bij
t'atdheut.

Fitoret i përkasin popullit. Ushtria i përket po-
pullit. Ajo lindi nga gjini i popullit pa zyra rekru-
timi, pa datlindje e kontroll mjekësuer. Në te u pra-
nuen pa dallim të dy sekset. U pranuen të rinj,
burra, gra, pleq dhe kalamaj. Të gjithë
këta banë ushtrinë tonë që e lindi lufta. Ne nuk
them kot edhe sot se ushtri e popull janë një ose i
gjithë populli asht ushtar. Kështu ka qenë dhe kë-
shtu do të jetë kur e kërkon nevoja e atdheut.

Do të marr si shembull katundin ku kryen
shërbimin Hekurani. Le ta quejmë këtë Tejmal. Aty
reparti bani ndërtesat e reja; në te punuen ushtarët,
por punoi edhe populli. Në të vërtetë, katundarët e
Tejmalit i quejnë si të vetat ato ndërtesa.

Ata punojnë në kooperativë, po në të vërtetë
janë edhe ushtarë. Fjalën «ushtarë» nuk e them në

kuptim letrar dhe të përgjithshëm. Jo, ata janë me të vërtetë ushtarë. Me t'i thirrë atdheu, ata shkojnë menjherë në vendin që u cakton komanda, dhe andej nuk shkulen pa urdhën. Pra, ata janë kooperativistë dhe njiherit edhe rojtarë të kufinit. Por si rojtarë nuk janë vetëm katundarët. Kufinin e riejnë edhe kalamajtë. Nuk janë të paka rastet, që kalamajtë kanë zanë shkelës të kufinit ose anmiq t'ardhun nga jashtë për të krye akte sabotimi. Këte punë e bajnë të gjithë. Kushdo që shikon një njeri të dyshimtë në katund shkon e lajmon komandën.

Veç kësaj, në mes të repartit dhe të katundarëve ka një vëllazni të vërtetë. Kur vjen filmi në kooperativë, ate e shikojnë edhe ushtarët. Si oficerat, ashtu edhe ushtarët shkojnë në raste gëzimi ose idhnimi në familjet e tyne. Furra e kooperativës furnizon me bukë edhe repartin. I del nevoja kooperativës për vjeljen e duhanit, për ndërtimin e ndonjë rruge, i shkon ndihmë edhe reparti.

Të gjitha këto tregojnë lidhjen e fortë të popullit tonë me ushtrinë. Katundarët i njohin me emën ushtarët dhe u ndihmojnë kur kanë nevojë.

Nji ambient i tillë ushtarak nisi ta kalitë ndryshe edhe ushtar Hekuranin. Ato që ne mund t'i quejmë sakrifica, atij nuk i dukeshin si të tilla. Edhe në Tozhar ai ngrihej herët për të lëshue bagëtitë. Atje bile nuk ushqehej me regull dhe aqë mirë sa këtu. Atje nuk kishte kaq shumë shokë. E sa për shi e borë ai s'donte t'ja dinte. Sa herë e kishte zanë shiu e bora malit me bagëti!

Dalngadalë, shokët e repartit iu banë vëllazën të vërtetë. I donte me shpirt. I vinte shumë keq kur shokët banin gabime dhe kritikoheshin në mbledhjet

e rinisë. Edhe ai vetë u kritikue një herë se arma e tij u gjend pak me ndryshk. Doemos kritika, edhe pse e drejtë, iu duk shumë e hidhun. Por ai pat burrninë të ngrihet dhe të thotë:

— Shokë, kritika që më bëtë është e drejtë. Unë, në t'ardhmen, do të tregohem më i vëmëndshëm në ruejtjen e armës!

Dhe Hekurani e mbajti fjalën.

Ja si e shikon Hekurani jetën në repart nga një letër që i dërgon shtëpisë.

«Me detyrë ushtarake e káloj shumë mirë. Merak mos kini fare për mua, se këtu kam shumë vëllezër, që shkojmë si në shtëpi, bile shkuar edhe shtëpisë».

Hekurani e kishte kuptue mirë randësinë që kishte edukimi politik.

Edhe pse vetëm me katër klasë, ai e kuptonte se, pa qenë i kjartë për të gjitha problemet politike, nuk mund të drejtohesh si duhet në jetën ushtarake, nuk mund të drejtosh një punë sado të vogël, qoftë r'ushtri, qoftë edhe në jetën civile.

Janë kuptimplote fjalët e tija të foluna në një mbledhje rinie me datën 8 tetor, 1963. Ai shprehet pikërisht kështu:

— Edukimi politik me frymën e vijës së Partisë është kryesorja për ne, ushtarët e popullit; prandaj duhet që të studjojmë vazhdimisht. Unë fjalën e Partisë, porositë e saj, do t'i bëj gjithmonë realitet.

Në një mbledhje tjetër ai kish thanë në lidhje me ruejtjen e traditave të repartit:

— Ne, shokët e rinj, duhet të mobilizohemi e të tregohemi të aftë për detyrën tonë. Shokët e

2865 40140

vjetër të nënrepartit tonë e kanë mbushur dhomën kulturale — arsimore plot me flamurë. Prandaj ne, me punën tonë të palodhur, me rezultate të mira, do t'i mbajmë këta flamurë dhe do t'i shpiem edhe më tutje sukseset tona!

Zgjedha këto dy-tri thanie të Hekuranit për të tregue se si ushtria nisi ta kalitë bariun e thjeshtë të maleve të Skraparit.

Ushtarët herë mbas here shkruenin letra në familje. Nji punë të tillë bante edhe Hekurani. Doemos, të merr malli për nanën, babën, vëllaun, nipat e vegjël; të merr malli për shokët, dhe kooperativën. Letra sikur të lidh me ta, të afron tek ata e të ban të jetosh me ta. Letrat e Hekuranit janë optimiste. Ai nuk di t'ankohet ndonjiherë. Ai jep vetëm porosi që të gjithë të punojnë mirë dhe të dalin faqebardhë. Kështu i shkruen edhe Syriajt, vëllaut të vet ushtar. Megjithëse asht ma i vogël, ai e porosit ate që të kryejë me nder detyrën dhe të kujtojë gjithnji se çfarë ka heqë dikur baba nën agallarët si bujk në tokë të huej. Ai i kujton anmikun dhe e porosit që ta urrejë me të gjitha forcat e shpirtit, siç e urren ai vetë!

Nji vit ndej Hekurani në Tejmal. Në gjashtëmujorin e dytë ate e caktuen të mësojë radion. Dhe Hekurani e mësoi për bukuri. Ke ai vend Hekurani la nji pjesë të shpirtit të tij: la shokët, komandantin, eprorët e mësuesit e tij, la katundin dhe atë vijë kufini, të cilën e mbrojti kushedi sa herë. Fati e suell në nji detyrë të re.

Me urdhën të komandës së repartit, Hekurani u transferue në nji objekt të ri ushtarak. Këtu jeta paraqitej krejt ndryshe nga ajo e kaluemja në Tej-

mal. Posti ushtarak ngrihej bri një shkambi të madh nalt një mali. Si vendbanim u caktue një shpellë në natyrë. Atje toger Stefani do të kryente një detyrë me randësi bashkë me tetë ushtarët e tij, ndër të cilët ishte edhe Hekuran Zenuni. Kundruei shkambit ishte edhe një shkrep tjetër madhështor. Te ky shkrep pillnin ujë. Një katundar gjeti një ditë atje katër klyshë ujë dhe i muer. Kur erdhi ulkonja dhe nuk i gjeti klyshët, u tërbue fare. Nga zemërimi u nis e, kudo që ndeshi në dele, pa marrë parasysh kurrfarë rreziku, u sul dhe i preu. Preu gjithashtu tri mushka që i hasi rrugës. Ulkonja u vra shumë larg.

Pra vendi ku u caktue me punë Hekurani me shokët e tij ishte i vështirë dhe mjaft larg qendrës ma t'afërme. Atje mund të sulmonin edhe ujë gjatë stinës së dimnit. Por detyra asht detyrë dhe duhet krye me nder.

Së pari, njësi i vogël u interesue për vendbanimin. Dera e madhe e zgavrës së shpellës u zu me mur. Iu hapën edhe dritare nga mund të shikonin një katund shumë të largët për karshi. Toka u sheshue dhe në të u vunë krevatet e fjetjes. Pra, mund të themi se u rregullue fjetorja. Vërtet që kjo ndodhej në shpellë dhe nën shkambin e madh, po ky vendbanim u quejt fjetore simbas rregullores. Dhe po ta shikosh, në krahasim me vendin e egër dhe të vështirë, kjo me të drejtë mund të quhej fjetore. Era nuk e merrte, shiu aty nuk pikonte. Veç kësaj, po mbrenda në shpellë u rregullue edhe një ndamje e vogël për kuzhinë dhe një tjetër për nevoja të tjera pune. U ba pra një gazermë e vogël shpelle. Kjo gazermë mund të jetë ndoshta ma e çudi-

tëshmjja në botë. Po ta shikonte anmiku mund të na shante, që kemi edhe gazerma të tilla për ushtarët tanë. Por për ne kjo nuk çon kandar. Njisiti i vogël me toger Stefanin kishin punë atje; dhe atje nuk mund të ndërtohej një gazermë ma e mirë se ajo, që e kish ndreqë vetë natyra dhe ushtarët ua përshatën për bukuri nevojave të tyre.

Aty fare afër kishin edhe vendin e punës. Puna që duhej krye ishte e vështirë dhe shpesh paraqiste edhe rrezik. Por ushtarët menjherë u ambientuen njëni me tjetrin dhe me natyrën e vendin e punës. Krijuen shoqni dhe formuen një familje të vetme. Mbas pune ashtu të lodhun, siç ishin ata e kalonin kohën me mësimë dhe argëtime. Shokët çuditeshin me Hekuranin sa i ngritun paraqitej, sidomos në punën politike. Për këtë, togeri i dha të kishte në patronazh shokun e tij Luigjin nga Zadrimea. Shpejt Luigji dhe Hekurani u banë shokë të ngushtë.

Ushtarët argëtoheshin aty në shpellën e tyre. Luenin shah, këndonin dhe u binin veglave. Toger Stefani ishte pothuej në një moshë me ta. Pra, në orët e lira, ai ishte një shok i tyre pa farë dallimi. Dalngadalë ai u ba shok edhe në punë, edhe në vështirësi. Por prapë toger Stefani dinte ta ruente autoritetin e detyrës. Ashtu edhe ushtarët e respektin dhe i zbatonin me përpikni urdhnat e tij. Ishin mësue tashma të dallonin urdhnin e shokun. Urdhni ishte urdhën e duhej zbatue patjetër, pavarësisht se këtë urdhën e jepte toger Stefani, shoku i tyre, që në mbramje i binte kitarës dhe këndonte në mes t'ushtarëve atje në shpellë.

Në grup ishin nda edhe përgjegjësitë. Hekurani muer përsipër kuzhinën. T'ishte kuzhinjer n'ate një-

sit, duhej t'ishe mjeshtë. Jo pse kërkoheshin gjell-na speciale, por pse ushqimet vinin poshtë nga qyteti dhe jo me rregull. Duhej të shkonte njeri t'i merrte. Dhe ushtari nuk mund të bante vetëm një rrugë aq të gjatë për të marrë ushqimet. Mandej ndodhte edhe moti i vështirë, binte borë, dilnin uj-qit dhe ushqimi mund të vonohej. Kështu, Hekurani kishte për detyrë të manovronte me ushqimet dhe njiherit t'i kënaqte të gjithë.

Në familjen e vogël prej nandë vetësh ishin të gjithë të mirë dhe të bindun. Ushtar Fadili diku e prishte nganjherë harmoninë dhe e shkelte disiplinën. Ai shkonte shpesh me detyrë në qytet. Kishte kambë dhe nuk ja përtonte. Por atje edhe ndodhte që vonohej. Nuk vinte në kohën e caktueme. Një natë, shokët ndejën dhe e pritën deri n'orën një mbas mesnate. Ishte një natë e ftohtë dimni. Të gjithë ishin rrjeshtue rreth shporetit dhe nuk binin të flinin pa shokun e tyre. Togër Stefani kishte vrejtë vetullat e nuk fliste. Heshtja e tij i vriste të gjithë.

— Do të ketë ndejë sonte në qytet, — thoshte ushtar Marashi. — E njoh unë Fadilin. I merr punët lehtë dhe nuk mendon sa telashe na shtie neve këtu.

Këtë ai e thoshte për t'ja largue mërzinë togerit. Atëherë Hekurani thirri:

— Nuk kemi pse të presim. Unë mendoj të shtërngohemi dhe të dalim ta kërkojmë. Duhet të mendojmë edhe të keqen. Atë mund ta kenë shqyer uj-qit rrugës. Pak kohë përpara ne i dëgjuam si ulurinin.

Togër Stefani ngriti kryet.

— Hekurani, ka të drejtë, — thirri. — Ne duhet ta kërkojmë shokun tonë.

Tek po baheshin gati të dilnin ushtar Fadili trokiti në derë. Bashkë me te hyni dhe gëzimi në familjen e vogël ushtarake. Të gjithëve u qeshi fytyra. I mvrejtnun ngeli vetëm toger Stefani. Ai kishte frikë mos ushtar Fadili ishte vonue në qytet ose ndokund tjetër dhe tashti vinte në këtë orë.

— Ku ishe? — e pyeti me seriozitetin e duhun togeri.

— Në qytet, shoku komandant.

— Kur u nise prej andej për t'ardhur këtu?

— Atëherë kur u nis maqina, n'orën katër.

— U prish maqina rrugës?

— Jo. Deri në Gozhdaj mbërrimë në rregull. Mandej mora rrugën në kambë.

— Kjo do të thotë se ti ke bërë dhietë kilometra rrugë për shtatë orë, — tha togeri tue e vërejtë në sy ushtarin. Ushtar Fadili ishte zbe në fytyrë dhe sikur tregonte shenja tronditjeje.

— Çfarë të ndodhi? Pse erdhe kaq vonë? — vazhdoi pyetjet togeri tue e zbutë tonin.

— Më dolën ujqit para — u përgjegj ushtar Fadili. — U detyrova të hypi në pemë dhe të rrij disa orë atje deri sa u larguen.

Ushtarët e muerën për gënjeshtër këtë.

Të nesërmen ke vendi që u tregoi Fadili ata panë me të vërtetë gjurmat e ujqëve në shtresën e hollë të borës.

— More, ti paske shpëtuar për qime, — i tha gjithë gëzim togeri.

Atëherë ushtar Fadili u tregoi fill e për pe si kishte ndodhë ngjarja atë natë me ujqit. Tregoi edhe për frikën që e kishte kapë, kur ujqit ishin përpjekë të vareshin në trung t'ahut që ta mbërrinin.

— Ti e kishe lehtë me ta, — bani shaka togeri.
— Ata nuk kishin armë tjetër veç dhëmbëve. Po sikur në vend t'ujqve të të dilte një bandë armike e armatosun mirë?

— Do të shtija kundër tyne, — iu përgjegj me krenari ushtar Fadili, — por nuk do të hypja në pemë. Do merrja pozicion dhe do luftoja deri në fishekun e fundit. E pse mos të luftoja? Derisa ata kërkojnë kokën time, pse mos ta kërkoj edhe unë të tynen dhe të shpëtoj timen?

Togeri qeshi përsëri. Idhnimi dhe inati i vjetër iu zhdukën nga fytyra.

Me ngjarje të tilla asht e mbushun plot jeta e njisimit të vogël atje në malet e largëta.

Togeri nxehet nganjherë se ushtarët s'punonin sa duhej. Kështu ndodhi edhe një ditë. Në mbramje njisiti i vogël u mblodh të nxirte përfundimet e punës. Kërkuen të gjenin shkaktarët e moskryemjes me sukses të zotimit. Po ku gjindej shkaktari? Të gjithë kishin faj. Kjo ndodhi se atë ditë ata banë shumë shaka atje në vendin e punës dhe, pa dashë, e vonuen kryemjen e detyrës. Tashti togeri e ndjeu veten keq para tyne. Ata i patën premtue se do të punonin pa përtim dhe do ta kryenin në kohën e duhur detyrën e caktueme.

Togeri bërtiti i zemruem. Hekuranit i erdhi ma keq se të gjithëve. Ai kujtoi se ishte shkaktar i kësaj që ndodhi, prandaj vendosi ta lajë fajin. Në të vërtetë ai qe ma pak fajtor se të gjithë. Fajin e kishte ushtar Fadili, që rrinte e bante shaka dhe i linte pa punë edhe të tjerët.

Hekurani u ngrit natën, shkoi ke vendi i punës. Në mëngjes, çdo gja ishte në rregull.

Ushtarët u çuditën. U çudit edhe toger Stefani. Ç'u ba gjithë ai piring me dhe që ndodhej para hyrjes? Mos i kishin ba sytë mbramë e i kritikoi pa asnji arësye ushtarët? As ai nuk dinte ç'të thoshte.

Por ushtarët e kuptuen mirë se kush mund ta kish ba këtë punë natën. Përveç Hekuranit, asnji tjetër nuk do të merrte mundimin të hiqte gjithë atë dhe. Ata e falënderuen me sy dhe në heshtje shokun e tyne, që i nxuer faqebardhë para togerit.

Dhe kjo gja nuk ndodhi vetëm një herë. Ke Hekurani shokët kishin një vëlla të vërtetë Nij vit plot, që jetuen së bashku në shpellën e vetmueme, shokët nuk mbajnë mend të jenë zanë, qoftë edhe një herë të vetme me Hekuranin. Me punë dhe sidomos me sjellje ai ja kish dalë të fitonte zemrat dhe respektin e shokëve. Dhe ky respekt rridhte vetëm nga thjeshtësia, nga drejtësia dhe nga mprehtësia e tij.

Janë të paharrueme ato net të kalueme n'atë vrimë shkrepit t'ujdisun si banesë atje në shkambin e madh.

Natën, nën dritën e kandilit, banorët e shpellës uleshin e bisedonin si vëllazën për të gjithë të kaluemen e jetës së tyne. Ushtar Shabani, një shok i ngushtë i Hekuranit, ishte martuëm. Të martuëm ishin edhe ushtar Luigji, reshter Shuku dhe ushtar Marashi. Ata flisnin edhe për punët e bukura të grave të tyne. Këndonin këngë, të cilat Hekurani i pëlqente për melodinë e tyne.

Kur biseda ndërpritej atje në shpellë, atëhere patjetër niste kanga, çiftelia ose kitara e toger Stefanit. Koncerti ishte i ndigjuem shpesh, por ai përsëritej. Megjithatë, të gjithë ndigjonin me dëshirë.

Kanga shpesh të dërgonte në katund: në ngjarjet e kalueme, në shoqinë e lanun atje. Nganjihërë kanga të kujtonte kohnat e bukura, stinët e ambla të verës dhe të pranverës. Të kujtonte familjen, prindët, vëllaznit dhe tufën e bagëtive. E kuitimet gjithnji të sjellin në mend të bukurën, poetiken. Pa dashë, të gërmon malli. Malli asht një ndjenjë e bukur, por na nxitë të kryejmë me dëshirë ate që na ka ngarkue atdheu. Në të tillë mënyrë e kuptonte Herkurani mallin atje në shpellën e gurit, dhe kjo ndjenjë fisnike e mësonte ate ta dojë ma tepër familjen, shtëpinë, katundin e tij dhe të gjithë atdheun.

Kështu kalonin ditët, kështu kalonin netët. Puna e ngarkueme nga komanda kryhej në rregull dhe n'afatin e caktuem. Njisiti i vogël, edhe pse i vetmuem, nuk e ndjente veten të shkëputun. Herëmbas here ate e vizitonin eprorë dhe shokë të ndryshëm t'ushtrisë. Veç kësaj njisiti njihej fare mirë me katundin aty afër. Bile katundarët i nihnin ushtarët e njisstit emën për emën. I dinin prej nga ishin dhe çfarë njerëzish kishin në familjet e tyne. Shumë herë ata u kishin ndihmue ushtarëve. E doemos, kur je larg shtëpisë, të bie nevoja edhe për një gjylpanë. Ushtarët me kohë u banë si një familje me ta. Kjo asht karakteristikë e ushtrisë sonë, të bahesh një me popullin.

Kështu, në mes të ushtarëve, nanave, baballarëve formohej një shoqni dhe miqsi e vërtetë. Në gosti dhe festa ata u ruenin diçka edhe ushtarëve, që rastësisht i kishin njohë. Por kjo miqësi i ka rranjët ma të thella. Ajo lindi gjatë luftës, kur fshatarët si prind shifnin dhe ruenin si fëmijët e tyne partizanët, që luftonin kundër pushtuesit fashist.

Atëhere ata patën nda të mirën dhe të keqen me fëmijët e tyne. Partizani n'atë kohë ishte shpresa dhe jeta e familjeve. Ndaj gjithëshka ruhej për partizanët, për shpëtimtarët. Ushtria lindi nga populli dhe i shërbeu atij deri në fitore. Kështu, figura e ushtarit u ba e dashun për popullin tonë. Ishte pikërisht kjo miqësi me popullin që ja lehtësonte mjaft shërbimin edhe njisitit të vogël atje në atë shpellë.

Stinët kaluen një nga një. Koha e lirimt po afrohej. Por para kësaj ngjarjeje po afronte një datë shumë e shënueme, festa e njizetvjetorit të çlirimit të atdheut. Këtë festë e priti me gëzim gjithë populli ynë. Tirana e festoi ate me madhështi. Edhe qytetet e tjera e festuen në mënyrën e tyne. E festuen ndërmarret, katundet, familjet. E festoi edhe njisiti i vogël atje ke shkambi i madh.

E këta ushtarë të thjeshtë e festuen në mënyrën e tyne. Kohë përpara Hekurani kishte mendue të kursente nga racioni i mishit, i patateve dhe i ushqimeve të tjera, në mënyrë që atë natë të kishin në sofër ushqim me bollëk dhe ta festonin si duhej.

Një ditë përpara, Hekurani skuqi patatet, rregulloi mishin dhe bani gati çdo gja. Togeri rregulloi edhe çeshtjen e rojës, në mënyrë që të gjithë të kishin mundësi të merrnin pjesë në gëzim dhe roja njiherit të bahej në rregull.

Festa filloi. Ishte një festë e veçantë, një festë pa mjete rahatllëku, pa fishekszjarre dhe pa drita neon. Megjithatë kjo qe një festë e dashun për ata pak ushtarë, që ishin në një pikë të largët, në roje t'atdheut.

Toger Stefani e ndjeu veten t'emocionuem. Ai duhej të ngrente dollinë i pari dhe t'u fliste ushta-

rëve të tij, të cilët ishin njiherit edhe shokët e tij.
— Shokë të mi! — tha togeri dhe korrigjoi: —
Shokë ushtarë!

Në të vërtetë ata qenë shokët e tij, shokë, të cilët nuk do t'i harrojnë deri sa të vdesë!

«Kam menduar me kohë çfarë duhet t'ju flas në këtë mbrëmje të madhe feste, — vazhdoi togeri. Për rëndësinë e saj, unë ju kam folur disa herë me radhë, prandaj s'po zgjatem. Ju tanimë e dini sa edhe unë rëndësinë e festës. Ju e dini mirë edhe detyrën që keni ndaj atdheut dhe popullit. Kjo është edhe arësyeja që ju dolët të dalluar, prandaj edhe në këtë pikë nuk do të ndalemi. T'ju flas për disiplinën? Më duket e tepërt. Ne kemi shkuar si shokë. Edhe urdhërat e mia ju i keni zbatuar me bindje. Për këtë ju falënderoj. Ju keni zbatuar një disiplinë të vetëdijëshme, gjë që më mbush me kërenari. Ju them një sekret. Më vjen keq nganjëherë që jam togeri i juaj e nuk jam ushtar i thjeshtë si ju.

«Shokë, ju së shpejti do të shkoni në shtëpitë tuaja. Do të filloni përsëri jetën e zakonëshme. Atje ju presin shokët, familja, kooperativa. Po largoheni nga jeta ushtarake, ku kaluat plot dy vjet. Ju uroj nga zemra t'i gjeni shëndoshë e mirë familjet. Sa për ju, e di se po shkoni shumë më mirë me shëndet se erdhët. Uroj të punoni mirë, të dilni faqebardhë dhe mos të keni halle në familje. Ata që janë të martuar, të shkojnë jetë të lumtur e pa telashe. Të pamartuarit, të gjejnë shogën e tyre të jetës dhe të kalojnë jetë të lumtur. Pikërisht për një jetë sa më të mirë punon sot i gjithë populli. Për të ruajtur jetën e qetë dhe të bukur vigjëlton sot e gjithë ushtria. Për këtë punuam ne dy vjet dhe

jemi gati të punojmë kurdoherë që e do nevoja e atdheut.

«Të rrojë Partia, që na bashkoi, na vëllazëroi dhe po na hap gjithnjë rrugë të reja përpara!»

Gotat u cakruen. Kur them gota, do të sillni në mend ca safa alumini, ndonji pagure ose ndonji gotë të madhe. Mos harroni se kjo festë bahej majë maleve, në një shpellë!

Dollitë u ngritën me radhë. Ushtarët folën për shakat e bame në këtë banesë interesante, për të metat e njëni tjetrit. Me fjalë të tjera, folën me karta të hapuna.

Edhe tek tregonin të metat e njëni tjetrit nuk fyheshin; përkundrazi, qeshnin me gjithë zemër. Afrimi i lirimit patjetër që kish sjellë një ndjenjë gëzimi ndër ta. Ishte ndjenja e të kryemit të detyrës. Jo vetëm kaq! Ishte ndjenja e të kryemit me nder të kësaj detyre. Prandaj edhe u ishte zgjidhë të gjithëve gjuha. Të gjithë flisnin, të gjithë banin shaka dhe mbramja po shkante për bukuri. Asnjherë ata nuk kishin kaluar një mbramje aq të bukur atje në banesën e tyre të gurtë.

Edhe Hekurani ngriti doli. Ai u uroi festën të gjithëve. I uroi për lirimin e tyre dhe t'i gjenin shëndosh e mirë njerëzit ke shtëpia. Ai që ndoshta i vetmi që u emocionue. E tha copë se i vinte keq që largohej nga ushtria, që largohej nga një shoqëri e tillë, kaq e dashun dhe kaq e fortë. Para shokëve muer zotim se, kur të kthehej në katund, do të punonte me forca të dyfishueme për ta ba kooperativën si shoqet e tjera. Ai tregoi se katundi asht i vorfën e se veç punës, ai ka nevojë edhe për njerëz me shkollë, që ta drejtojnë. Hekurani

u zotue që, po ta çonin në shkollë, do të mësonte në mënyrë që t'i vlente sa më mirë vendit të vet. Njiherit ai u zotue se do të ishte gati t'i shërbente ushtrisë kurdoherë që ajo ta kërkonte.

Mbas shakave, nisi kanga dhe çiftelia. U kënduen me radhë kangët partizane. Çiftelia u këndoi trimave të Luftës Nacional-Çlirimtare dhe dëshmorëve të vramë në luftë me diversantët. Ma vonë nisi edhe isoja e zakonëshme me ato notat e gjata dhe të shtrueme. Edhe kitara i këndoi të gjitha kangët që dinte. Kështu kaloi ajo festë e paharrueme.

Asht dita e ejte e datës katër dhetuer të vitit 1964. Pak dit i ndajnë ushtarët nga dita e lirit. Mueji i dhetuerit ka ardh me shi e me furtunë. Bora e parë asht dukë disa ditë përpara, atje përmbi shkrepin e madh. Rruga për në qytet kalon nëpër pyje, që gjinden majë malesh. Atje fryn erë e tërbueme. Andej nuk kalon njeri i gjallë dimnit. Prandej edhe ujçit e ndjejnë veten ma të lirë në atë anë. Gozhdaj i ka disa shtëpi e stane deri sipër. Por prapë shtëpitë e fundit të tij janë larg tri-katër kilometra nga vendi ku gjindet kazerma shpellë.

Ushtarët të gjithë po pregatiten për lirin. Duhet këpucë, duhen plaçka. Veç kësaj, dikujt do t'i duhet të shkojë edhe në qytet për të krye punët e njësitit. Asht e nevojëshme të tërhiqen disa ilaçe, të tërhiqet shtypi. Shokët kanë dërgue këpucët për t'i ndreqë, që t'i kenë gati kur të nisen për në shtëpitë e tyne. Edhe Hekurani i ka këpucët atje. Mbasi motit nuk i dihet Hekurani paraqitet vullne-

tarisht të shkojë në qytet dhe të tërheqë çdo gja që nevojitet. Këtë gja ai e ka ba edhe herë të tjera. Nuk i pëlqen atij që shokët të vuejnë dhe të kryejnë detyra të randa. Ato ka qejf t'i kryejë vetë. Toger Stefani e din këtë veti të Hekuranit. Ai nuk mendon t'ja prishë qejfin. Por, nga ana tjetër, Hekurani i duhet togerit edhe në punë. Doemos, njisiti ka punë me përgjegjësi. Jo kot i kanë zgjedhë këta djem në një detyrë kaq të vështirë dhe njihërit delikate.

Në fund të fundit, togeri e ngarkoi Hekuranin të shkante në qytet, të merrte ilaçet, shtypin, ushqimet dhe këpucët e shokëve dhe të kthehej patjetër të nesërmen deri n'orën pesë mbasadreke. Kjo detyrë iu dha Hekuranit si urdhën.

Dhe Hekurani u nis. Ai ishte i përpikët dhe togeri e kishte mendjen të fjetun në këtë anë.

Të nesërmen, moti u gdhi i keq. Frynte erë e tërbueme. Binte borë si pjalm, që të fshikte fytyrën kur të takonte. Poshtë maleve, e ndoshta edhe në qytet, binte shi. Por atje ke shkambi bora kish kchë që binte e dendun dhe me rrëmbim. Toger Stefani shikoi kohën nga dritarja dhe i erdh keq që i kishte dhanë urdhën të premë Hekuranit të kthehej atë ditë e nuk ish kujtue me i thanë se, po ta shikonte punën pisk, mund edhe të mos vinte deri sa të qetësohej moti.

Atë ditë ra borë pa pushue. Mbasdreke, moti u ba edhe ma i keq. Tufani fishkullonte për tmer. Ishte vështirë të nxirrje kryet jashtë banesës. Nga dritarja dukej qielli i nximë e malet përtej nuk qenë dukë gjithë ditën. Retë kishin mbulue gjithëshka. Nëpër një kohë të tillë njeriu nuk mund

t'udhëtojë kurrresi. Tashti merak u për fatin e Hekuranit ishte ba ma i madh, qoftë ke togeri, qoftë edhe ke ushtarët. Ora po afrohej edhe ai nuk po dukej. Të gjithë rrinin të heshtun dhe, me veshë të ngritun, pritnin të dëgjonin ndonji za dhe t'i shkonin në ndihmë menjherë. Por asnjeri i gjallë nuk bante za jashtë. Para se t'errej mirë, Luigji, të cilin Hekurani e kishte në patronazh, muer guxim dhe duel jashtë. U nis. Dësh të merrte rrugën deri ke kthesa në qafë të malit, mirëpo nuk mbërrini dot deri atje dhe u kthye.

— Asht e pamundun të shkosh ma përtej, — u tha shokëve kur u afrue ke zjarri. — Po të rrija edhe pak, pata me ngri së ftohti.

Ora kaloi dhe Hekurani nuk u paraqit.

— Asht e pamundun, që të ketë marrë rrugën nëpër këtë të ftohtë, — tha Shabani. — Patjetër do të ketë ndejtë ke kushurini i vet që ka në qytet deri sa të pushojë furtuna.

— Po t'isha unë, ashtu do të veproja, — tha ushtar Fadili, — por Hekuranit ja kam frikën.

Këto fjalë t'ushtar Fadilit e zemruen togerin.

Nata erdhi me të gjithë zyrtësinë e saj. Tashti, dashë e padashë, të gjithë u bindën se Hekuranin do ta kishin ndalue ata të komandës dhe nuk do ta kishin lanë me u nisë maleve në një stuhi të tillë. Kjo bindje vinte ma tepër nga halli. Në të vërtetë, togeri nuk mbylli sy gjithë natën.

Nata qe jashtëzakonisht e gjatë. Dita mezi zbardhi. Stuhia kishte pushue. Gjithë natën ra një borë e madhe, që kishte veshë në të bardha gjithëshka. Tashti as pemët, as kunorat e tyne nuk dukeshin ma. Gjithëshka dukej e bardhë. Shokët

që duelën nga banesa dhe kaluen disa metra nëpër borë nuk panë as gjurmë njeriu as gjurmë kafshe t'egër. Duket se edhe ujqit kishin zanë një skutë mali diku dhe nuk ishin dukë gjatë tërbimit të stuhisë. Dita kaloi me mërzi të madhe. Hekurani nuk erdh as në mbramje. Pra, tashti ai mund t'udhëtonte. Bile të gjithë u çuditën kur, në mbramje, ja behu ushtar Nikolin Mara nga qyteti, ku kishte qenë i shtruem në spital.

— E pe kund Hekuranin? — e pyetën shokët menjëherë.

— Unë isha në repart, — tha Nikolini, — por Hekuranin nuk e takova.

— Po si mbërrine deri këtu? — E pyeti togeri.

— Deri në Gozhdaj erdha me maqinë. Mandej, rrugën e bana në kambë.

— Mos pe gjurma kund rrugës?

— As gjurmë, askurrja. Vetëm në të dalë të katundit kam pa disa gjurmë ujqish.

Tashti dyshimi filloi t'i brejë. Mërzia u ba edhe ma e theksueme. Të gjithë rrinin pa za. Secili mendonte: «Ku do të jetë Hekurani?»

Përsëri në shpellë zunë të bisedojnë se ku mund t'ishte ai. Ushtarët dhe togeri e njihnin kushurin e Hekuranit në atë qytet të vogël. Sa herë që ai shkonte atje, do ta vizitonte patjetër shtëpinë e të afërmit të tij. Pra Hekurani mund të ndodhej atje. Por si ishte e mundun të rrinte kaq gjatë pa e vu në dijeni komandën? Dikush duhej të nisej patjetër në qytet.

U nis ushtar Marashi.

Në komandën e repartit në qytet i thanë se

ushtar Hekuran Zenuni ishte paisë me të gjitha gjanat e nevojshme dhe po atë ditë ishte nisë për-pjetë për te gazerma e shpellës. Dikush tregoi se e kishte pa kur kish hypë në makinë, e cila, udhë-tonte deri në Gozhdaj. Tregoi se kishte me vete një strajcë me ushqime, me gazeta dhe ilaçe. Veç këtyne, kishte edhe disa palë këpucë të mereme-tueme në qytet.

— Ne kemi ba shaka me të rrugës, — tha shoferi kur u pyet. — I thosha se do të martohej shpejt tashti që po lirohej. Ai skuqej.

— Nga shkuem, — vazhdoi shoferi, — binte borë me furtunë. Era sillte borën paralel me to-kën. Nuk shikoja dot as tre kilometra larg nga radiatori. Mezi e kapa katundin. Disa shokë, që ishin në makinë, i thanë Hekuranit të mos nisej ke shokët me këtë mot. Ke dyqani i katundit unë e luta të merrte një konjak, por nuk pranoi kurr-sesi. Ngriti kapotën mbi krye, u mbështuell mirë dhe u nisë nëpër stuhi.»

Kur ndigjonte këtë tregim kaq të hollësishëm të shoferit, Marashi zu të dridhej nga dëshpërimi. E njihte mirë Hekuranin. Sigurisht, ai do të kishte mbetë diku në borë ose do ta kishin shqye ujqit.

Marashi u kthye dhe u tregoi shokëve fill e për-pe se ç'kishte ndigjue për Hekuranin. Të gjithë u prenë në fytyrë. Çfarë duhet t'i kishte ngja He-kuranit?

Ajo që mbramja ma e randë, ma e mërzitësh-mja e të gjitha netëve të kalueme aty. Njeri nuk fliste, kurse Luigji qante në vetmi. Secili blunte me mend se ç'mund t'i kishte ndodhë shokut të ty-ne. Përpiqeshin të gjenin ndonji arësye dhe ta nxirr-

nin të gjallë Hekuranin e tyne. Por në këtë drejtim, tashti pak shpresë kishte mbetë. Posa u gdhi dita, ata duelën nga strofulli i tyne dhe u nisën ta kërkonin. Po ku ta kërkonin? As këte nuk e kishin mendue. Mali, pylli, i gjithë vendi ishte i mbuluem me borë. Dukeshin vetëm gjurma kafshësh t'egra, ndër të cilat edhe gjurma ujqish.

— Shikoni mos takoni ndonji copë këpuce ose ndonji copë rrobe, — tha togeri që printe përpara.

Kjo porosi e togerit i dridhtëroi të gjithë, megjithëse e kishin mendue një gja të tillë. Hekuranin mund ta kishin hangër ujqit. Zunë të kërkonin malin, të shkryejnë borën dhe donin me gjithë shpirt që mos të ndeshnin në shenja, të cilat do të dëshmonin për një vdekje tragjike të shokut të tyne. Për fat, edhe mali nuk u jepte kërkuesve asnjë shenjë të tillë.

— Shoku toger, — i thoshin ata komandantit të tyne, me një fije shprese në zemër. — Nuk gjindet asnjë shenjë e tij. Mundet që asht gjallë.

— Shenjat e tij mund ti' ketë mbuluar bora, — përgjigjej zyrtë togeri. — Unë për vete nuk besoj më se Hekurani jeton. —

Si iu suellën malit në të dyja anët e rrugës, si kërkuen andej e këndej, mbërrinë pothuej grumbull ke dyqani i fshatit Gozhdaj. Shitësi, një burrë i pjekun, me trup të gjatë dhe fytyrë serioze, i priti me dashamirësi. Ai i njihte të gjithë një nga një. Kujtoi se mos po niseshin për t'u lirue.

— Si more?! — thirri me të madhe kur i thanë se Hekurani nuk ishte paraqitë në detyrë që nga data katër dhetuer. — Paska mbaruar në mal i shkretë Hekuran! — Ofshani dhe sytë iu mbushën me lot.

— I shkreti Hekuran, — thirri përsëri dhe i ra me shuplakë ballit. — Ç'bëra unë që nuk e ndalova me zor. Po ku ndalej ai! — Lot të tjera i kaluen nëpër mollzat e vyshkuna të faqeve. Këto lot i tronditën luftëtarët e shkambit të madh.

— Çfarë djali që ishte! — vazhdoi shitësi.

— Mund të na tregosh ndonjë gjë për të? — e pyeti me dashamirësi togeri.

— E çfarë t'ju them? — shoku toger. — Ne të gjithë që ishim në dyqan e lutëm atë ditë të mos shkonte në njësit, se do të mbetesh rrugës ose do ta shqyenin egërsirat. Frynte një veri i tërbuar, binte një borë që të fshikullonte. Unë e kam shtëpinë këtu afër e mezi arrita të shkoj atë natë. Gati mbeta rrugës. Bile tek ecja, thosha me vete: «Po ti, o Hekuran, si u nise ashtu i vetëm majave të maleve në këtë natë skëterre!» Iu luta unë, iu lut shoferi dhe Xhezairi. Iu lutën të gjithë fshatarët. Po ku i mbushej mendja djalit të shkretë! «Kam urdhër», thoshte, «Dhe urdhëri duhet të zbatohet». «E zbaton nesër, — i thoshim ne. — «Ja, nesër në mëngjes do të pushojë stuhia. Ne bashkë me ty do të shkojmë dhe do t'i tregojmë togerit se si e kishe punën». «Nuk është e mundur, — përgjigjej ai. — Ushtari nuk ka nevojë për dëshmitarë. Unë jam ushtar dhe detyrën e kryej vetë». «Po ja, o Hekuran, — i thoshte Xhezari — tashti ne nuk kemi gjë të fshehtë njëri me tjetrin. Në fund të fundit të gjithë ushtarë jemi. Ti ke detyrë të çosh ushqimet, gazetatat dhe këto këpucë. Po a nuk bën t'i shpiesh nesër? Po fundi i fundit le të rrijnë ushtarët edhe një natë pa bukë se nuk bëhet gameti. Ne, si partizanë, kemi ndëjtur edhe

një javë pa vënë gjë në gojë, dhe, siç e shikon, sot jemi gjallë e shëndoshë». Hekurani nuk pranoi në asnjë mënyrë. Bile Xhezairi i shtini krahun dhe i tha: «E marr unë përsipër përgjegjësinë tënde. Flas unë me toger Stefanin». Por Hekurani iu përgjegj: «Ushtarët nuk janë fëmijë. Ata përgjigjen vetë për punët e tyre». I dhamë një konjak, që ta ngrohte, por nuk e pranoi. Na përshëndeti dhe u nis. Xhezairi kur e pa ashtu të krrusur për t'u mbrojtur nga era, i tha: «Ore Hekuran, nuk ma ha mendja se do të sosësh sonte, por kthehu më mirë».

Tashti u ba e qartë për të gjithë se Hekurani kishte mbarue rrugës; Hekuran nuk kishte ma! Po ku do të ishte trupi i tij? Lajmi i humbjes së Hekuranit u përhap si rrufeja në fshat.

— Ka humbë Hekurani!

Kjo fjalë fluturonte nëpër katund gojë më gojë dhe shtëpi më shtëpi. Të gjithëve u dhimbsej, si të ishte djali i tyne. Dhimbjen ata e tregonin tue marrë pjesë i madh e i vogël në kërkim. Në drekë, i gjithë katundi Gozhdaj kishte dalë me kërkue Hekuranin. Kërkonin brinjat, skutat. Largonin borën aty ku dyshonin. Por asnji shenjë e viktimës nuk dukej kund.

Komanda e qytetit u vu në dijeni menjherë. Hekurani kishte humbë. Kërkimet nuk jepnin asnji të dhanë që të vërtetonin se Hekuranin e kishin hangër ujqit.

Lajmi i humbjes së Hekuranit u hap edhe në katundet përreth. Atë e mori vesh edhe i gjithë qyteti. Ishte diçka e çuditëshme. Nji ushtar nisët e

nuk mbërrin në vendin e duhun! Kërkohet e nuk i gjindet as nam as nishan.

Të nesërmen, brigada e ushtrisë u nis të kërkonte shokun e vet. Këtë gja e panë katundarët dhe nuk ndejën duerkryq. Nga katundet përrreth dilnin me qindra burra e të rinj për të kërkue ushtarin e popullit, që kishte ngelë diku në borë.

U pyet përsëri shoferi dhe shitësi. U muer vesh se me Hekuranin atë natë ishin takue edhe disa të tjerë. Zeneli e kishte pa Hekuranin nga shtëpia e tij. Kalonte i krrusun dhe i mbështjellun në kapotën e tij tue luftue me erën për të ça përpara. Atëkohë Zeneli po ngrohej ke zjarri. Kur e pa se Hekurani kishte marrë rrugën për te shpella, e muer me mend se do ta kishte pisk. U ngrit dhe i duel para ta ndalonte. Hekurani e falënderoi për kujdesin, që po tregonte dhe i tha se kishte urdhën të paraqitej patjetër në kohën e caktueme në komandë.

— Unë do të zbatoj urdhërin, — thirri Hekurani. — Detyra është detyrë!

— Era të merrte frymën, — tregoi Zeneli. — Mezi merreshim vesh njëri me tjetrin. I fola me dashmirësi, e mora për krahu, por nuk qe e mundur t'i mbushja mëndjen. Atëhere e luta të vinte e të ngrohej pak dhe pastaj të nisej. Por as këtë nuk e pranoi.

— Nuk kam të ftohtë, — tha. — Tashti sa dola nga dyqani.

Mbi katund janë disa stane bagëtish. Atje e ka shtëpinë edhe Azisi. Ai atje mban familjen dhe bagëtitë. Azizi e pa Hekuranin tek po ngjitej me zor përpjetë.

— Ku po vete, o i zi? — tha me vete dhe nuk ja bani të gjatë; duel jashtë dhe i zuni rru-gën.

— Ore Hekuran, — i thirri. — Nuk e shikon çfarë moti është?

— Do të vete te shokët, — iu përgjegj Hekurani.

— Ktheu, bir, se po merr veten në qafë. Deri këtu erdhe si erdhe, por më tutje s'shkon dot. Rruga asht shumë e përpjetë dhe sa më lart të ngjitesh aq më e tmerëshme bëhet suferina. E shikon si nuk dëgjohen as ulurimat e ujqëve? Edhe ata do të kenë zënë ndonjë skutë në këtë mot. Kthehu te kasollja ime. Nesër do të shkojmë bashkë te toger Stefani.

— Detyra është detyrë, — iu përgjegj Hekurani. — Unë duhet të gjëndem patjetër te shokët sonte.

Azizi vërejti se Hekuranit kishin nisë me iu nxi buzët. Ai mbante shtërngue në dorë këpucët e shokëve, kurse në shpinë kishte një trastë të mbushun plot. Kishte mbulue kryet me kapotë dhe përpiquej të priste erën që ulërinte për tmer.

— Kthehu, Hekuran, kthehu bir, — i tha Azizi.

— Shpella nuk është larg, o Aziz, — iu përgjegj Hekurani. — Pothuaj se arrita.

— Ashtu është, — i tha Azizi. — Në një mot të mirë në shpellë arrin për një gjysëm ore, por në një kohë të tillë as burri më i fortë nuk çan dot përpara. Më dëgjo mua, që jam i këtyre anëve. Unë nuk flas kot. Bora të gënjen. E shikon si ka nisur të na hyjë i ftohti në trup? Kthehu! Kthehu, bir!

Por Hekurani nuk u kthye. U nis të kryente detyrën. Azizi foli me te një copë herë, u përpoq me të gjitha mënyrat ta bindte, por nuk qe e mundur.

U mësue se Hekurani kishte shkue deri nalt, atje ku ishin stanet e bagëtive. Prej andej duheshin edhe dy kilometra rrugë për të mbërri ke komanda e njisitit. Këto dy kilometra u kontrolluen vend për vend. Nuk u la skutë, bri, zgavër ahu pa u gjurmue. Kudo bora u kthye përmbys. Njerëzit shkuen edhe ma përtej. Mbërrinë deri pranë fshatit ma të afërt të shpellës. U kontrollue gjithë vendi. Por Hekurani nuk u gjet.

— Nesër do të kontrollojmë përsëri. Duhet ta gjejmë me çdo kusht — tha komandanti i repartit të qytetit.

Të nesermen, bashkë me ushtrinë u nisën edhe ata të degës së mbrendëshme dhe me qinda qytetarë. Me qinda ishin edhe ata që zbrisnin nga malet e larta ose ngjiteshin për t'u bashkue me shokët dhe për të kërkue Hekuranin.

Ky ushtar tashti ishte ba për të gjithë një enigëm, e cila duhej të zbërthej patjetër. Pleqtë, në mbramje, thoshin se të rinjtë nuk dijnë të kontrollojnë. Gjurmët e Hekuranit duhesh të gjindehshin patjetër. Ata tregonin përvojën e tyne në këtë rast, përvojë e grumbullueme gjatë shekujsh n'ato vende të vështira.

Malet u mbushën plot me kërkimtarë. Orë e gas pritej se mos po vjen dikah lajmi se u gjetën gjurmët e ushtarit të humbun. U gjurmuen shtigjet vend për vend. U tregue e gjithë përvoja e pleqve, por Hekurani nuk u gjet. Humbi pa lanë as ma të voglën shenjë.

Nji gjendje e tillë e rriti edhe ma tepër figurën e ushtarit të thjeshtë. Disave u vinte të thërrisinin:

— O Hekuran, dil, aman, e trego ku je!

Dhe kishin të drejtë. Ujqit ate nuk e kishin ngranë. Kjo kuptohej lehtë sepse ujqit do t'i hanin mishin, por rrobot do t'ja linin. E pra ku ishte atëherë? Ku e kishte gjetë atë vend aq të fshehtë sa mos ta gjinin afër dymijë kërkimtarë!

Familja e Hekuranit në Tozhar të Tërpanit u lajmue me takt se djali i saj ushtar Hekuran Zenuni, kishte humbë.

Por sado takt të përdoret, humbja asht diçka e randë dhe e çuditëshme. Çfarë do të thotë ka humbë? Pra, nuk asht vra tue mbrojtë kufinin, siç do të dëshironte t'i vinte lajmi xha Aliut. Nuk asht rrëzue në detyrë e sipër. Nji vdekje e tillë nuk asht e plotë. Me nji vdekje të tillë prindi nuk e ndjen krenarinë e dëshmorit.

Komanda i dërgonte ngushullimet familjes, por atyne ky lajm u erdhi ma i randë se vetë humbja e djalit. Ata po e prisnin Hekuranin e tyne. Nanën e kishte kapë nji mall i fortë për Hekuranin. T'i thuesh nanës në prak të lirit të tij nga ushtria, se djali yt ka humbë, nuk asht gja e vogël. Njeri mos e provoftë! Po baba? Xha Aliu kishte qenë gjithnji krenar për djemt e vet. Ai edhe si bujk kishte qëndrue kryenaltë para bejlerëve dhe agallarëve. Ai e kishte në gjak sedrën malësore.

Pra, ku kishte humbë djali i tij? Pse nuk e gjenin? Të paktën t'i sillnin kufomën dhe ta qante me ligje e zakon, siç e lyp nderi i shtëpisë.

Kërkime u banë përsëri. Bile fshatarëve u mbet zakon, që kur kalonin andej të shikonin ashtu kot se mos gjenin trupin e pajetë të ushtarit të humbun.

Hekurani kreu detyrën e ushtarit. Këtë detyrë, sigurisht, ai nuk e kreu të fitonte ndonji gradë dhe të bahej i dëgjuem. Rrugës, prej Gozhdajt dhe deri sipër ke stanet, atij nuk i shkoi asnjherë nëpër mend se do të dilnin dymijë vetë për të kërkue trupin e tij të pajetë.

Pra, detyra e tij qe e thjeshtë. Mirë, thoshte shitësi i dyqanit. Ai do t'u dërgonte shokëve bukë, kutia mishi, makarona etj., pra, ushqim trupor. Do t'u dërgonte libra e gazeta, ushqim mendor, dhe ilaçe për të shërue sëmundjet e për të pasë një trup të fortë e të gatshëm kur ta lypë nevoja e atdheut. Të gjitha këto ushqime mund të prisnin deri sa t'ulej murlani dhe të çelej moti.

Por Hekurani nuk mendonte kështu. Ai duhej të kryente detyrën. Ai ishte prototipi i ushtarit të thjeshtë t'ushtrisë popullore. Ai nuk e vinte në kandar detyrën për ta çmue sa vlen. Urdhëni për te nuk diskutohej, por zbatohej. Hekurani u sakrifikue për detyrën. Kjo asht heroika e madhe, që naltëson figurën e tij. Ai, pra, kur ishte i gatshëm të sakrifikohej për një urdhën, zbatimi i të cilit nuk kërkonte një përpikmëni aq të domosdoshme, për çdo urdhën tjetër ai do t'ishte dhjetëfish ma tepër i gatshëm. Për këtë figura e Hekuranit si ushtar i thjeshtë bahet gjithnjë ma madhështore përpara syve tonë.

Ushtar Hekurani u nis nga dyqani i Gozhdajt me bindjen e plotë se do të gjindej para orës pesë ke shpella. Atëherë, do ta ndjente veten të lehtësuem dhe krenar, që e kishte krye urdhënin e dhënë nga toger Stefani. Bora, tufani, ngrica për te ishin diçka të rastit që përpiqeshin ta pengonin në zbatimin e urdhënit. Por ai kishte vendosë t'u bante ballë këtyne vështirësive. Bile në fillim ai ndjente dhe një farë krenarie, që po i ipej rasti të luftonte kundër vështirësive të natyrës, siç kishin luftue dikur partizanët, për të cilët ai kishte ndigjue kushedi sa tregime. Pa dashë, i shkoi në mend tregimi i një ushtaraku për shokun e tij gjatë luftës. Ai tashti tue ça borën e shihte me sytë e shpirtit partizanin që ecte nëpër borë si ai për të arritë shokët e brigadës dhe për të lajmue për rrezikun që i kërcënohej gjithë fshatit. Pa dashë e unjisoj veten me partizanin e dikurshëm. Iu duk se ai po nisej të lajmonte për rrezikun e madh, që i kërcënohej pikërisht katundit të tij. Ky andrim i pëlqeu dhe ja shumfishoi guximin. I dukej se atje poshtë, diku në një qafë mali, po priste katundi Tozhar me gra dhe fëmijë t'i vinte në ndihmë brigada dhe të shpëtonte nga thonjtë e anmiqve. I dukej se atje ishin edhe nipat e tij të vegjël, të cilët i donte aq shumë. Kur e ndaluen me radhë Zeneli dhe ma nalt Azizi, Hekurani po kënaqej me imagjinatën e tij. Ata sikur po e pengonin dhe nuk po e linin të kryente misionin për të cilin ishte ngarkue. Ai i falënderoi me gjithë zemër të dy. I kënaqej shpirti kur shikonte se sa shumë interesoheshin të tjerët për te. Kjo gja e bante me besue se ndaj të tjerëve, qofshin këta edhe katundarë të thjeshtë, siç ishte ai, e kish-

te krye detyrën si duhet. Për shembull, Azizi, ishte blegtor. Edhe Hekurani i tillë ishte. Ai kishte shkue disa herë në shtëpi t'Azizit. E njihte me të parë e me të mbramë. Edhe Azizi e dinte se çfarë njerëzish kishte ke shtëpia Hekurani. Bile edhe u kishte ba të fala me letër.

Të gjitha këto i kujtonte Hekurani kur luftonte me veriun tue iu afrue shkambit të madh. Ai dalngadalë po harronte se të ftohtit po ja pushtonte pa u kujtue gjymtyrët. E ndjente se po mërdhifte. Por kjo i dukej diçka e durueshme dhe e përkohëshme, që mund të largohej fare lehtë. Po të lëvizte ma tepër, të ftohtit mund të shmangej.

Por sa ma nalt që ngjitej aq ma e randë bahej era. Tashti ai nuk shikonte ma përtej se këpucët e tij. Era e detyronte të krrusej në mënyrë që mos t'i binte pjalmi fytyrës. Megjithëse majë malesh, dita e shkurtë e dhetuerit nisi të soset pothuej para kohe. Nata po vinte me një të ftohtë të madh. Hekurani luftonte me të gjitha fuqitë e tij për të çu përpjetë. Bora nisi të trashet. Çizmet tashti hvnin thellë, dhe kjo e vështirësoi edhe ma tepër rrugën. Por ja që detyra duhej krye. Ai, tashti, n'imagjinatën e tij, po arrinte brigadën, po i tregonte asaj se anmiku rrezikonte katundin e tij, rrezikonte të dashunit e tij, babën, nanën, vëllaun me nipat e vegjël. Ky vegim i ipte zemër. E, pra, po e shikonte kjartë se fuqitë po e linin.

Ngriti kryet dhe pa se i ishte afrue mjaft vendit. Për të dalë në qafë duheshin edhe njiqin metra. Prej andej duhej të kaloje majtas, rranzë malit. Mbas pesëdhjetë metrash ishte shpella. Aty ishte edhe dritarja. Posa të mbërrinte afër, do të thërriste.



Shokët do të dilnin menjherë dhe do ta ndihmonin. Së paku do t'i mirrin këpucët, të cilat tashti i randonin në dorën e ngrime. Hekurani nuk i hapte ma gishtat. E kapi një frikë se do t'i ngelnin kështu gjithë jetën.

Po ja, që urdhëni, detyra duhej krye. Edhe njëqind metrat u kaluen. Hekurani nuk e pa mirë se a u kaluen me të vërtetë. Ai nuk shikonte ma përpara, bile i dukej se nuk po shihte ma si duhet. Ngriti kryet e pa një ah të thatë, shenjë që tregonte se duhej mbajtë nga e majta rranzë malit. Uli kryet e muer majtas. Mirëpo nuk bani shumë hapa, kur pa se nuk ishte në rrugën e duhun. Vrau mendjen dhe u kujtue që ishin dy aha. Kthesa duhej të bahej ke i pari, kurse ai e kishte ba ke i dyti. Kjo kthesë të çonte poshtë në humnerë. Për t'u kthye përsëri nga kishte ardhë, nuk i dukej e mundun, mbasi rruga bahej e gjatë dhe ai kishte nevojë të ngutëshme për pushim. Edhe sytë sikur i mbylleshin. Bora tashti i ngjante si një jorgan i bardhë, sipër të cilit mund të pushonte fare mirë. Por jo, mendjen e kishte top. Nuk duhej të gabonte e të flinte! Duhej krye detyra! Ai ishte ushtar i popullit. Bora, vështirësitë, nuk i kishin përkulë kurrë partizanët. Pra as Hekuranin nuk duhej ta përkulnin kurrë!

Mendoj se do t'ishte ma mirë, që t'i binte thikë rrugës dhe të dilte te ahu i parë. Aqëhere mund ta merrte kthesën pa frikë. Kështu do të përfitonte shumë rrugë. Mandej, vendi ishte i mbuluem me borë dhe dukej gjithkund njisoj. Bora fshihte nën te gropat, hendeqet dhe rrëpinat. Hekurani u nis t'i binte rrugës mes për mes. Si zakonisht, pa një herë nga do t'ja mbante, uli kryet, krrusi trupin dhe muer përpjetë malit.

Lodhja, gjumi, që sjell të ftohtit dhe ngrica, që i kish hy në trup e banin t'ecte si automat. E shihte se ishte gati të binte. Gjumi po e lodhte shumë. Pa mbërri ke një urë i shkanë kambët në një kanal të thellë nja dy metra. Tronditja që ndjeu kur ra ja humbi ndjenjat në fillim. Mandej, sikur e zu gjumi. Aty, në mes të borës, pa i lëshue nga dora këpucët e shokëve, ashtu i mbështetun në kambë për mur të kanalit, ai pa andrrat e fundit të jetës së tij. Ai i mbërrini shokët, të cilët po e prisnin me ankth. Ata u gëzuen shumë kur e panë dhe i banë zjarr pranë shporetit. Bile toger Stefani sikur i tha:

— More Hekuran, po pse s'ndëjte edhe një natë kur e pe këtë mot kaq të keq?

Hekurani me krenari iu përgjeggj:

— Kisha urdhër, shoku toger! Atje po pret i gjithë fshati. Janë në rrezik! I shpëtoni! Unë e kreuva detyrën. Kryejeni edhe ju! E shpëtoni popullin!

Dhe Hekurani u fik siç fik era dritën e kandilit. Ai mbeti aty si roje besnike e maleve tona, ngeli aty si simbol detyre për t'u tregue ushtarëve të rinj, për t'u tregue breznive t'ardhëshme se si duhet krye detyra ushtarake ndaj atdheut.

Ky ushtar i thjeshtë, i urtë, i dashun dhe i bindun, ky ushtar i zakonshëm, që kishte ba kushedi sa shaka me shokë aty ke shpella e gurit, bani edhe sakrificën ma të naltë dha jetën për të zbatue detyrën.

Bora, që ra gjith natën, e mbuloi statujën e lavdisë. Tashti Hekurani nuk mund të gjindej.

Ditët kaluen njena mbas tjetrës. Në shpellën e gurit mbaruen lodrat e shakat. Netët, që ki-

shin mbetë, kaluen të heshtuna. E si mund t'ishin të gëzueshëm shokët tashti pa Hekuranin? Për te fliste çdo skutë e shpellës, për te fliste çdo vegël pune, çdo enë kuzhine!

Erdhi dita e lirimit. Erdhi dita që ushtarët t'i thoshin lamtumirë njeni tjetrit, të largohe-shin nga togeri i tyne. Por një plagë në zemër u randonte të gjithëve. Po shkonin pa u përshëndetë me Hekuranin. Mos tjetër, ta përshëndetshin për së vdekuni. U vinte keq që po e linin shokun e tyne diku atyne maleve dhe po shkonin në shtëpitë e tyne. Shokët u ndanë me vaj në buzë, u ndanë me zemër të plagosun dhe u larguen si ata zogjtë e vjeshtës. Muerën kujtime ma të bukura dhe ma të dhimbëshme për shokun dhe me ato kujtime u nisën. Në kazer-mën-shpellë erdhën të tjerë për të vazhdue punën.

Të rinjtë që erdhën e ndigjuen ngjarjen e Hekuranit. U vunë në dijeni për të gjitha sa ishin ba për ta gjetë këtë ushtar, që kishte humbë në borë. Togerit u foli atyne për vetijat e Hekuranit; për sakrificat, që bante ai për shokët dhe për rregullin që mbante kudo që ishte.

Edhe pse nuk e njihnin, ushtarët e rinj ndjenin një respekt dhe dashuni për këtë ushtar, që vdiq në krye të detyrës.

Humbjen e Hekuranit e ndjenin të gjithë në shtëpi. Nana e çante në heshtje. Vëllau i madh, mësuesi, rrinte i vërenjtun. Edhe në mësim i fanitej figura e vëllaut të vogël, Hekuranit. Por, këtë humbje e ndjente ma tepër baba plak.

E për çfarë nuk i punonte mendja? Shpesh

i shkonte nëpër mend se një grup diversantësh e kishte ndeshë në rrugë atyne maleve dhe, si e kishte zanë në befasi, e kishte marrë me vete. Moti kishte qenë shumë i përshtatshëm për punë të tilla.

E për xha Alinë njimijë herë ma mirë vdekja se një rrojtje ke anmiqtë, qoftë edhe kundër vullnetit të tij.

Shtëpia e Hekuranit kishte ra në heshtje të plotë. Njerëzit flisnin me za t'ulët, sikur nuk donin të zgjonin kujtimin e Hekuranit të humbun.

Edhe katundarët përreth Tozharit, oë e dinin tashma çështjen e tij, çuditëshin për këtë humbje. Kurse ata, që udhëtonin nga shkrepit i madh për të dalë në Gozhdaj, shikonin mos ndeshnin në ndonji gjurmë të ushtarit, që aq shumë e kishin dashun.

Dhe që pikërisht ky kujdes i katundarëve, që e zbuloi Hekuranin kur nisën të frynin ernat e ngrohta të pranverës dhe kur fushave poshtë nisën të çelin lulet e para.

Një ditë, një katundarë tek kalonte afër vendit të ngjarjes, vuni re se mushka mbi të cilën kishte hypë, u tremb. Në fillim nuk e kuptoi pse u tremb mushka. Kërceu nga kafsha dhe u përpoq ta tërhiqte prej kapistalli. Përsëri kafsha nuk lëvizti. Pa dashë, atij i shkuen sytë ke diçka e zezë si kapotë ushtarake e dalun përmbi borë. Për një çast edhe ai u tremb. Kur e pa mirë, ajo i ngjau si forma e një njeriu të zhytun përgjysëm në borë. «Mos është Hekurani?» — mendoi me vete. E la mushkën dhe iu afrue. Zemra i rrahu me hov. Para tij ishte Hekurani. Pallton e kishte të ngritun mbi krye. Në dorë mbante disa palë këpucë

ushtarake të meremetueme. Trupi, nga brezi e poshtë, i rrinte gjithnjë i zhytun në borë. e cila shkrihej vazhdimisht nën rrezet e ngrohta të diellit pranveror.

I afrohet. Ja largon kapotën nga fytyra dhe shikon ushtar Hekuranin, të cilin e njihte shumë mirë. Ishte mbështetë për mur të hendekut, kishte ulë kryet dhe, ashtu me sy mbyllun, dukej sikur po mendohej.

Iu kujtue Hekurani kur kalonte andej nga kullotat dhe i thërriste:

— Hë, o Istref, a po të kullosin? Eh, ta dish sa më ka marrë malli! — Dhe mandej, tue këndue, merrte rrugën për teposhtë.

Pa dashë, katundarit iu mbushën sylë me lot. Ashtu me sy të përlotun u sul dhe e puti në faqe. Iu duk se puthi një gur të ftohtë si akulli.

Dy herë me radhë ai e kish kërkue Hekuranin nëpër borë e nuk kishte mundë me e gjetë. Tashiti e kishte para sysh, të ngrimë akull, me këpucë në dorë dh strajcë në shpinë. Fytyra e tij ishte sjellë andej nga shpella, prej së cilës nuk ishte larg as pesëdhjetë metra.

Fshiu lotët, përmbloodhi veten dhe, pa u kujdesë ma për mushkën, shkoi ke shpella e ushtarëve.

Roja e la t'afrohej, mbasi dukej se kishte për të thanë diçka me randësi.

— Lajmëro të gjithë shokët, — bërtiti ai, — e gjeta Hekuranin.

Roja shtangu në kambë nga çudia.

— Ore, dëgjon ti, apo si e ke hallin? — përsëriti Istrefi. — E gjeta Hekuranin. Ja ku është, as pesë-

dhjetë metra prej këndeje, më plaçin të dy sytë po gënjeva.

Ai bërtiti kaq fort, sa e ndigjuen të gjithë.

N'atë kohë, Istrefi hyni bashkë në rojen në vendin e punës dhe thirri:

— Vëllezër, lini punën dhe ejani me mua të shikoni Hekuranin.

Ushtarët duelën nga objekti. Të gjithë u nisën vrap për tek vendi.


Pamja ishte me të vërtetë tronditëse, por edhe madhështore! Togeri po e shikonte përsëri Hekuranin, të cilin e kishte pa andër kushedi sa herë në këto net të kalueme me tronditje. Por tashti Hekurani nuk ishte ma ai ushtar i qeshun, i gëzueshëm dhe optimist, që e mbannte gjallë humorin në shoqni. Hekurani ishte serioz, i mvrejtun dhe i mendueshëm. Dukej sikur po i thoshte komandantit të tij:

— Shoku komandant, nuk munda të vi në kohën e duhur. Bëra çmos që të zbatoja urdhërin, luftova me borën, me vdekjen, por nuk munda; por edhe urdhërin nuk e shkela. Siç e shikon, unë gjithnjë isha afër jush...

Ky mendim e bani togerin të dridhej nga mallëngjimi. Në mendjen e tij Hekurani gjithnjë fliste:

— Shoku komandant, unë e kreve detyrën. Ja ku është çanta me ushqime, shtypi, ilaçet dhe këpucët e shokëve, që do të lirohen. Asgjë nuk kam humbur. Ja, edhe i vdekur, këpucët nuk i kam lëshuar nga dora.

Toger Stefanit nuk iu durue ma para këtij vegimi, por u sul dhe e përqafoi ushtarin e tij, sho-



kun e tij aq të dashun! Kur e pushtoi atë trup t'akulluem, e kuptoi sa fort e kishte dashë. E, pra, Hekurani nuk ja hudhi dorën në qafë kësaj here, por ndej si statujë.

Lajmi i gjetjes së Hekuranit muer dhenë. Kautandarët lanë punën dhe u nisën për ke vendi. Ata vinin ta shikonin ushtarin që rrinte me krye ulun, mbështetë për mur. E njihnin mirë. Disa e qanin në heshtje. Të gjithë ndjenin krenari për këtë bir të lavdishëm, që e dha jetën e tij të re në malet e tyne. Ata tashti e quenin të tyne ushtar Hekuranin. Bile disa nana, që i kishin dhanë disa herë ujë me duert e tyne, erdhën dhe e qanë si të ishte djali i tyne. E qanë me ligjë, ashtu siç dijnë të qajnë nanat shqiptare.

Të gjithë e kishin rrethue kufomën, të gjithë e shikonin me çudi.

Lajmi shkoi si vetëtima edhe në repart të qytetit. Prej andej u përhap edhe në të gjithë qytetin.

— Hekurani u gjet i ngrimë në borë!

Me qinda qenë ata, që shkuen ke vendi për ta pa heroin e detyrës.

Lajmi fluturoi menjherë edhe në Tozhar të Skraparit.

Asht e randë mandata, që lajmon vdekjen e një të dashunit në familje, por ka edhe dhimbje krenare! E tillë qe dhimbja për xha Aliun.

— Hekurani u gjet i vdekun në krye të detyrës!

Ky lajm e tronditi plakun. Djali tashma ishte i vdekun! Por ky lajm sikur i suell një përkëdhelje të dhimbëshme; sikur ja ledhatoi sedrën prej shqiptari. Figura e të birit u rrit shumë ma tepër para

syve të tij. Sa do të deshte ta kishte të gjallë për një çast e ta përçafonte! Mandej, do t'i thoshte: — Të lumtë, bir, se ma zbardhe faqen në pleqëri. Për të vdekur kemi të gjithë. Çështja është të vdesim me nder, kështu si ti.

I madh dhe i vogël duelen ta prisnin Hekuranin e tyne, që po vinte në krah të shokëve. Donin t'i jepnin përshëndetjen e fundit.

Nalt nga udha nisi t'ulet korteu i vogël, që sillte trupin e vdekun të Hekuranit. Ai po vinte aty i veshun me rrobe ushtarake. Ai kishte vendosë të rrinte ushtar i përhershëm! Ushtar i të gjithë datlindjeve, ushtar i pavdekshëm i Republikës popullore të Shqipërisë!

Si katundi Tozhar, si katundet përreth, bashkë me të dërguemit e ushtrisë e varrosën Hekuranin në një kodër të vogël nga mund të shihen të gjitha lagjet e Tozharit. Atje, baba i tij foli shqip-tarçe:

— Bir, — thirri tue e ngritë kryet me krenari. — Më vjen keq që nuk je më dhe po të vorrosim në dhé të zi. Vdekja është e rëndë. Por ja ku po e porosis edhe Syrianë, që ka ardhur nga ushtria në vorrimin tënd:

— Shiko ti, o bir! Po të ndodhi që, për të mprojtur atdheun, tokën tonë, nderin tonë, duhet të japësh jetën, jepe me krenari, jepe pa dhimbje, ashtu si Hekurani. Unë do të ta di për nder edhe ty, ashtu si po ja di edhe Hekuranit.

Tashti, në vorrezat e Tozharit duket gjithnjë i ri një varr i rrethuem me drunj të latuem, siç e kanë zakon fshatarët. Ai asht vorri i bariut të kooperati-

vës, i ushtarit Hekuran, që do të mbetet gjithnji simbol flijimi për detyrën. Ai do të mbetet shëmbull për të gjithë, e sidomos për rininë tonë, e cila trashëgon virtytet ma të nalta të partizanëve trimë, të atyne që kryen epopenë e madhnueshme të historisë sonë.

(«Nëndori» Nr. 4-1936).

NEXHIP NEZHA

BIRI PER SHPIRT I TOZHARIT

«...Si një çfaqje të thjeshtë admirimi dhe respekti tim për kujtimin e Hekuranit, ju lutem të më lejoni që të shkoj në fshatin e tij të lindjes... e të punoj në kooperativë si anëtar i familjes së Hekuran Zenunit.»

Dhoma e studimit e repartit është e thjeshtë. Këtu është pikëtakimi i luftëtarëve të repartit me librat dhe gazetat.

Midis të shumtëve hyn edhe një luftëtar me pamje të qetë. Është Kujtim Hysenaj. Ai merr një gazetë dhe e çfleton... Pastaj qëndron dhe lexon një negim të vërtetë. Heroizmi i Hekuran Zenunit i lë mbresa të thella.

— Njësoj si të hidhesh mbi tank — tha me vete kur mbaroi leximin. — Ai është bir i vërtetë i këtij populli që nuk trembet nga vështirësitë dhe ecën përpara me hap ushtarak. Kështu i kemi mposhtur të gjitha furtunat e shekujve, me shpatë në dorë. Të lumtë, o Hekuran Zenuni!

* * *

Kujtim Hysenaj trokiti në zyrën e komisarit.
— Shoku komisar! Më lajmëruan të shkoj me lejen e zakonëshme. Kisha menduar të shkoja në shtëpi, të shikoja prindërit, të çmallesha me miqtë. Por këto ditë më lindi një dëshirë tjetër. Lexova në gazetë për heroizmin dhe sakrificën supreme të ushtarit Hekuran Zenuni. Luftëtar Zenuni ka rënë duke përmbushur një detyrë ushtarake. Si një çfaqje të thjeshtë të admirimit dhe respektit tim

për kujtimin e tij ju lutem të më lejoni që të shkoj në fshatin e tij të lindjes, pranë familjes së tij, në kooperativën bujqësore të Tozharit, në rrethin e Beratit, dhe gjatë ditëve të lejes sime të punoj në kooperativë, si anëtar i familjes së Hekuran Zenunit. Ju lutem të ma plotësoni këtë dëshirë.

Komisari u ngrit më këmbë dhe sytë e tij ndritën nga një gëzim i brëndëshëm. Ai ndjen një kënaqësi të thellë për këtë qëndrim të lartë patriotik të ushtar Kujtim Hysenajt. Po, po. Ky qëndrim tregon moralin e lartë të luftëtarëve të repartit të tij, tregon se çfarë njerëz kalit Partia jonë, çfarë shkollë e madhe revolucionare është ushtria jonë popullore. Ai është komisar i kompanisë. Detyra e tij është që t'i bëjë luftëtarët të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e Atdheut socialist. Ai është edukator, por propozimi i Kujtim Hysenajt është një shembull që edukon më mirë se çdo libër. Jeta e gjallë e popullit është burim i pashtershëm edukimi. Heroizmi i luftëtar Hekuran Zenunit dhe kërkesa e ushtar Kujtim Hysenajt janë të frymëzuara nga i njëjti ideal i Partisë sonë: mbi të gjitha duhet vënë interesi i Atdheut, interesi i përgjithshëm.

I thjeshtë si e vërteta, me kapelen në dorë, me flokë gështenjë, të shpupuritur pak në anën e majtë, Kujtimi po e shikon me ata sy të ri allë komisarin dhe pret përgjigjen. Komisar bën një hap përpara dhe e përqafon luftëtarin.

— Të lumtë, Kujtim Hysenaj. Ti e meriton plotësisht emrin e luftëtarit të Ushtrisë sonë Popullore.

Oficerët, nënoficerët dhe luftëtarët, që u mbledhën pas disa ditësh për të përcjellë Kujtim Hyse-

najn për në kooperativën bujqësore të Tozharit, çfaqën një kënaqësi të thellë që ai vendosi të punojë e të jetojë në atë vend ku lindi dhe u rrit Hekuran Zenuni.

* * *

...Të përshëndes Tozhar! Kujtova se ishe gur e gërxhe por kështu paske vetëm pragun e hyrjes. Vend i përthyer qënke, por kjo toka jote e tultë më thotë hapur se tek ty lulëzoka një pranverë e bukur plot blerim. Paske prroie që gurgullojnë, pyje me lisa, paske shumë pjergulla.

Shtëpitë i paske shumë të përhapura, Tozhar! Po ku është shtëpia e atij trimi që po kërkoj? Qënkërke karshi Tomorrit Tozhar, gati në këmbët e tij. Hej, sa mal i bukur! E paske afër Tendën e Qypit. Aty fricët gjermanë hëngrën një grusht që nuk do ta harrojnë kurrë. Trimi yt, që më ka hyrë në zemër, do të ketë lexuar për atë betejë dhe ajo ka qenë burim frymëzimi për kryerjen e detyrës së tij. Ti e linde dhe e rrite atë trim. Të lumtë, Tozhar!».

Luftëtari, duke zbritur atyre shpateve solli ndërmend skena të luftës heroike. Pasi eci dhe ca deshi të dallonte shtëpinë ku lindi dhe u rrit shoku i tij i armës, Hekuran Zenuni, që ra heroikisht duke plotësuar një urdhër të komandës. Nji plak dolli aty pari dhe po e shikonte mysafirin me rrobat jeshile.

— A mund të më tregoni, xhaxha, se ku është shtëpia e Hekuranit? — e pyeti atë.

— Hekuranit?... Ai ka vdekur, o bir. Në

shtëpi ka lënë dy vëllezër. Njëri prej tyre, Dulja, është mësues. Më pyete për shtëpinë? Ja, ajo përtej lumit, anës së atij shpati. Nga vjen, o trim? Nuk e paske marrë vesh se Hekurani...

— Po. Unë jam shok i tij i armës. Luftëtarët që bien në krye të detyrës janë gjithmonë midis nesh. Ata rrojnë dhe na japin fuqi.

Mysafiri bëri tatëpjetë, gjatë shpatit, në rru-
gën plot dredha. Plaku e ndoqi me vështrimin e
tij kureshtar deri përtej lumit. Kujtim Hysenaj
kapërceu urën me harqe dhe u ngjit plot vrull
djaloshtar në lagjen e përtejme. Kur iu afrua shtë-
pisë së Hekuran Zenunit, para saj takoi disa nje-
rëz. I përshëndeti dhe hyri brenda. Iu drejtua
nënë Haxhiresë. I tregoi për qëllimin që kish ar-
dhur dhe iu lut ta quante si djalin e saj, ta bënte
bir për shpirt. Nëna s'e mbajti veten nga kjo da-
shuni e madhe që tregonte një njeri gjer dje i
panjofun për te dhe për të birin.

— Për hatrin e djalit, mbahu nënë Haxhire!
Ke rritur një djalë trim, nënë, një djalë që i fry-
mëzon të rinjtë në punë dhe në jetë.

Ajo e përqafoi njëlloj si të ishte kthyer He-
kurani.

— Ka nëna plot djema, — i tha ajo, duke
mbajtur lotët.

— Po, ashtu është. Unë jam njeri prej tyre.
Kam ardhur të punoj pakë ditë në vend të Heku-
ranit. Ndofta do t'ju lëndoj një plagë, por Heku-
rani rron në zemrën time si hero.

— Nuk i lëndohet plaga nënës. Hekurani im
është djalë i Partisë, hallall ta ketë. Ma bëre zem-
rën mal, bir i nënës!

* * *

Njerëzit e shtëpisë e pritën Kujtim Hysenajn sikur të ishte kthyer Hekurani. Të nesërmen nënë Haxhireja përcolli në punë jo dy djem, por tre. Kujtimin dhe Syrjain me kazma në krahë ndërsa Dulen me fletoret e detyrave të nxënësve nën sqetull. Me vështrimin e saj, nënë Haxhireja i ndoqi gjersa kapërcyen urën me harqe. Në brigadën «Hekuran Zenuni» të kooperativës bujqësore të Tozharit, nisi punën një luftëtar i ri në vend të luftëtarit trim që nuk u kthye.

Në fshat thonë se Kujtim Hysenaj është bir për shpirt i Tozharit.

«Puna» korrik 1966

LUAN DIBRA

TREGIM PËR HEROIN

«...Unë kam bërë detyrën». Ky
përkufizim sikur i vë kornizën por-
tretit dhe veprës së tij.

Çastet e para të takimit me Lymin, më patën zgjuar një ndjenjë habie dhe mund të them dëshpërimi. Kjo ka ndodhur në vitet e para të çlirimit. Unë kisha dëgjuar se shumë nga atentatet më të guximëshme, një numur aktesh me të vërtetë heroike e legjendare në betejat e luftës çlirimtare, ishin lidhur me emrin e Myslim Ketës. Dhe unë e kisha përfytyruar një figurë epike, nga ato të legjendave, të cilat i kishim lexuar e dëgjuar me etje në vitet e fëminisë e miturisë. Po Lymi, m'u duk disi ndryshe. Vërtet ai ishte i gjatë, por trupi i tij ishte pak i hollë, ai kishte një zë të ëmbël, dy sy të butë, të ngrohtë e bile shpesh të menduar. Fliste qetë, ngadalë, për gjëra të thjeshta, të zakonëshme, njerëzore, dhe në përpjekjet e mia të para, ai u largohej bisedave që kishin të bënin me jetën, figurën e tij si luftëtar. Dalngadalë nisa të ndjeja tërheqjen e tij, u ndodha nën ndikimin e personalitetit të tij, jo si e pata menduar: nga forca e ashpër epike, por nga një forcë tjetër, që buronte nga gjërësia dhe thellësia e botës së tij, të cilat çfaqeshin në tërësinë e personalitetit të tij: në thjeshtësinë, butësinë, në ndërgjegjen e lartë, se ai kish bërë e nuk bënte veçse detyrën, atë që i kërkonte bindja e tij prej qytetari, patrioti e komunisti. Dhe pikërisht në këtë sfond munda të shquaja forcën e

tij burrërore dhe epike, guximin e heroizmin e tij, të cilat rridhnin jo si një shpërthim i çastit, por si pasojë e mpleksjes së natyrës me edukatën e fushme, si pasojë e zhvillimit të një botkuptimi të tërë që i ushqyen ndjenjat e atdhedashurisë dhe idetë e komunizmit.

Fyt për fyt me armikun

Heroizmi është sakrifikimi i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm i gjithë interesave dhe i vetë jetës në shërbim të një ideali të shenjtë. Në themel të heroizmit qëndron dashuria për atdheun, dashuria e thellë për njerëzit. E gjithë jeta e Lymit ka qënë një pohim i sigurtë dhe plot devocion i këtyre ndjenjave.

Pushtimi fashist italian tronditi gjithë kombin, gjithë popullin, i cili nisi të mendojë e të mbledhë forcat i shqetësuar për fatet e atdheut, për lirinë, dinjitetin e të ardhmen e tij. Partia Komuniste u bëri thirrje dhe u tregoi rrugën e çlirimit kombëtar dhe shoqëror të gjitha forcave e njerëzve të ndershëm të vendit. Koha e zgjimit, koha e luftës çlirimtare kishte ardhur.

Ndonse fëmijë, Lymi i përqafoi që në fillim, sigurisht në mënyrë ende jo plotësisht të ndërgjegjshme, idetë komuniste. Së bashku me Adnanin, shokun e tij të vegjëlisë e të tërë jetës, sabotonin kampet e pushimit të balilave, vendosnin shënjen e drapër-çekanit në kampe, në muret e ndërtesave të ministrive, grisnin flamurët e pushtonjësit. Afrimi me komunistin dëshmor Xhez-



mi Dellin, puna e tij edukative, e futi përfundimisht në rrugën e revolucionit.

Jeta e aksioneve luftarake, puna politike dhe ideologjike e partisë, në radhët e së cilës ai u pranua në korrik të vitit 1942, zbuluan dhe zhvilluan cilësitë e shkëlqyera të heroizmit tek djaloshi ende i mitur. Ishte vetëm 15-16 vjeç, kur hyri në njësitet guerile e më vonë në çetat partizane, dhe mori pjesë në ndërmarrje që kërkonin guxim, gjakftohësi, mençuri dhe pjekuri të rrallë. Më teoër se vepër, asgjë s'e zbulon më mirë portretin dhe karakterin e një njeriu. Le të tregojmë disa nga episodet e Lymit në ditët e luftës për çlirim:

Vrasja e kolonelit fashist.

Dy djem të rinj, qëndronin para kishës në rrugën e Dibrës (sot rruga «Bajram Curri») e tre të tjerë para kafe «Përmetit», po në këtë rrugë. Brënda dëfrente spiuni fashist Jani Kristo. Kur ai do të bëhej gati të dilte nga pijetorja, dy djemtë do t'u jepnin shenjë tre shokëve të tyre (Lym Ketës, Adnan Qatipit e Njazi Mekës) e ata do të afroreshin dhe do ta qëllonin. Por papritmas e pa u vënë re, ai doli nga lokali dhe, kur Lymi e Adnani e vunë re, spiuni ishte larguar mjaft. E ndoqën nga pas, por ai iku me vrap dhe u fut në një postë karabinerie. Ky dështim i papritur i shqetësoi pa masë.

Atëhere vendosën shpejt e shpejt që të vrisnin patjetër ndonjë fashist ose tradhëtar. Ishte e dielë dhe bulevardi nxinte nga njerëzit. Një fashist, një

tradhëtar, duhej të shkonte në djall. Dhe ja, përpara tyre, u duk figura e krekosur dhe mburavece e Ndok Gjeloshit. Ai ishte dënuar nga Partia me vdekje për masakrat dhe raprezaljet që kish bërë në Pezë dhe në Mallakastër. Shetiste i shoqëruar nga rojet personale. «Të qëllojmë pa humbur kohë», foli Lymi. Por në çast, midis tyre u gjendën dy burra: sekretari i komitetit qarkor të partisë për Tiranën, Gogo Nushi dhe komandanti i njësiteve guerrile, Beqir Balluku. E kishin kuptuar qëllimin dhe i urdhëruan që të përmbahehin e të vepronin vetëm atëhere kur të ndodhehin në një vend të përshtatshëm e për këtë do të merrnin shenjë nga ata: Tradhëtari ecte përpara e trimat komunistë prapa. Ata prisnin me padurim shenjën. Trupi i madh i kolonelit fashist, sikur i nxiste ta qëllonin e ta shfarosnin duke shfryrë kësh-tu urrejtjen ndaj okupatorëve dhe këtij shërbëtori të fëlliqur.

Pak më poshtë se materniteti, Lymi shtatëmbëdhjetëvjeçar i doli përpara oficerit tradhëtar dhe ja plasi në sy: «Partia të ka dënuar me vdekje për Mallakastrën dhe Pezën». Dhe pa i lënë kohë të bëjë asnjë lëvizje e qëlloi në kokë. E qëlloi përsëri, përsëri dhe pasi tradhëtari ra në tokë, përsëri tre, katër, pesë herë, nëntë herë deri sa shfreu gjer në fund urrejtjen dhe u bind se e kish vrrarë. Rojet kishin ikur të tmeruar. Karabinierët e një poste të afërt, u futën brenda të trëmbur. Shokët po e prisnin Lymin më tutje. Pasi u bind se armiku qe vrrarë, nisi të vraponte. Karabinierët, si e mblodhën veten, dualën e filluan t'i ndjekin. Armiqtë po qëllonin dhe ai me shokët ishin në rrezik. «Ecni me zikzake»

— u thërriste Lymi shokëve dhe vazhdoi vrapin. Pastaj hodhi një granatë dhe tmeri e tymi i zi i zbrapsën karabinierët. Por me t'u kthyer tek rruga pas maternitetit, Lymi, Adnani dhe Njaziu u gjendën të rrethuar nga një grup karabinierësh të një poste tjetër. Ata u kishin drejtuar pushkët. Lymi qëndroi përsëri gjakftohët. Ai i shtyu mënjatë shokët dhe vrapoi vetëm poshtë nga lumi. Xhandarët iu vunë në ndjekje e filluan ta qëllojnë. Dy shokët u larguan, duke kapërcyer shtëpi më shtëpi, ndërsa Lymi po i afrohej lumit i ndjekur nga armiqët. Arriti në lumë më shpejt se ata. Futi duart në ujë, u freskua dhe zuri një pozicion lufte. Disa punëtorë ngarkonin rërë. «Djalosh, ikë se po vijnë», foli njëri prej tyre. Lymi qeshi pa u bërë merak fare. «Mirë se të vijnë. Por e dini ç'bëni? Ata do t'ju pyesin për mua, dhe ju u thonë se shkova në drejtim të kundërt». Dhe ashtu ndodhi.

Në mbrëmje Lymi dëgjoji në radio lajmin e vrasjes së Ndok Gjeloshit. Radioja njoftoi gjithashtu se dy nga atentatorët u vranë, ndërsa njerin po e ndiqnin. Ai nuk priti, por u nis me të shpejtë tek shtëpia e Adnanit. Fashistët kishin gënjyer. Të gjithë shokët e njësitit ishin shëndoshë e mirë.

Aksioni i miellit.

Edhe sot në pazarin e ri, në Tiranë, ndodhet një furrë bukësh. Në kohën e pushtimit ajo ishte pronë e një italianit. Ky miell duhesh për popullin, për partizanët. Më 1943, Lymi dhe një grup shokësh u ngarkuan që të bënin një aksion pikë-

risht në këtë furrë, për të tërhequr një sasi sa më të madhe mielli për partizanët, që vepronin në rrethet e Tiranës.

Plani i aksionit ishte i thjeshtë: ai mbështetej në gjakftohtësinë dhe guximin e shokëve. Lymi dhe një shok i tij, do të futeshin në furrë, do të çarmatosnin dhe do të ndalonin nëpunësit për çdo përpjekje alarmi, ndërsa të tjerët do të qëndronin jashtë në mbështetje të aksionit. Ishin siguruar edhe kamionët që do të shërbenin për transportimin e miellit në bazë.

Ishte mëngjes. Para furrës, një grumbull punëtorësh ngarkimi, tregonin qyfyre me zë të lartë. Qytetarë të ndryshëm futeshin brënda për të marrë bukë. Por ja, papritmas dy djem të rinj, u futën me armë në dorë, urdhëruan nëpunësit e furrës të mos flisnin dhe njerëzit që ishin brënda të mos dilnin jashtë. Policin e çarmatosën, e lidhën dhe e mbyllën në w.c. Atëherë të dy shokët u dhanë urdhër punëtorëve të fillonin nga puna. Ky ishte një aksion në mes të ditës, në mes okupatorëve dhe tradhëtarëve. Kamionët së fundi u ngarkuan plot dhe menjëherë u nisën në baza e shtëpi të ndryshme për t'i shpënë te partizanët.

Kur gjithçka kish përfunduar e të dy shokët fërkonin duart të kënaqur, Lymi befas vuri re se kish harruar në furrë këllëfin e dhjetëshes.

— Oh, — tha ai i mërzhitur — paskam harruar në furrë këllëfin e dhjetëshes.

— Punë e madhe, — foli shoku i tij i shqetësuar, sepse ja njihte kokën dhe e dinte se mund të bënte ndonjë të pabërë.

— Jo e kam shumë merak. Do të vete ta marr.

— Kjo është marrëzi. Për një këllëf do që të vesh kokën në rrezik? Po e di se aty duhet të jetë grumbulluar e gjithë policia e Tiranës?

— Sidoqoftë unë do të vete, ti po të duash mos eja, unë do të shkoj ta marr.

Shoku i tij i ngushtë e dinte se nuk e ndalte dot dhe e këshilloi që të hetonin para se t'i afroheshin furrës. Por Lymi u dha te dera, me revolen të shtërnguar fort në dorë, pa iu trëmbur syri dhe në rrëmujë e sipër shkoi në vendin ku e kishte lënë e me gjakftohtësi të çuditëshme e mori dhe u largua duke u kaluar nën hundë policëve, të cilët ishin ngritur të trëmbur për të kaluar guximtarët.

Letër për komunikatat e partisë.

Depoja e letrës ndodhej në pazarin e ri, pranë postës së dikurshme (gjer kohët e fundit ndërtesa e bashkimeve profesionale të qytetit). Lymi ishte informuar për gjithçka: Administratori i depos kishte dy djem të rinj, ai punonte aty deri vonë. Dy roje ruanin përpara depos. Aksioni u caktua të bëhej në një nga ditët, që qe vendosur për transferimin e depos. Hyrja u bë e befasishme. Administratorin e lidhën shpejt e shpejt, i mbyllën gojën dhe e futën në një qoshe. Filloi puna. Jashtë priste një triçikël. Lymi dhe Tasi ngarkonin në triçikël. Lymi e shpinte në bazë e kthehej përsëri.

Por në çast, të dy rojet u futën brënda.

— Ç'bëni këtu, o djema?

— Jemi të bijt e X... (emëri i administrato-
rit nuk dihet). Po transferojmë materialin në një
depo tjetër. Baba na pret atje, — foli Lymi i qe-
të, sikur të ishte vërtet ashtu. Një roje u ul e nisi
muhabetin. Lymi i përgjigjej dhe vazhdonte punën.
Rojet dilnin, bënin disa rrotullime në rrugë e kthe-
heshin përsëri. Lymi ngarkonte, transportonte në
bazë e kthehej përsëri. Kjo vazhdoi deri sa sasira
të mëdha letre u transportuan në bazat e teknikës
së partisë, prej nga shpërndareshin në të gjitha
anët e vendit, duke shpënë kushtrimin dhe urdhë-
rat e ditës të luftës çlirimtare.

Skëterë, 1943.

Kjo ka ndodhur aty nga fundi i muajit shta-
tor. Italia kish kapitulluar e gjermanët e veglat e
tyre. përpqeshin nga njëra anë të trembnin po-
pullin me violencën e tyre dhe nga ana tjetër
mundoheshin ta mashtronin me demagogji duke
thënë se ushtritë gjermane nuk kanë ardhur për të
pushtuar Shqipërinë por janë në kalim, prandaj
nuk ka arësye të luftohet me to.

Por populli ngriti pushkën. Dhe një nga aksio-
net e para kundër gjermanëve ka ndodhur pikë-
risht në këtë kohë. Çeta e Dajtit vepronte në rru-
gën e Krrabës. Lymi me 7-8 shokë të tij, vëzhgon-
te lëvizjet e armiqve, për të marrë informata ose
për të kryer ndonjë aksion. Disa ditë më parë atij
i kishte shpëtuar një gabim, të cilin ai ish zotuar
ta ndreqte patjetër: kish ndaluar një veturë, u kish
kërkuar identitetet pasagjerëve dhe ata i kishin

thënë se ishin inxhinierë. Por në të vërtetë aty kish qënë një funksionar fashist. Kjo e kishte tërbuar Lymin.

Dhe tek qëndronte, aty pranë udhës, vuri re nga larg, se po afrohej një veturë, e pas saj disa kamiona. I vendosi shokët në pozicione të volitëshme, anës xhadesë ndërsa vetë, së bashku me një partizan tjetër, i doli përpara veturës dhe e ndaloi. Hodhi sytë mbrenda: një pre e majme, një kolonel e disa oficerë. Kishte zënë parafangon e përparme, kurse shoku i tij qëndronte në gadishmëri. Me të shpejtë hetoi kamionat. Ata ishin automjete furnizimi, prandaj s'kishin veçse pak oficerë dhe ushtarë. Me qetësi të madhe u dha shenjë edhe shoferëve të kamionëve që të shikonin komandantin e tyre në ndëshkimin hakmarrës që e priste. Në një shesh u çarmatosën: ishin 18 veta, oficerë e ushtarë, me në krye një kolonel.

Atë ditë Lymi dhe shokët e tij, zëvendësuan rrobet e tyre të reckosura me uniformat e reja të gjermanëve që gjetën në kamiona.

Në çetë filloi pregatitja, sepse ishin të sigurt se gjermanët do të vinin të nesërmen për të marrë hakun e shokëve të tyre. Që pa gdhirë grupi partizan u nda në tri grupe dhe zuri tri prita, nga parashikohej të sulmonin nazistët. Kjo ishte beteja e parë e çetës me okupatorët gjermanë. Ata e kishin zakon ta nisnin betejën mbasi të kishte aguar. Duke e ditur këtë, Lymi dhe tre shokë dolën të vëzhgojnë shumë herët, lëvizjet e gjermanëve. Por pa kuptuar ishin futur thellë në prapavijat e tyre. Papritmas plasi lufta në mes partizanëve dhe kolonave gjermane. Lymi u tha shokëve që të shtrihe-

shin e të heshtnin për disa çaste. Para tyre ndodhej një ndërtesë. Në të dy anët e saj, dy gjermanë të shtrirë barkas qëllonin partizanët. Ndërsa në faqen e mbrojtur të saj, dy të tjerë pinin cigare. Lymi u tha shokëve të qëllonin, por vetëm ata të dy që ishin në luftim. I qëlluan dhe i vranë. Pastaj vendin e tyre e zunë dy të tjerë. I qëlluan dhe i vranë dhe ata. Pastaj erdhën tre të tjerë. Dy u vranë, por njëri e kuptoi se i qëllonin nga prapa e njoftoi të tjerët. Atëhere nisën të qëllojnë. Pas pak dy shokët e tij humbën lidhjen me Lymin, e ai vetë u fut në një korie të vogël, ku harxhoi në luftime të ashpëra edhe fishekun e fundit. Pastaj zuri një guvë, u shtri e priti të errej. Muzgu veshi me një ngjyrë të hirtë natyrën. Gjermanët ndërprejnë luftën. Ai pa nga larg një grup ushtarësh nazistë që ktheheshin nga një kodër. Ndënji disa çaste e si u bind që nazistët ishin larguar, u ngrit e doli në një shesh. Por, papritur, dy gjermanë i dolën përpara e njëri prej tyre, duke e parë Lymin me uniformën e oficerit gjerman, iu drejtua dhe i thërriti diçka në gjermanisht. Lymi i pa automatikun varur në qafë e duke menduar se fishekët i genë mbaruar, po bënte llogari që t'u hidhej në fyt. Por gjermani, duke kuptuar me kë kish të bënte, lëvizi armën. Atëhere ky, instiktivisht, futi dorën në brez, nxori revolen (ai mbante disa armë) dhe u çudit, kur, duke hequr këmbëzën, dëgjoi krismat. Një nga gjermanët u rrëzua për tokë, me tjetrin u kap fytazi dhe më në fund edhe këtë e vrau. Ishte vonë, kur arriti tek shokët. Ata e pandehnin të vrarë.

Për çfarë akti tjetër trimërie dhe guximi të Lymit të flasim tani? Për trimërinë e treguar në luftën e Arbanës, ku, siç shkruan ish kapiteni nazist, Herman Frank, që drejtonte operacionin gjerman, u bë një luftë e pabarabartë ndërmjet nazistëve të armatosur me mitralozë, topa e tanke, dhe Lymit që qëllonte vetëm me mitraloz, aq sa së fundi gjermanët u detyruan të largohen prej sferës së qitjes të këtij mitrolozi, që në asnjë mënyrë nuk pushonte? Për sulmin në Teqenë e Sukës, ku shpartalloi gjermanët e shpëtoi dhjetë fshatarë nga pushkatimi? Për trimëritë në aksionet e tjera të njësiteve guerile, për luftat e tija në Tropojë, Deçan e Junik të Jugosllavisë? Rreth treqind okupatorë e 50 tradhëtarë ranë nga plumbat e heroit në vitet e luftës.

Shpirti i sakrificës dhe i vetmohimit ishte natyra e dytë e Lymit. Me një shpirt të tillë ai kryente edhe në vitet e pushtetit popullor detyrat që i caktoi Partia. Tregojnë se gjatë një lëvizjeje të mjeteve ushtarake, një rimorkiator i ngarkuar me predha që tërhiqte topin mori flakë. Lymi dha urdhër që të largoheshin të gjithë për t'iu shmangur rrezikut. Por atij i erdhi keq për predhat dhe automjetin e, duke shfrytëzuar vetëm pak sekonda, me një shkathësi të rrufeshme, shuajti zjarrin dhe mënjanoi shpërthimin. Sigurisht atij iu hoq vërejtje nga eprorët që rrezikoi veten. Ai heshti kokëulur.

Ashtu sikundër në luftën partizane ishte mjeshtër i armëve, i revoles, automatikut, mitro-

lozit të lehtë e të rëndë që i mbante në krah, ashtu dhe në armën e tankeve ku shërbente, ishte një mjeshtër i shkëlqyer. Në një lojë, ai bëri një zbritje me tank në një terren me një kënd pjerresie që kapërcen kufijtë teknikë të përdorimit të tankeve.

Ai mësonte dhe përvetësonte me kujdes armën, e donte armën, e donte atë si mjet që i shërbente fitores e mbrojtjes së revolucionit.

Thjeshtësia

Shokët e tij tregojnë se Tata — kështu i thërrisnin Lymit miqtë më të afërt me gjithë sukseset dhe trimëritë e tij në luftë, që e bënë atë shumë të njohur dhe të respektuar, mbeti po ai njeri kokulur, i thjeshtë dhe i dashur. «Atributi Tata, thotë shoku i tij i ngushtë Adnan Qatipi, i shkante për mrekulli natyrës së tij prej babaxhani, prej njeriu të sinqertë, modest, të gjerë e mirëdashës, si një baba i pjekur para kohe».

Dhe ai mbeti i thjeshtë tërë jetën. Shumë e njihnin Lymin. Sidomos pas çlirimit, kur Partia e nderoi me titullin më të lartë, atë të Heroit të Popullit. Emri i tij, trimëritë e tija u bënë të njohura prej mijra e mijra njerëzve. Prandaj mjaft të rinj e qytetarë donin ta njihnin e të dëgjonin prej tij episode nga lufta. Por kjo i shkaktonte shumë shqetësime. Ai nuk dëshironte të fliste në asnjë mënyrë për vete. Në biseda shoqërore ishte tepër i dashur, i ëmbël, me humor të hollë ane një tregonjës i këndëshëm. Por sapo ndokush ja

sillte fjalën në ngjarjet që kishin të bënin me heroizmat e tij, ai vrenjtej, ngrihej dhe ikte. Vitet me radhë që porositur të shkruante kujtimet që të përdorshin si dokumenta për ngjarjet kryesore të aktiviteteve të njësiteve guerile, të luftës në çetën e Dajtit dhe Brigadën III ku kishin genë efektiv, por ai lëkundej, për të vetmen arsye se kjo i tingëllonte si një vetëlëvdatë. Disa shënime në formë ditari, që i kishin mbetur pas shumë ndërhyrjesh, ja pat dhënë një shoku me të vetmin kusht, që t'i shfrytëzonte pa përdorur emrin e tij. Por një ditë vajti tek ai dhe kur shoku nuk ndodhej në dhomë, ja mori dhe e fshehu. Shoku që pat marrë ditarin tregon se edhe në këto shënime ishte vështirë të zbulojë rolin e Lymit në shumicën e aksioneve më të rëndësishme. Në disa shënime të tjera, që patëm rastin të shikojmë para disa ditësh në shtëpinë e tij, mbi njësitet guerile, nuk gjetëm asnjë rresht, asnjë shenjë goftë edhe të vogël, ku të identifikohet personi i tij. Nji nënkolonel, shok i tij, tregon: «Të rinjtë e Kombinatit të Tekstilit kishin ftuar Lymin për t'u treguar ngjarje nga Lufta Nacional-Çlirimtare. Lymin foli rrjedhshëm e bukur për 40 minuta me radhë, me një gjuhë të thjeshtë e prekëse, sa që edhe unë që i dija ato, mbeta i tronditur. Por asnjëherë nuk tregoi se heroi kryesor i këtyre aksioneve kishte genë ai vetë. Mua m'u duk mëkatë dhe padrejtësi, se kjo i kalonte kufijtë e modestisë. Prandaj, në fund, si afrova mikrofonin pranë vetes thashë me plot zë: «Ngjarjet që dëgjuam kanë patur si hero kryesor kolonelin Myslimin.» Nuk kisha mbaruar fjalën, kur ndje-

va një dhëmbje të fortë në këmbë: Më shkeli. Ktheva kokën me nervozitet, por vura re në fytyrën e tij një ndjenjë të thellë dëshpërimi. Më pyeti në fillim: «Mos të vrava shumë?» «Jo» i thashë. Pastaj shtoi: «Nuk bane mirë». Dhe dy javë nuk më foli me gojë. Një shok tjetër i Lymit tregon: «Pak vjet pasi ishte çliruar Atdheu, dy gazetarë të huaj, që kishin dëgjuar për trimëritë e tij, çfaqën dëshirën të bisedojnë me të. Takimi ishte caktuar në Hotel «Dajti». Unë isha ngarkuar si përkthyes. Por Lymi, ndonse i priti me mirësjelljen e tij karakteristike, nuk desh në asnjë mënyrë të fliste për veten. U detyrova unë të tregoja çka dija, por në një çast, papritmas, ai m'u lut, me një ton të vendosur: «Të lutem, mjaft më». Dhe u tha atyre: «Unë nuk kam bërë më shumë se luftëtarët e tjerë. Është e kotë që prisni ndonjë gjë interesante nga unë». Dhe duke u kërkuar të falur u largua». Ja dhe një fakt tjetër. Në vitin 1945, në kongresin II të BRASH-it, e ngarkuan të fliste. Se sa kish vuajtur për të dalë në atë podium e tregoi vetë, që në fillim të fjalimit: «Më mirë do të preferoja të luftoja 10 ditë kundër fashistëve, se sa të flas këtu në kongres».

Ai thoshte shpesh se e ndjente veten të shqetësuar kur dëgjonte të flitej për të. «Shumë akte që s'i kam bërë m'i atribuojnë, shumë të tjera i rrisin pa kuptim. Unë s'kam bërë veçse detyrën, si të gjithë partizanët».

Thjeshtësia ishte pjesë e natyrës dhe e edukatës së tij, si ishte trimëria, ndërgjegja e lartë

në kryerjen e detyrës, dashuria për shokun, sinqeriteti dhe shpirti i gjërë dhe i hapur deri në fund. Ai urrente pamjen, bujën dhe reklamën. «Unë kam bërë detyrën». Ky përkufizim sikur i vë kornizën portretit dhe veprës së tij.

Dashuria për shokun

Do të duket, ndoshta paradoksale: Lymit, këtij ndëshkonjësi të pamëshirshëm të armiqve dhe tradhëtarëve, këtij luftëtari thuaj të çmendur, që futej gjithmonë në zjarrin e betejës, i binte të fikët sa herë që shihte shokë të plagosur. «Ne e largonim sa herë varrosnim shokët e rënë» thotë një shoku i tij i luftës, se ai bëhej si i vdekur nga dhëmbja e thellë.

Krahas ashpërsisë së papërmbajtur ndaj armiqve, kjo dashuri e thellë për shokun e zbulon shumë mirë fytyrën humanitare të heroit tonë.

Shoku i tij i ngushtë, Adnan Qatipi, thotë: «Unë ja detyroj Lymit, tri herë jetën time. Në atentatin e Ndok Gjeloshit, ai më ndihmoi t'u shpëtoja plumbave të armikut. Kur isha i arreshtuar në vitin 1942, ai i vajti në shtëpi me revole, një spiuni që më kish denoncuar dhe e kërcënoi se do ta vriste në qoftë se nuk ndërhynte për të më shpëtuar. Dhe së treti në një betejë partizane. Duke luftuar nga afër me gjermanët një plumb më plagosi në krahun e djathtë. Arma më ra nga dora, gjaku më rridhte çurkë. Mua më qenë prerë gjunjët, në një kohë, kur gjermanët nuk ndodheshin veçse disa metra larg. Lymi m'u

gjend pranë. Më hodhi në krahë dhe më fshehu prapa një mulliri. Më la një revole e më tha: «Pa vdekur unë, ty s'të prek kush me dorë.» Mori mitrolozin e i qëlloi gjermanët që po afroheshin. Pastaj më hodhi rishtas në krahë duke shtërnguar armën në dorë. Me një skuadër partizanësh, ai pastroi zonën. Lymi dhe shokët e tjerë, më mbajtën në krahë në një situatë kur luftohej dhëmb për dhëmb me armikun, rreth 40 km. rrugë».

Lymi nuk hante kurrë vetëm. Në ditët e ashpra të urisë dhe të të ftohtit ai merrte gjithmonë pjesën më të vogël. Rrobat më të trasha, më të mira që u zinin armiqve, ai ua linte më parë shokëve. Për shokët kishte një dhëmshuri, një dashuri të thellë Tata. Dhe ai zinte shpejt shokë e miq nga radhët e njerëzve të mirë e të ndershëm ai me atë zemrën e tij të gjërë, me shpirtmadhësinë e gadishmërinë për të sakrifikuar gjithçka për shokun, me atë bisedën e tij të ëmbël, të hapur e të singertë, i bënte shumë shpejt njerëzit për vete. Partizanët linin kokën për Tatën. Në fshatrat ku kalonte Lymi, linin kokën për trimin. Ushtarët, me të cilët ai kalonte një pjesë të kohës së lirë, linin kokën për komandantin e tyre të zot, të guximshëm dhe aq të afërt. Një fshatar, që kishte ardhur për ngushëllim, heshti, nuk foli asgjë gjatë gjithë kohës që ndejti në dhomë. Së fundi, duke u ngritur, psherëtiu me një dhëmbje që dilte nga shpirti: «Ma mirë të mos e kisha njohur atë, sa i afërt, sa shok besnik ishte ai!» Një tankist tregonte se si Lymi ishte edhe komandant edhe një shok i

afërt që kujdesej çdo ditë për shëndetin, ushqimin, familjen e ushtarëve dhe ishte gati në çdo rast që të ndihmonte me zemër të hapur. Në lagjen ku ai jetonte fëmijët e vegjël e deri tek pleqtë e kishin shok e mik Lymin. Të gjithë e donin. Me të gjithë kishte miqësi. Ai ishte i afërt, i butë, i dhëmbshur, i qeshur, plot humor, i thjeshtë. Ky hero, ky luftëtar që dhe ndëshkonjës i tmershëm i armiqve. Ajo ashpërsi kundër armiqve të popullit, duket sikur buronte pikërisht nga kjo zemër e mbushur plot dashuri për njerëzit, për popullin.

Edhe vdekja e tij, megjithse aksidentale, që një dëshmi e forcës së madhe shpirtërore, e guximit dhe trimërisë, e dashurisë për shokun. Ai udhëtonte drejt Pukës, bashkë me shoferin, por makinën e drejtonte vetë. Afër një kthese automjeti pësoi një difekt e makina rrezikohej që të rrëzohej në një humnerë të thellë. «Mbahu, i foli ushtarit pranë, do ta përplasim në bokrimë që të mos biem poshtë». Dhe ktheu timonin. Por shëmbja që aq e fortë, sa u përplas me kokë në hekurat e makinës. Një plagë e thellë vdekjeprurëse iu hap në fytyrë. Syri iu prish e hekuri i hyri thellë në tru. Ai doli nga makina, i larë në gjak, i dërmuar. E para punë që bëri në atë gjëndje së cilës njeri tjetër s'do t'i kish rezistuar, që kujdesi për shokun. Ju afua shoferit dhe e shikoi me kujdes se mos ishte vvarë.

Shoferi kishte një tronditje të lehtë. Ai u ngrit ngadalë, por në çast, ndjeu se po rrëzohej duke vështruar kolonelin e tij të dashur, me fytyrë të plagosur e me organet e kokës të copëtuara.

— Oh, kolonel, shok! — thirri ai i tronditur.

— Ç'bën kështu? — foli Lymi. — Asht turp, unë nuk kam gja. Afrohu të të shoh, se ndonjëherë plaga nuk ndihet në fillim. Por ushtarin e mjerë e vriste pamja e Lymit.

— Lidhma kokën me këtë shami!

Ushtarit i dridheshin duart.

— Merr automatikun e qëllo në ajër, që të na vijnë për ndihmë shokët.

Ushtarit nuk i punonin duart nga ajo pamje ngjethëse, nga ajo plagë e thellë, që do të kishte lënë të vdekur në vend thuajse çdo njeri. Lymi e mori vetë armën dhe shtiu me breshëri.

— Tani qëllo dhe ti vëlla!

Dhe ushtari qëlloi.

— Tashti do të vijnë shokët — foli Lymi.

Pastaj u ul në një vend të ngritur anës rrugës. Ushtari e shikonte dhe mendonte se ç'forcë e madhe morale, shpirtërore e guximi e mbante të gjallë Lymin. I dukej se jetonte në legjendë. Është e pamundur që ai të ishte gjallë, dhe përsëri, mendonte ushtari, është e pamundur që ky njeri, ky hero të vdesë.

Kur erdhi një kamion, ai vetë, me trup të drejtë, u ngjit në kabinë, dhe mundi të qëndrojë gjer në spital. Atje mjekët vunë re se pulsi ishte krejt i heshtur, tensioni zero, vetëm zemra, zemra e këtij heroi, bënte rrahjet e fundit.

Dhe deri në çastet e fundit të jetës, ai s'pushoi së thëni: «Unë jam shumë mirë, kujdesuni ju lutem për ushtarin, shokun tim»!

Fjala shok, e cila tingëlloi në ditët e luftës si një simbol i një bote të re që po lindëte, i

botës pa klasa, pa vuajtje, i një bote të vëlla-
zëruar, në gojën e Lymit, në gojën e heroit që i
kushtoi pa kursim gjithë jetën e tij çështjes së
revolucionit, tingëllonte si një besim i flakët. si
një hymën që buron nga shpirti.

«Zëri i Rinisë» Mars 1966

PIRO TASE

KOMUNISTET E REJA HEROIKE TË MIRDITËS

«Ta dinë mirë, qent e tërbue, që të
kan pre e t'kan shkatrrue, se ta-
razhve s'kan me u pshtue, gjall o
vdek kan me të pague.»

Duke çfletuar disa dokumenta në arshivën e KQ të BRPSH, pashë një letër të dërguar Komitetit Qëndror të Rinisë 18 vjet më parë nga komiteti i rinisë së Mirditës. Ishte një letër e shkruar me makinë, nga një dorë e pastërvitur mirë në punët e zyrës dhe me mjaft gabime ortografike. E lexova atë letër që mishëronte heroizmin e rinisë sonë, patriotizmin e të rejave mirditore dhe luftën e ashpër klasore. Kjo më nxiti të shkoj në Mirditë e të shkruaj këto radhë.

... Shqipëria pas luftës kish kryqëzuar pushkën me kazmën, jehona e luftës ish ende e freskët dhe këngët partizane gërshetoheshin së bashku me ato të rrugës Kukës-Peshkopi e të hekurudhave të para.

Në ato vite kish pak bukë, pak rroba e këpuccë, por frymë të lartë revolucionare, punë, këngë, besim e entuziazëm të lartë. Këto këngë, këngë të revolucionit në marshim, këndonin dhe bijtë e bijat e Mirditës. Këndonin komunistja Mrikë Lokja si dhe Marta, Prenda e dhjetra të tjera anëtare të Rinisë Komuniste.

Ato, duke u ngritur mbi zakonet prapanike, duke mospërfillur predikimet e priftit reaksionar e kërcënimet e bandave të kriminelëve, u regjistruan vetë dhe nxitën edhe shoqet e tyre të

shkonin vullnetare për të ngritur trasenë e hekurudhës së parë në vendin tonë dhe të mirrnin pjesë në ndërtimin e Shqipërisë së re.

Këto dy binarë çeliku, që do të shtriheshin nga Durrësi në Peqin, u bënë si një vijë ndarëse ndërmjet dy ideologjive, dy botëve. Ja sepse kishite kaq entuziazëm rinia dhe kaq vrer reaksioni. Ja sepse u bënëin kaq shumë agitacion të rinjve që t'i pengonin të vinin në hekurudhë, ja sepse u bënëin kaq kërcënime të rejave dhe të rinjve vullnetarë.

Shpesh herë Marta dhe Prenda pyesnin veten: «E ç'ka këtu në hekurudhë që të jetë kundër moralit?» Ato e kuptonin se klasat e përmbysura nuk donin zhvillimin dhe përparimin e Shqipërisë. Mbeturinat reaksionare e kuptonin se aty, në aksion, Marta e Prenda do mësonin edhe se ç'është forca e bashkuar e njerëzve të një ideje, forcë që çan malet e ngre fushat. Pastaj ato a nuk mësonin shkrim e këndim pas punës?

Këtu, në aksion, si në një shkollë të madhe, ato mësuuan të vërtetën e thjeshtë se ndërtimi i socializmit ishte i pashmangshëm, se atë nuk e ndalonin dot as priftërinjtë, as kriminelët, që strukeshin pyjeve dhe që kërcënonin njerëzit e ndershëm. Ja sepse të vije në aksion, shënoheshe në listat e zeza të reaksionit. Hekurudha ishte llogore e një beteje të re, llogore e ndërtimit të Shqipërisë së re socialiste, gjë që reaksioni nuk e dëshironte në asnjë mënyrë.

Ndaj ato punonin me vull për të hapur tunelin e Rrogozhinës dhe u dukej në të njëjtën kohë se flaknin tej errësirën shekullore të Mirditës. Marta dhe Prenda u lidhën ngushtë si shoqe të një

brigade. Disa herë në orët e lira ato bisedonin dhe për hallet e tyre, por më shumë për hallin e Prendës.

Larg, në fshatin malor të Selitës, kish lindur Prenda. Sipas zakonit të vendit, atë e kishin fejuar me një djalë që ajo nuk e njihte. Kur u shpall vendimi se rinisë i besohej ndërtimi i hekurudhës së parë, u regjistrua dhe Prenda. Familja e të fejuarit u zemërua së tepërmi. Eile ata hapën fjalën se do ta linin, në rast se ajo shkonte vullnetare. Të frikësuar nga kjo prindët e kërcënuan Prendën se do ta përzinin nga shtëpia. Ajo, shokët dhe shoqet e saj, u përpoqën t'i bindnin ata, por më kot. Prenda vendosi të mos ndahej nga shokët e shoqet, të mos kthehej nga rruga e nisur edhe sikur i fejuari ta linte e familja ta mohonte. Prenda ish e vendosur në këtë rrugë dhe e bindur në drejtësinë e saj.

— Po ty, Martë, — i thosh ajo, — a të nxuarën pengesa?

— Jo, Prendë! Ata më lanë megjithse kisha fëmijën në gj. Kushedi se ç'ban Pashkja e vogël! Ende s'e ka mbushë motin njomza ime. Me çfarë e ushqen gjyshja tash që i mungon qumështi i nanës? Dhe ajo çonte mendjen e zemrën e saj larg, larg në Mirditë tek fëmija dhe përkundëte me mendje cucën e saj të mitur në atë djepin prej druri, të thjeshtë e të bukur, siç e bëjnë në Mirditë.

Sigurisht është i vështirë largimi i nënës nga fëmija për të vajtur në aksion. Por atëhere ishin pak të reja komuniste dhe ato duhej që patjetër të jepnin të gjitha shëmbullin krahas komunistëve.

Asnjë lëkundje në rrugën e caktuar, asnjë shkëputje nga radhët e luftëtarëve për socializmin. Ndaj ato, me vendosmëri të madhe, pa marrë parasysh as kërcënimin e priftit dhe të prindit, as zërin lutës të vogëlushes, linin kullat e tyre dhe zbrisnin poshtë, buzë detit, për të ngritur trasenë e hekurudhës. E ç'ishte kjo hekurudhë? Ato as e kishin parë, as kishin dëgjuar për të. As burrat pleq e më të ditur se ato, nuk e dinin. Por ato do të ndërtonin hekurudha të tilla, duke kaluar mes rreziqesh e sakrificash në emër të revolucionit, që revolucioni të shkonte më tej, që jeta të bëhej më e mirë.

Në hekurudhë dolën disa herë sulmuese e bile u dekoruan me medalje pune, për ndërgjegjen e lartë. Aty mësuan të jetojnë më mirë, mësuan të gatujnë gjellë të panjohura, njohën perimet që nuk i kishin parë e morën farat e tyre për t'i mbjellë në Mirditë. Ato e kuptonin se kishin ardhur ditë të reja pas përmbysjeve të mëdha dhe se i priste një punë e madhe, shumë e madhe, për të realizuar idetë e partisë, ndërtimin e një jete të lumtur. Nga ana tjetër, ato si gra, si amvisa e si nëna, duhet dhe kishin për detyrë të losnin një rol të madh në familje e shoqëri. Kështu të bashkuara, e më të pjekura, plot entuziazëm e optimizëm, u kthyen në fshatrat e tyre bashkë me dhjetra shokë mirditorë. Por ndërsa Martën e prisnin me gëzim në familjen e saj, me Prendën ndodhi ndryshe. Prenda mësoi se, i shtyrë nga reaksioni e nga zakonet prapanike, i fejuari e kish ndarë. Por kjo që e keqja më e vogël. Edhe familja e mohoi dhe i mbylli de-

rën. Prenda u detyrua të nisej për në Malaj, në fshatin e së motrës, ku e pritën me dashuri. Takimi me Martën, që edhe ajo ish në Malaj, i dha forca të reja, bëri që të gjejë një strehë tjetër familjare.

Kaluan kohë dhe ato punonin me të rejtat, i mobilizonin në punë e i drejtonin në jetë. U flisnin për aksionin e për jetën që bëhej atje, u tregonin se ishte detyrë patriotike për çdo të ri dhe të re të merrte pjesë në aksion, sepse kësh-tu ndërtohej atdheu e socializmi. U tregonin se po të shkonin dhe ato në aksion, do t'u hapeshin sytë, do t'u ndritohej mendja. I ftonin që të bashkoheshin në skuadrat kolektive të punës, i shtynin të vinin në kurset kundër analfabetizmit. Punonin, agjitonin. Populli i donte dhe i respek-tonte, bile Martën e zgjodhën anëtare të këshíllit popullor të rrethit në Mirditë dhe rinia e kish anëtare të byrosë së organizatës.

Kaluan pak muaj dhe Prenda u fejuua e u martua me një burrë në fshat që quhej Pjetër Zefi. Në atë kohë ai punonte si një nëpunës i thjeshtë dhe kish lidhje me bandat reaksionare, të cilat i ndihmonte. Prenda nuk e dinte. Asnjë në fshat nuk e dinte.

Prenda, pasi u martua, nuk e ndërpreu aktivitetin e saj me rininë e ish një e re komuniste e dalluar dhe e vendosur. Kjo gjë shkaktoi mos-marrveshje në shtëpi. Pjetri me marifet i thoshte Prendës të hiqte dorë nga puna shoqërore, sepse ajo ishte grua e duhej të merrej me punët e shtë-pisë. Ç'i duhej asaj të këndonte e të kërcente bashkë me rininë? Përse të vinte në hekurudhë? mjaft

kishte qenë, le të punonin të tjerat. Pastaj nuk e shikonte Prenda se reaksioni ishte egërsuar e mund ta vriste?

Prenda i përgjigjej se nuk mund të ndalej në mes të rrugës. E sqaronte atë se ajo ishte jo vetëm gruaja e tij, por dhe anëtare e rinisë komuniste, organizatë luftarake që e drejtonte Partia, dhe si e tillë nuk i kish hie të trembej nga kërcënimet e të strukej pranë vatrës. Detyra e saj, e shokëve dhe e shoqeve të saj, ishte të zgjonin popullin, ta bindnin, t'i tregonin rrugën e partisë e ta mobilizonin në realizimin e detyrave të planit. Pastaj, ajo, si femër, kish dhe detyra të rëndësishme ndaj shoqeve të saj, grave të fshatit, të cilat ishin analfabete të mbyllura mes katër mureve.

Si nuk arriti ta bindëte dot Prendën, i shoqi filloi të gjejë shkaqe e të grindej me të.

Kaluan muaj e reaksioni pësonte disfata. Por çdo ditë më shumë ai egërsohej e në tërbim e sipër ngrinte pushkën e qëllonte njerëzit e pushtetit e të partisë, luftëtarët e dalluar të ndërtimit socialist.

Edhe në portat e shtëpisë së Martës e Prendës u dukën letra të zeza. Në to, me fjalë të ulta, reaksioni i kërcënonte të ndërprisnin aktivitetin, të heshtnin. Ç'u duhej atyre të merrnin pjesë në organizatën e rinisë komuniste? — thuhej në këto letra. Ato mbaronin me këtë kërcënim: «Në rast se nuk e ndërprisni aktivitetin tuaj, do të pushkatoher!».

Prendës e Martës, Mrikë Lokes e shumë të tjerave, u thoshnin të hiqnin dorë nga rruça, nga ide-

ali i tyre. Por për to ishte më e shtrenjtë rruga, ideali i partisë, se sa jeta e tyre. Më mirë të vdisnin se sa të frikësoheshin para armiqve të urryer.

Si trimëresha ato punonin me të rejat, me gratë, me gjithë popullin. Marta ishte dhe një kopshtare e zonja dhe e apasionuar. Në kopshtin e saj shikoje perime që nuk i njihte njeri në Mirditë, që nuk i përdorte njeri për t'i ngrënë. Krahas rritjes së fëmijës dhe punëve të tjera të shtëpisë e të organizatës, ajo punonte dhe me bel e me shatë.

Armiqtë tërboheshin. Në një mbledhje të fshehtë, kur mirrte pjesë edhe Prenda, i kunati i Prendës, u vendos që Marta dhe Prenda të vriteshin me tortura. Prenga kish këtu rolin më të poshtër e më të ndyrë. Nëpërmjet tij do të hynin bandat natën për të marrë Prendën dhe Martën. Ndryshe nuk bëhej. Ata kishin frikë nga populli dhe forcat e sigurimit që ta bënë këtë gjë ditën. Në ato ditë Prenga hapi fjalë se do të shkonte për të gjetur nuse për të vëllanë, ndaj i duhesh një xhaketë, një palë pantallona, këpucë dhe një sahat. Ndër njerëzit e fshatit mbledhi ato që i duheshin dhe u nis. Njerëzit kujtuan se shkonte për qëllime kru-shqie dhe e ndihmuan.

Një natë prilli të vitit 1948 Prenda me Martën ishin kthyer nga një mbledhje. Aty ishin shtruar probleme me rëndësi të fushatës së pranverës, puna me skuadrat kolektive, regjistrimi i vullnetarëve të rinj për në hekurudhë, si dhe shumë detyra të tjera.

Aty nga ora 10,30 të natës, në shtëpinë e

Prendës, u ndjenë këmbët e shqerrave të trembura. Plaku i shtëpisë, vjehri i Prendës, doli.

— Kush asht?

— Jam Prenga, — foli i biri.

Plaku çeli derën. Në kullë hynë nja 8 burra të armatosur. Prenda kish rënë të flejë.

— Çohu! — i foli i kunati me zë të ashpër. — Na gatuej bukë për miqtë!

Prenda u çua dhe një parandienjë e keqe i shkoi në mendje: «Ç'janë këta? Ç'duen kaq vonë?» Ajo u çua e përgatiti darkën për miqtë e vonuar. Ndërsa punonte mendonte: «Po ky u nis për nuse?»

Ku ta dinte ajo se ç'krim po përgatitej!

Si morën bukën në. do strajca, një nga kriminelët me armë në duar i bërtiti:

— Shtërngohu (vishu) dhe hajde me ne! — Këto fjalë qëlluan si me kamzhik plakun e shtëpisë dhe Prendën.

— Preng! — foli i jati, — ku don me e çue?

— Në hekurudhë! — u zgërdhi Prenga — Po, në hekurudhë. Pse, s'ke qejf, oj Prendë?

— Po kam! — foli Prenda që e kuptoi se ata donin të talleshin me të. — Kam posi! — theksoi ajo duke ngritur zërin e saj. Me këtë donte t'u tregonte se s'ua kishte frikën.

Dhe ata burra të armatosur patën frikë nga ajo grua e re njëzetvjeçare, patën frikë nga rinia e saj e zjarhtë, prandaj e lidhën. Plaku nuk duroi dhe u hodh, por dhe atë e morën të lidhur, ashtu si morën dhe djalin e vogël dymbëdhjetëvjeçar që të mos mbetej njeri e të tregonte. Ecnin në heshtje.

Ja dhe shtëpia e Martës. Asaj iu dhimb Marta, në shtëpinë e tyre nu kish asnjë mashkull. Ah Prenga! E dinte ai që vetëm Marta me të vjehrën ishin, ndaj ecnin kaq serbes. Desh të bërtasë, të thërrasë. të shpëtonte Marta, shoqja saj e të rriste fëmijën, atë Pashkën dyvjeçare. Po si të thërriste, kur gojën ja kishin lidhur me peshqir? S'u mbetej rrugë tjetër veçse të qëndronin të dyja, si shoqe pranë njëra tjetrës.

Kryebanditi me të tjerët u fshehën pasi i thanë Prengës që të fliste.

— Oj Marë, oj Marë! Çile derën!

— Kush je? — u dëgjua pas pak zëri i përgjurmur i plakës.

— Jam Prenga. Kam ardhë me Gjonin.

Plaka u gënjye. Mendoj se kishte ardhur i kushëriri me të birin, burrin e Martës. U çua dhe hapi derën.

Ata hynë brenda, të egër e të armatosur.

— Hajde Martë e merrja nji valle! — i folën ata me cinizëm. Ishte e vërtetë se Marta kërcente bukur dhe ishte e para që niste vallet në fshat. Gjithë rinia e fshatit mblidhej, këndonte e vallzonte. Ishin valle të bukura, me tekste revolucionare, që demaskonin reaksionin, armiqtë, tekste që ngrinin lart frymën luftarake e i mobilizonin për fitore. Këto, programe artistike të thjeshta, grumbullonin njerëzit përparimtarë rreth partisë dhe i largonin nga reaksioni e nga opiumi i fesë.

Marta e kaloi për një çast këtë vegim të bukur të aktiviteteve të rinisë dhe mendoi fëmijën, foshnjën e saj të vogël. E mori vetëtimthi dhe e rroku në grykë. Nuk tha asnjë fjalë, s'donte të

tregohej e dobët përpara armiqve të egër të saj, të pushtetit të saj e të ardhmes së Atdheut. Por foli zemra e saj, zemra e nënës, që dridhej nga emocionet e forta, nga mallëngjimi i ndarjes për gjithmonë nga loçka e zemrës së saj.

— Çohu Martë! Asht nata jote sot!

Kush foli kështu? Ishte e vjehra, Mara, ajo grua burrneshë që kish frikë se mos nënës së re i ligshohej zemra. Por jo! Zemra e luftëtares doli më e fortë se zemra e dhëmbsur e nënës dhe foli: «Unë do të vdes, por ti, moj bija ime e vogël, do rritesh e lumtun, për ty do të mendojë partia. Këta do vdesin me turp, ferrave.»

Ngriti kokën lart, i dorëzoi foshnjën së vjehrës dhe u nis. Në errësirë u takua me shoqen e saj të ngushtë, me Prendën. I lidhën të dyja dorë më dorë dhe i nisën. Pylli ishte i freskët. Marta dhe Prenda e kuptuan se për to kish ardhur fundi, kishte ardhur çasti t'u tregonin se, ashtu siç kishin ditur të punonin e të luftonin për idealin e partisë, dinin dhe të vdisnin.

Po, do të vdisnin në këtë natë prilli, kur gjithë natyra qe gjallëruar e arat prisnin përmendën, kur shokët e shoqet e tyre punonin në hekurudhën e dytë, Durrës-Tiranë. Sa kishin dëshirë ato të vinin atje, të punonin e të këndonin me gëzim, ashtu siç punohet e këndohet në aksione!

Ja livadhi, ku sa e sa herë kishin kullotur tu fën e dhenve. Këtu siç duket do t'i kosiste vdekja nga duart e xhelatëve të shitur tek imperializmi.

Pse i prunë gjer këtu? Dëshën t'i gjunjëzonin, deshën t'i dërmonin moralisht, t'i fyenin e t'i poshtëronin... Le t'ja lemë më mirë këtë skenë



letrës që zumë në gojë në krye të këtij shkrimi, e që, siç thamë, është shkruar tetëmbëdhjetë vjet më parë.

«Në datën 25 prill 1948 në orën 10,30 të natës, një bandë kriminelësh prej 8 vetash, shkoi në shtëpiat e të rejave komuniste Martë dhe Prendë në katundin Malaj të rrethit tonë. Kriminelët i morën të lidhura Martën dhe Prendën duke u thënë: «Do t'ju pushkatojmë, mbasi na kini prishur zakonin, pse kini shkuar në hekurudhë dhe doni të shkoni dhe sivjet; nga ana tjetër do të merrni dhe shoqe të tjera në aksion». Mbasi i shanë, i morën dhe i larguan 100 metra nga shtëpiat e tyre, kriminelët i torturuan në mënyrat më barbare duke u çarë me thika gjoksin, duke u prerë gishtat e dorës, duke u prerë dhe fytyrat e tyre me thikë. Qëndrimi i të rejave komuniste, si Martës të Gjon Tarazhit, të cilën e kishin torturuar edhe më tepër se sa tjetrën (Prendën e Pjetër Zefit) ka qenë shumë i rreptë kundrejt kriminelëve. Ato i shanë dhe me gjithë torturat që u bëheshin, u thanë se ishin të poshtër vetë, dhe se nuk e kishin prishë zakonin e vendit, pse kishin shkuar në hekurudhë, por përkundrazi e kishin ngritur lart, pse kishin punuar për ndërtimin e vendit të tyre. Zakonin e keni prishë ju, që vini dhe na vrisni në grave të pambrojtuna, ju jeni armiq të betuem të popullit dhe të Pushtetit tonë. Bani veprën tuej kriminale, të poshtër, se ne nuk kemi asgja të për-bashkët me ju».

Banda e kriminelëve me revolver dhe me pushkë u ra në kokë dhe ua prishi gjithë fytyrën.

Mbasi i vranë të rejat komuniste, kriminelët

u larguan, duke lënë një letër, e cila thoshte se i kishin vrarë të nalt-përmendurat (Martën dhe Prendën) pse kishin shkuar në hekurudhë, dhe kishin mobilizuar të rinjtë dhe të rejat në kurset kundra analfabetizmit dhe në skuadra të punës kolektive. Gjithashtu kishin dalë vullnetare prap sivjet, duke dashur të marrin dhe shoqe të tjera me vete. Mbas pak ditësh, aty nga data 5 maj 1948 kriminelët kanë vënë dhe një letër tjetër me po atë përmbajtje në atë vend ku kanë vrarë të rejat. Ky krim që është bërë nga ana e bandës kriminale, ka vetëm e vetëm këtë qëllim: të pengojë të rejat që të mos regjistrohen vullnetare për në aksion. Dhe fill mbas vrasjes së dy të rejave komuniste nga katundi Malaj, kriminelët kanë hedhur parullën: «Kush të punojë në këtë drejtim, do t'i vrasim sikur ato të katundit Malaj. . .»

Një krim i tillë i poshtër s'kish ndodhur kurrë në malësi. Kurrë kaq burra s'ishin mbledhur rreth dy femrave, kurrë! Ata që ishin më pranë livadhit dëgjuan fjalët e tyre të fundit, plot besim dhe krenari:

*«Qëlloni! Do t'na e marrin hakun!
Tërhiqe Prengë! Se edhe ty do të ta tërheqin!»*
— *kish thënë Martu.*

Pa gdhirë vajti lajmi. Mirdita u ngrit në këmbë e revoltuar. Gjithë fshati mori pjesë në varrimin e tyre, gjithë fshati u betua. Ende jetojnë fjalët e vajtueshme, fjalët e gruas plakë Mara Cup Marku. Ajo ligjëroi kështu për Martën:

*Ta dinë mirë, qent e tërbue,
që të kan' pre e t'kan' shkatrrue,
se tarazhve s'kan' me u pshtue,
gjall' o vdek' kan me të pague.*

*Cucat tona janë shtërngue!
Në aksione prap me shkue;
e me dit ku ke punue,
ku ke fol' ku ke liqjrue,
e nji fjal' kan me ta çue:
se hekurudhën e kemi mbarue!*

Dukej sikur reaksioni ishte i fortë, por ndodhte e kundërta, këto ishin shënja të dobësisë së tij. Fill pas kësaj ngjarjeje u ngrit shkolla në fshat. Në brigadat vullnetare shkuan pas kësaj jo 3-4 vajza, por 36 që e dinin se reaksioni do vërsulej mbi to, por që njëkohësisht ishin të bindura se armiqtë i kishin ditët e numëruara, se në fund lufta me klasat e përmbysura, do të përfundonte me fitoren e së resë, revolucionit.

«Lajmi i vrasjes barbare të Martës dhe Pren-
dës na pikëlloi shumë, tregon një ish vullnetar i
brigadës «Heronjtë e Vigut» — Punonim aherë në
Sukth, në hekurudhën e dytë, 5 ditë me radhë as
kënduam as kërcyem, mbanim zi për to e punonim
me shpirt në dhëmbë, me urrejtje e duf të madh.
Pas 5 ditësh komunistja Mrikë Lokja na tha:

«Mjaft vajtuem shoqet tona. Do të këndojmë për
inat të anmikut. Le ta marrin vesh se ne jemi të
pamposhtun, se Mirdita asht e partisë, se reaksioni
e ka humbun davanë».

Edhe Mrika pati fatin e tyre. Pas kthimit nga

aksioni ajo u vra në një mbrëmje qershori të po atij viti. Po kthehej nga një mbledhje dhe shokët i thanë të mos shkonte vetëm në shtëpi, se nuk u dihej bandave që ishin rreth e rrotull. Mrika e quajti si shenjë frike dhe u nis natën përmes pyllit. E zunë dhe pas torturave e vranë komunisten Mrikë Lokja, këtë grua heroike të Mirditës.

Po dhe armiqtë nuk mbetën pa u ndëshkuar.

I shoqi i Prendës, megjithse ishte i maskuar mirë, u demaskua dhe u arrestua disa muaj më pas, si bashkëpunëtor me kriminelët, dhe mori dënimin e merituar. Po Prenga? Dhe ai nuk shpëtoi. U vra në Ujë Lurth. Në atë përpjekje ra heroikisht Pal Mëlyshi, heroi i popullit, i cili ishte futur dhe luftonte në strofkullën e banditëve.

* * *

Dhe rrodhën vite... Revolucioni, si një lavë e zjarrtë, përvëloi dhe fshiu nga faqja e vendit tonë bandat kriminale të reaksionit të përmbysur... Kaluan vite. Tani Mirdita është bërë një rreth i metalurgëve dhe i minatorëve trima. Shkollat janë ngritur kudo dhe bijtë e bijat e saj marrin dituri. Po ku është ajo Pashkja e vogël, që nëna e re, Marta e la dy vjeçe?

Pashkja, që mbeti jetime në moshën dy vjeç, është nxënëse në shkollën pedagogjike «Shejnaze Juka» në Shkodër. Vajza e një dëshmoreje është nxënëse në shkollën që mban emrin e një dëshmoreje të Luftës Nacional-Çlirimtare! Një ngjarje e rastit, por që tregon se femra shqiptare në çdo kohë ka vaditur tokën amtare me gjakun e saj.

Mora dhe çfletova disa nga hartimet e Pashkës. Ja se ç'lexova ndër të tjera:

«Në shtigjet e maleve, në rrugën ku shkojnë autmobilat, në qytetin e vogël të minatorëve, në follenë e gjeologëve, kudo do të takosh gramirëditore me fustanin e tyre të bardhë e me jakë të qindisura. Ato të dalin shpesh përpara sysh te shtegu që mezi duket, nga lisat e borigat, me djep të ngarkuar në shpinë ku hap sytë një njeri i vogël.

Mue gjithmonë më ka tërhequr jeta e nënave tona, që kanë lindur e rritur fëmijët e tyre, që u kanë fshirë plagët vëllezërve, bijve të tyre, që u kanë pastrue armët dhe që u kanë dhënë ushqim. Janë këto nana që kanë rritur fëmijët, duke hedhur farën në arë dhe duke prerë dru në pyll. Unë jam nga ky fshat, nga këto boriga, unë jam ajo që u rrita në atë djep shekullor. Në këtë dimër ulur mbi bangë, dëgjoj dhe shkruaj për nanat, për këto burime të mëdha të jetës. Unë jam nga këto male, që lashë fshatin dhe mora rrugën për në shkollë, ku do mësoj me zell për të marrë sa më parë maturën, për t'u bërë mësuese».

Pashkja ka shkruar dhe shumë vargje të frymëzuara nga jeta e vrasjes tragjike e nënës. Në strofat spikat dhëmbja e saj për nënën që nuk e pa deri në fund frytin e punës së saj, dashuria e saj për rrugën e nënës, besnikëria ndaj nënës së madhe, Partisë.

Pashkja ishte në aksion, në aksion si e ëma. Punoj si e ëma, derdhi djersë si ajo dhe doli tre herë sulmuese. Edhe sivjet ajo ishte ndër të parat që shkoi në aksion. E bija ecën në rrugën revolucionare të nënës së saj. Gjithë rinia jonë ecën në rrugën e lavdishme të prindërve dhe brezit të Luftës Nacional-Çlirimtare për ndërtimin e Atdheut socialist.

(«Zëri i Rinisë» Korrik 1966)

VATH KORESHI

PER ATË QË RA NË KUFË

«... Kanë kaluar vite të tëra, shumë
ujra kanë rrjedhur qysh atëhere
drejt detit të gjërë, po lapidari që
ngrihet aty mbi tokën e murrme
vazhdimisht tregon për një shok të
rënë e të paharruar.»

Lapidari

Në bregun e majtë të Bunës, buzë ujrave që rrëshqasin nga dalë drejt perëndimit, në mezin e një lëndine të vogël rrethuar me shelgje, ndodhet një lapidar. Kanë kaluar vite të tëra, shumë ujra kanë rrjedhur qysh atëherë drejt detit të gjërë, po lapidari që ngrihet aty mbi tokën e murrme vazhdimisht tregon për një shok të rënë e të paharruar. Vendi pranë lapidarit është i qetë, pranë tij vigjëlojnë kufitarë të rinj me zemrën zjarr e syrin pishë e gjethet e drurëve shushurijnë, sikur të këndojnë lehtë këngë trimërie, këngë burrash që japin dhe jetën për të mbrojtur tokën mëmë. Lapidari duket si një kufitar i ngurosur aty buzë ujrave të lumit e sikur përjetësisht mbron kufitë e atdheut të shtrënjtë. Ai vigjëllon aty natë e ditë së bashku me kufitarët e rinj, të cilët herë mbas here hedhin sytë në faqet e tij të bardha e lexojnë me një ndjenjë nderimi të thellë shkronjat e skalitura në to: «Në luftë me armiqtë e popullit, këtu ra më 28.X.1953 tetar Myzafer Lipellari».

Myzaferi ra që të mos prekej toka e shenjtë e Atdheut nga këmba e shkelësit armik, ra që vajzës së tij të vogël të mos ja prishte kush ën-

drat e ëmbla fëminore atje në fshatin e largët, që në tokën mëmë të gumëzhijë, jeta, gëzimi, puna.

Fëmijëria

Myzafer Lipellari lindi në fshatin Vloçisht të Korçës në vitin 1931 nga një familje e varfër fshatare.

Myzaferi ish një çunak i shkathët. Ai vinte i gjatë nga trupi, me kërcinj të hollë e të dobët e me ca flokë ngjyrë kërpi. Dëshironte të mësonte, të bëhej njeri i ditur, po asokohe kishte pak shkolë, kështu që ëndra e çunakut mbeti në rrugë.

Një ditë, kur pranvera sapo kish hyrë e nëpër gardhiqe kishte plasur lulja e ferrës dhe Myzaferi me dy shokë kishin nxjerrë gjënë andej nga Lumishtja, në xhadenë që shkante buzë kodrave u dëgjuan zhurma motorësh. Pastaj u duk një autokollonë makinash e mbi to një mori ushtarësh me helmata në kokë.

Të vegjëlit mbajtën frymën, u strukën mbas drurëve e nisën të shohin me çudi këtë vargan të gjatë makinash që s'kishte të sosur. Ata kurrë në jetën e tyre s'kishin parë kaq shumë kamionë, kaq shumë ushtarë me helmata, me bajoneta të zbërthyera dhe me uniforma jeshile. Mendja dhe ndërgjegja e të vegjëlve u rëndua nga kjo uturimë, që vinte si hie e zezë, e pushtonjësve të Italisë fashiste që robëruan vendin.

Kamioni i fundit u zhduk në kthesë, atje mbas kodrave, e djemtë të frikësuar mblodhën lopët e u nisën për në fshat.

Myzaferi nisi të ndjejë dalngadalë urrejtje për këta ushtarë me bajoneta të zberthyera që nisën të duken gjithmonë e më shpesh në fshatin e tij.

Kaluan kohë. Në male u ndez lufta për liri. Djem më të rritur se Myzaferi linin fshatin e shkonin në çeta. Gjithmonë e më shpesh dëgjo-heshin krismat e luftës, gjithmonë e më shpesh vinin lajme se partizanët korrnin fitore të njëmbasnjëshme. Kjo valë lufte e rrëmbeu dhe Myzaferin njëmbëdhjetëvjeçar. Shpesh do ta shihje këtë çunak shtatëhollë që rendëte shtëpi më shtëpi, mbliidhte bukë, i fuste në torbë dhe ua çonte partizanëve andej nga Klosi, Damjaneci, Porodina e kudo që të ishin.

Urrejtja për pushtonjësit, në zemrën e Myzaferit, arriti kulmin një ditë kur ata i vunë flakën gjithë fshatit.

Kjo ndodhi në vitin 1943.

Ishte koha, kur Italia fashiste tërhiqej nga vendi ynë e ja lëshonte vendin një pushtonjësi më të egër e më gjakatar, Gjermanisë naziste. Italianët në atë kohë qenë rrethuar në fushën e Maliqit nga forcat partizane e ata as për në Korçë s'mund të tërhiqeshin dot e as për në Elbasan s'mund të niseshin. Vendi u hiros nga moria e ushtarëve që ishin mbërthyer në darë, nga armatimet dhe automjetet e tyre. Një natë partizanët sulmuan mbi këta ushtarë, luftimet zoiatën gjer në mëngjes e nga ky luftim armiku pati shumë humbje. Për t'u hakmarrur, italianët i dogjën fshatrat për rreth. Fshatin e Myzaferit, Vloçishtin, e bënë pothuaj shkrumb e hi.

Dhjetra e dhjetra familje mbetën pa strehë, pa rroba, pa ushqime. Tymi i shtëpive ngrihej me pikëllim drejt qiellit të hirosur dhe shpërndajej pastaj i shtyrë nga era tej e mbanë kënetës së Maliqit. Trarët stërgjyshor të shtëpive të vjetra këputeshin e rrëzoheshin nga zjarri, duke lënë shkretë trojet ku mezi mbahej e rridhte ieta e fshatarit të varfër. Brënda një dite gjithë fshati qe kthyer në një gërmadhë të trishtuar, nëpër muret e rënuara, të të cilit lëvrinin si hie njerëzit e mbetur pa strehë. Plakat mallkonin e nduknin faqet e vijëzuara nga brazdat e rrudhave, gratë qenë hutuar e mundoheshin të qetësonin çiliminjtë e tromaksur, kurse pleqtë rrinin në këmbë e vështronin me dhëmbje e me dhëmbë të shtrënguara. Kjo flakë kish rënë si një kob që e ngriti peshë urrejtjen e të gjithëve për pushtojësin që vinte si hajduti e rënonte gjithshka të shtrenjtë e të dashur që ishte në jetën e tyre.

«O zot, zhurite me rrufe dorën e katilit» — mallkonin plakat. «Digje e frugulloje, o perëndi e madhe, hasmin e vatanit, që na la në mes të katër rrugëve.»

Po dora që mori hak, nuk qe dora e zotit. Kjo dorë ishte dora e partizanëve, dora e partisë, dora e vetë popullit, që më 29 Nëntor të vitit 1944 i përzuri pushtojësit e huaj e shpartalloi armiqtë e brendshëm. Mbi Shqipëri zbardhi drita e lirisë.

Përmes këtyre ngjarjeve të stuhishme kaloi fëmijëria e Myzafer Lipellarit, përmes këtyre ngjarjeve që brumosën në zemrën e tij dashurinë për popullin, për Atdheun dhe urrejtjen për armiqtë.

Vitet e para

Tashti në Atdhe nisi puna e rindërtimit dhe e ndërtimit. Vloçishti kish mbetur gërmadhë e ai duhej ndërtuar që të fusnin kokën kaq e kaq familje të mbetura jashtë. Ishte viti 1945. Myzaferi asokohe ishte katërmbëdhjetë vjeç, pat lëshuar shtat e trupi i tij i hollë po mbushej. Atij i pikonte në zemër kur shikonte familjen e Rakip E, të një bashkëfshatari, që qe mbledhur në një qose të shtëpisë së djegur e jetonte si mos më keq. Rakipi ish i vetmi mashkull në atë shtëpi, djemtë i kish të vegjël, e as që kishte kohë ta rindërtonte shtëpinë.

Atëhere Myzaferi bisedoi me disa shokë e vendosën që ta ndihmojnë Rakipin. Mbrehën qetë në qerre e nisën të mbartin gurë. I prunë në oborrin e Rakipit e nisën t'i shkarkojnë.

— Për kë i keni këto, mor djem? — i pyeti i zoti i shtëpisë.

— Për ty, o xha Rakip, — i thanë ata.

— Ja, tashti ne do të të ndihmojmë që të ndërtosh shtëpinë.

Fshatari s'kish se si t'i falënderonte këta djem që kujdeseshin për të. Ai mori zemër nga kjo e qysh atë ditë u dha me mish e me shpirt t'u bënëte kalamajve një strehë të mirë. Myzaferi me trekatër të rinj të tjerë i afruan gurët, qerestenë, e ndihmuan të ngrinte muret e më në fund shtëpia e Rakip E. u ngrit në këmbë.

Ata ndihmuan dhe disa familje të tjera e për këtë fshatarët nisën ta duan e ta çmojnë shumë Myzaferin me shokë. Të rinjtë e fshatit, bashkë me

ta dhe Myzaferi, bënin punë vullnetare në ndër-
timin e rrugëve, në rregullimin e oborreve, në
hapjen e kanaleve, etj.

Gjatë kësaj kohe Myzaferi nisi të mësojë në
shkollën e natës. Drita e diturisë nisi të hedhë rre-
ze në mendjen e tij. Ai kish vullnet e dëshirë të
madhe për t'u bërë njeri i ditur, e darkave, mbas
punëve të lodhëshme të ditës, merrte librat në sqe-
tull e vraponte për në shkollë. Myzaferi e kupton-
te se për njeriun nuk është kurrë vonë që të më-
sojë, prandaj ai me këmbëngulje e vullnet të for-
të, rrudhte ballin mbi fletore e përpiqej të mëson-
te shkronjat. Ai ish një nxënës i mirë. Mësonte në
shkollën e natës bashkë me një shok të vegjëlisë,
së tij, me Kahreman M. «Si delnim nga shkolla,
tregon Kahremani, shkonim në shtëpi e i prega-
titnim që atë natë mësimet për të nesërmen. Ai
ish këmbëngulës e nuk i lëshonte librat nga dora
gjer sa tjetri ta kuptonte mirë mësimin. Të nesër-
men çoheshim herët për t'u marrë me punë të buj-
qësisë apo me punë shoqërore.

«Në vitin 1946, si në gjithë Shqipërinë, dhe
në Vloçisht u bë reforma agrare. Myzaferi pesë-
mbëdhjetëvjeçar ditët që u ndahej toka fshatarë-
ve ish shend e gaz. Ai shkonte poshtë e lart arave
e dëgjonte nga fshatarët që bisedonin: «Ja, më
në fund, ua morëm tokën afendikojve të Korçës.
Erdhi koha jonë. Tashti e tutje toka është jona,
atë na e dha pushteti popullor».

Kështu Myzafer Lipellari nga dita në ditë rri-
tej si njeri e si karakter. Tashti ushtarët me helme-
ta e me bajoneta të hapura qenë shporrur një he-
rë e përgjithmonë, bejlerëve dhe agallarëve u qe

marrë toka e në fshat kish nisur një jetë e gjallë dhe e gëzuar. Ai e ndjente thellë se njeriu duhet të bëjë çmos për të mirën e të gjithëve, për lulëzimin e kësaj jete, që kish nisur në vendin tonë. Dhe Myzaferi nuk e kursente veten për të shkuar atje ku e thërriste detyra si i ri e patriot.

Kahreman M. tregon:

«Në vjeshtën e vitit 1947 nga fshati ynë e nga fshatrat përreth, Bulgarec, Sovjan, shkoi një brigadë vullnetare në punimet për tharjen e liqenit të Maliqit. Më kujtohet se u nisëm nga fshati bashkë me Myzaferin në një ditë me shi. Rrugës i thosha Myzaferit: «Si ta pret mendja ty, a do të thahet me gjithë mend Maliqi?». Myzaferi buzëqeshte e më thosh: «Po, ti Mane, si thua?» Unë mblidhja supet e thosha: «Po, me sa ma ha mendja mua, them se do të thahet. Më kot s'mundohet gjithë ajo mizëri me lopata, kazma, karroca e me makina».

«Po, po — ma priste Myzaferi, — do të thahet, ma thotë mendja, o Mane. Ja, me këta sy kemi për ta parë fushën që do të dalë pas largimit të ujrave nga kënetat».

Brigada jonë u caktua të punojë në korrjen e shavarit për të mbuluar fjetoret e vullnetarëve në grykën e lumit të Maliqit. Arritëm në vendin e punës në mbrëmje. Shiu binte, vullnetarët qenë lagur e qenë lodhur. Myzaferi pikonte sikur të qe kredhur në një pellg me ujë, po ai nuk ankohej kurrë. Të nesërmen ja nisëm punës për korrjen e shavarit. Puna ishte shumë e rëndë: Duhej futur gjer në bel në ujrat e kënetës e aty të korrje. Ish-te vjeshtë, moti kish marrë për ters, nga dita në ditë ftohej e herë-herë mëngjeseve kish ngrica. U

fut në ujë dhe Myzaferi. Ai u çvesh, mori drapërin dhe hyri në kënetë duke u thirrur të tjerëve: «Hajdeni, shokë! S'është dhe aq ftohtë. Ne jemi bujq e kushedi sa herë kemi korrur shavar për vete. Tashti duhet të punojmë më shumë».

«Kur vinte darka ktheheshim për në baraka të qullur e të këputur fare. Hanin darkë e si e merrnim pak veten, Myzaferit i pëlqente të këndonte. Ai këndonte mirë e më thosh t'ja merrja unë i pari. Këndonim:

*«Ku mërzen cjapi me zile
Atje fryn veriu me erë
Për atje qan zemra ime
Të rrijë një copë herë».*

«Në mes të vetullave i sajohet një rrudhë kur këndonte e zërin e kish të ëmbël e të ngrohtë. Gjumin e natës e bënte të lehtë.

«Në Maliq punuam dy muaj. Unë mbeta atje, kurse Myzaferi iku, se e kishin caktuar në këshillin e lokalitetit. Ai ish i zoti dhe organizator i mirë. Gjithmonë që marrë me punët e fshatit e sidomos me rininë. Mbas çlirimit ai shkante shtëpi më shtëpi dhe bënte agitacion që të shtoheshin radhët e rinisë me të rinj dhe të reja. Asokohe vajzat nuk dëgjonin të bëheshin anëtare rinie, shpesh Myzaferi mërzitej e dëshpërohej nga kjo gjë, po nuk hiqte dorë nga qëllimi i tij. Shumë herë e pata parë duke organizuar grupe të rinjsh për të ndërtuar rrugët e fshatit, çezmat, shtëpitë e rrënuara nga lufta. Pastaj, në dimrin e vitit 1950 ai iku ushtar e qysh atëhere s'u pamë më...»

Kështu ka luan vitet e para të çlirimit të Myzafer Lipellarit, vite të ngjeshura me plot punë shoqërore për të mirën e vendit dhe të bashkëfshatarëve të tij. Herë në punë vullnetare, herë duke dhënë ndihmë shoqërore, herë në punët e rinisë, si anëtar i rinisë komuniste, herë si drejtues i pushetit lokal, ai fitoi respektin dhe dashurinë e të gjithëve, u kalit me një ndërgjegje të lartë dhe gadishmëri të plotë për t'i shërbyer popullit kudo që të paraqitej nevoja.

Në ushtri

«Në vjeshtën e vitit 1950 mua dhe Myzaferin na thërritën ushtar. Ishim të dy të një moshe, të dy nga një fshat.» Kështu i nis kujtimet e tij për Myzaferin Skënder B.

«Nga Korça u nisëm në mëngjes herët. Më kujtohet si tashti se Myzaferi qe ulur aty pranë meje e ishte i heshtur. «Ç'paske kështu sot?» e pyes. Ai qeshi një çikë e më tha: «Si të them... se si më vjen...». Unë e kuptoja mirë atë... Doemos, ai nuk mërzitej se shkonte ushtar; po Myzaferi ishte ndryshe nga unë. Unë isha beqar, e për beqarin është më lehtë të shkëputet nga familja, kurse Myzaferi para një viti ish martuar, kishte një vajzë të vogël e doemos i vinte mall për çupën që e linte në fshat. «E, se mos vetëm ti ke çilimi — i them — kur të kthehesh vajzën do ta gjesh të rritur».

«Jo — më thotë, duke dashur ta fshehë mallin e tij — s'e kam për atë, jo». Po si kaluam

Pogradecin, ai erdh e u çel e ja nisëm këngës në makinë.

Mua me Myzaferin na çuan në shkollën e instruksionit. Në këtë shkollë ne përgatiteshim për 'tu bërë roje të kufirit. Mësimet kishim shumë e na dukeshin të zorshme kiamet, sepse kalemit s'ja thonim sa duhej. Po Myzaferi më jepte zemër: «Po s'mësuam tashti, s'kemi ku mësojmë më për të ruajtur kufirin. Pra, o burra se kur të vijë provimet do mbetemi për turp». Dhe përpiqeshim e mundoheshim me të gjitha forcat. Në shkollën e instruksionit, përveç lëndëve speciale, bënim edhe mësim politik e këtu Myzaferi ish i fortë, studjonte me zell, dhe, kur diskutonte, mendimet i kish të qarta dhe të rrjedhëshme.

«Mbas disa muajsh shkua në kufi, në Shkodër. Po nuk qëndruam bashkë. Mua më çuan në Vermosh, kurse Myzaferin në postën kufitare të Rrushkullit».

* * *

Shkurt i vitit 1951. Për në postën kufitare të Rrushkullit shkojnë një varg ushtarësh të rinj, që ecin anës gjerdheve, buzë Bunës, nën degë shëlgjesh. Fusha është e ftohtë dhe e mbytur nga ujrat e dimrit, diku mbi sipërfaqen e hirtë të lumit fluturojnë rosat e egra që nxitojnë për nga kënetat e Muriqanit.

Midis këtij rreshti djemsh të rinj veshur me kapota, është dhe Myzafer Lipellari. Në këtë rruge me baltë nis e lidhet, si me fije të arta, një miqësi e madhe midis djemve, që vijë nga ana e

anës, fillon e zë rrënjë ajo miqësi e paharruar dhe e mrekullueshme e ushtarëve.

— Nga je ti, shok?

— Nga Skrapari.

— Po ti?

— Unë nga Berati.

— Brënda?

— Jo, nga fshatrat.

— O, qënkemi patriotë. Dhe unë nga Berati jam, nga fshatrat.

— Ore, a bën ta ndezim një herë?

— Shoku ushtar, mos je nga Tropoja ti?

— Ama, baltë...

Ata janë të gëzuar që janë bashkë, që do kalojnë një kohë të gjatë së bashku.

Mbrijnë në postë, lëshojnë torbat në stolat e menciës, dalin përjashta e pastrojnë këpucët nga balta. Aty pranë është kufiri, një pikë vrojtimi ngrihet si karakoll në atë qiell të hirtë e atje një ushtar qëndron i heshtur e vigjëlton. Ushtarëve të rinj u rreh fort zemra dhe ja kanë zili atij ushtari të regjur që vrojton atje lart. Ai kushedi sa herë ka hipur e ka ruajtur kufirin nga ajo pikë, kushedi sa net i ka gdhirë pa gjumë duke ecur poshtë e lart vijës së kufirit me veshët ngritur e me syrin pishë... Së shpejti atyre do t'u besohet të mbrojnë këtë copë vend të tokës shqiptare. Mendime e ndjenja të thella trazojnë shpirtin e të rinjve. Çfarë kurthesh ngre armiku? Nga përpisjet të hyjë? A do t'i pikasin gjurmët e shkelësve të liq që vijnë e prishin qetësinë e netëve tona?

Mendja atyre u shkon në të katër anët, po më në fund në zemrat e tyre triumfon besimi se

s'do t'u shpëtojë asgjë, se ata do të jenë bij besnikë e të pamposhtur para kurtheve të armikut.

Nuk ka kaluar një gjysëm ore që kanë ardhur aty, e si pa e kuptuar, i kanë rrethuar me dashuri ushtarët e vjetër. Kufitarët e regjur kanë fytyra të argasura nga era e nga dielli, në fytyrat e tyre spikasin qartë tipare burrërore, tipare të forta një-rëzish që vazhdimisht rrijnë zgjuar për t'ja prerë rrugën në çdo rast armikut. Pastaj kufitarëve të rinj u flet komandanti i postës. Ai i ka mbledhur ata në mence e u tregon detyrën e shënjtë që u është ngarkuar.

* * *

Ka kaluar një muaj që Myzafer Lipellari ka ardhur në postën kufitare të Rrushkullit. Një ditë atë e thirri komandanti i postës:

— Kufitar Lipellari!

Myzaferi u paraqit e komandanti e ngarkoi me detyrën e furnitorit. Ai duhej të merrte ushqime me mushkë nga Shkodra për postën e Rrushkullit.

Myzaferi ngrihej që në mëngjes, vinte mushkën përpara e nisej për në Shkodër, tri orë e ca rrugë me këmbë. Rruga ish tërë baltë, ajo herë dilte në breg të Bunës e herë futej nëpër ara. Ai shkonte e kthehej në mbremje vonë, herë i lagur e i përbaltur, herë me duar e fytyrë të ngrira nga të ftohtit.

Një natë ai sapo që kthyer nga Shkodra. Qe lodhur e lagur nga shiu që s'kish të pushuar asaj dite marsi. Hyri në fjetore e po hiqte këpucët që

të ndërronte pecet e këmbëve. Pak më tutje rën-
konte lehtë një kufitar.

— Ç'ke? — e pyeti Myzaferi.

— S'e di — i tha ai. — Po më shungullon trupi.
Më duket se kam ethe.

— A t'u them të të bien një çaj të nxehtë?

— Jo, jo, — tha ai. — Tashti do të dal me
shërbim.

— Po ti je me ethe! — ja pat Myzaferi.

Po ushtari s'u përgjegj. Ai u ngrit e nisi të
vishej.

— Rri, — i tha Myzaferi. — Po dal unë në ven-
din tënd.

— Jo, — i thotë ushtari.

Po Myzaferi e kapi për krahu, e detyroi të shtri-
hej në shtrat e vetë mori automatikun e shkoi në
grupin që do të dilte me shërbim.

Atë natë ndenji vonë, lodhja e këputi fare, po
ai s'jepej para vështirësive. Të nesërmen shkoi me
mushkë si zakonisht për ushqime.

Që prej asaj kohe ai e bëri zakon që shpesh të
dilte me shërbim sapo kthehej nga rruga. Kur ndo-
njëri ish i sëmurë, Myzaferi dilte menjëherë vull-
netar për ta zëvendësuar.

Një ditë e thirri komandanti i postës e i tha:

— Ju, kufitar Lipellari, s'do të dilni më me
shërbim. Detyra që kryeni është e vështirë, pra
duhet të çlodheni natën.

Po Myzaferi nguli këmbë se puna që bënte ai
s'ish aq e lodhëshme dhe se ai e ndjente veten të
aftë që edhe natën të mbronte kufirin.

Ishte një natë qershori. Në postën kufitare kish qetësi. Papritmas nga larg u dëgjuan ca zëra të mbytur. Myzaferi u ngrit nga shtrati dhe u vuri veshin zërave që dëgjoji. Dikush bërtiste, dikush thërriste për ndihmë.

Myzaferi zgjoi disa shokë, u vesh shpejt e shpejt e doli jashtë. Në fshatin aty pranë në Somrishtë, kishte rënë zjarri në shtëpinë e një fshatari. Flaka ngrihej lart e skuqte qiellin e asaj nate vere.

Myzaferi me shokët vrapuan drejt zjarrit. Për një çerek ore ata ishin atje e nisën luftën për të shpëtuar shtëpinë e fshatarit. Lufta me zjarrin vazhdoi një orë e ca, kufitarët u përcëlluan nga flakët, u përzhitën e u furgulluan, po më në fund e shuan atë.

Herë në roje të kufive të Atdheut, herë duke ndihmuar shokun, herë në kryerjen e detyrave që i ngarkoheshin, kështu kaluan vitet e shërbimit ushtarak të Myzafer Lipellarit. Aspektet nga kjo jetë janë të shumta, aspekte që tregojnë se si Myzaferi u rrit në këtë shkollë burrërie. Gjithmonë ai ruante në zemër dashurinë për vendin e tij dhe urrejtjen për armikun. Ai vigjëlonte në kufi. Sa e sa herë shkelës kufiri ishin përpjekur të hynin në tokën tonë, sa e sa herë ishin munduar ata të gjenin një shteg, po më kot. Myzaferi

dhe kufitarët e tjerë të postës kishin pikasur çdo lëvizje të tyre e kishin asgjësuar kaq e kaq banditë.

Shërbimit ushtarak po i vinte fundi. Sa e vështirë është të ndahesh nga shokët, sa e vështirë të ndahesh nga kufiri, gjatë piramidave të të cilin ke kaluar kaq e kaq netë, me të cilin je lidhur si mishi me kockën! Po ja, ata do të iknin e vendin e tyre do ta zinin ushtarë të tjerë, të ardhur nga ana e anës.

28 tetor 1953

Po të kalosh në komandën e kufirit në Shkodër, në këndin e lavdisë do të shohësh fotografinë e Myzafer Lipellarit, taserën e rinisë të shpuar nga plumbi dhe gjakun që ka rrjedhur në kapakët e saj. Po aty janë dhe ca dokumenta të tjera të Myzaferit, një lek, edhe këto të shpuara nga plumbi e të lara me gjak. Ky plumb i përshkoi këto sende e mbas tyre dhe trupin e tetar Myzafer Lipellarit në natën e 28 tetorit të vitit 1953.

Si ndodhi kjo?

Atë ditë erdhi urdhëri i lirimit i Myzafer Lipellarit me shokë. Grupi i parë i kufitarëve të vjetër iku, mbas tij dhe një grup tjetër e aty nga ora tre mbasdite u nis dhe Myzaferi me disa shokë. Shkonin më këmbë gjer në Shkodër e aty i prisnin makinat që do t'i çonin nëpër shtëpira. Dita e 28 tetorit ka qënë një ditë me shi, rrugët qënë mbytur nga balta e kufitarët e liruar shkellnin rresht njëri pas tjetrit anës mezhdave.

Që të shkoje në Shkodër, duhej kaluar Buna me lundër. Tek vendi i lundrës ata arritën aty rreth orës katër, po lundërtari kish ikur dhe lundrën e kish lënë në bregun tjetër të lumit. Myzaferi me të tjerët pritën aty nja një gjysëm ore. Shiu rridhte me shtëmba, dita e shkurtër e vjesh-tës po shuhej dalngadalë andej nga kodrat e bregdetit e kufitarët, si e panë që atë natë nuk mund të shkonin në Shkodër, u kthyen prapë për në postën e kufirit.

Ishin njëmbëdhjetë vetë së bashku me Myzafer Lipellarin. Kur kufitarët arritën në postë, vunë re se aty kishin mbetur pak njerëz. Atëhere Myzaferi me shokë shkuan tek komandanti i postës dhe e pyetën se ç'kish ndodhur në kufi.

Komandanti u tregoi se revizionistët jugosllavë, mbasi patën vënë re largimin e ushtarëve, kishin vendosur që atë natë të futnin diversantë në kufi. Lajmet ishin të sigurta. Kufitarët kishin dalë nëpër pikat kyçe dhe ishin në pritje.

— Shoku komandant, — i tha Myzaferi, — na jepni armët, se do të dalim edhe ne.

— Jo, — ia ktheu komandanti. — Forcat ne i kemi të mjaftueshme. Ju duhet të flini. Nga Shkodra më lajmëruan se duhet të niseni në orën pesë të mëngjesit.

— Jo, — kundërshtoi Myzaferi. — Ne jemi këtu e përderisa jemi këtu, s'mund të flemë, kur armiku kërkon të fusë diversantë.

Më në fund komandanti pranoi e kufitarët e li-ruar shkuan në shërbim. Myzaferi me një shok shkoi në vend vendosjen e njësitit në piramidën numër dy.

Ishte ora tetë e mbrëmjes. Myzaferi zuri vend në mesin e shkurreve, buzë Bunës, e nja gjashtështatë metra më tutje, u vendos në pozicion dhe shoku tjetër.

Nata ish e errët pus dhe shiu vazhdonte të binte. Buna qe fryrë breg më breg nga ujrat e vjeshtës e rridhte plot gurgullima të mbytyra në shtratin e gjerë. Në këtë natë të errët duhet t'i hapësh sytë mirë që të vësh re edhe lëvizjet më të vogla të armikut. Pika ku ishte Myzaferi qe më delikatja. Në atë vend titistët ishin përpjekur disa herë të futnin diversantë. Përballë piramidës, në bregun tjetër të lumit, ishte një shtëpi guri dykatëshe e një fshati jugosllav. Myzaferi ja kishte ngulur sytë shtëpisë dhe rrëpirës që binte gjer në breg të Bunës.

Pranë tij ra një gur i vogël. Myzaferi ngriti kokën. Me këtë shenjë shoku e lajmëronte që t'i afrohej. Myzaferi iu afrua dhe ai i tha se mbas krahëve, diku nja 50 metra më tutje kish vënë re një dritë që qe ndezur e qe fikur menjëherë.

— Të kanë bërë sytë, — i tha Myzaferi. — Ne i presim të vijnë nga Buna, kurse ti thua që pe dritë prapa krahëve. Po pa mbaruar këto fjalë, prapa krahëve u duk prapë drita. Në shtëpinë jugosllave përballë u duk një dritë tjetër që i kthente përgjigje.

C'kishte ndodhur? Diversantët ishin futur para një ore e tashti, jepnin sinjal për të ardhur dhe të tjerët.

Myzaferi i thotë shokut:

— Mos u ndje fare. Tashti do të vijë lundra e ne do të hapim zjarr kur të mblidhen aty.



Zunë vendet e nisën të presin.

Në bregun tjetër u dëgjuan ca hapa që zbrisnin poshtë. Mbas pak një lundër nisi të vijë drejt bregut tonë. Ajo lundronte ngadalë e Myzaferi mezi e shquante atë pikë të zezë në mes valëve të lumit.

Papritur lundra ndaloi në mes të Bunës dhe dha një sinjal me dritë. Atëhere sinjali u përsërit nga ata që ishin në anën tonë dhe mbas pak u panë pesë silueta të zeza larg njëra tjetrës që po i afroheshin shtegut ku do të vinte lundra.

Tashti Myzaferi priste që diversantët të shkonin pranë shtegut e në çastin që do të mblidheshin grumbull, të hapte zjarr. Po ky plan s'mund të realizohej. Ai vuri re se një diversant po vinte drejtpërdrejt në vendin ku ai kish zënë pozicion; maskimi tani ish i pamundur. Rrugë tjetër s'kish. Megjithëse ishin dy kundër pesëve, zjarri d'hej hapur medoemos. Lundra po afrohej, diversanti që vinte drejt dhe diversantët e tjerë qanë afruar dhjetra metra e koha s'priste.

Myzaferi u kthye nga diversanti dhe hapi zjarr. Ai u lëkund, lëshoi një rrënkim dhe mbeti në vend, po në atë kohë katër të tjerë u shtrinë barkas dhe hapën zjarr mbi Myzaferin e mbi shokun e tij. Nga shtëpia jugosllave përballë nisën të qëllojnë me mitroloz. Lufta aty në piramidën tonë vazhdoi një gjysëm ore. Katër diversantë u vranë, njëri u kap i gjallë. Po mbeti i vranë dhe Myzaferi ynë. Plumbi e kapi në gjoks... gjaku i tij i ngrohtë rrodhi në tokën e lagur buzë Bunës. Myzafer Lipellari u vra, u vra si një bir i denjë

i popullit për të mbrojtur kufitë e shenjtë të
Atdheut.

* * *

...Dhe sot aty ngrihet një lapidar. Ai ngrihet aty në tokën mëmë dhe tregon për shokun e rënë e të paharruar.

«Zëri i Rinisë» mars 1966

FADIL KRAJA

**HERONJTË E RINJ TË LEGJENDËS SË
LASHTË**

— Nisu, bir! Kështu veprojnë bu-
rrat. Hajt, udha e mbarë! Ec' gjith-
nji, mos u ndal kurkund! Po u djer-
site, mos ha borë. Vetëm sytë fërkoj
vazhdimisht me te që mos të të mi-
rren mendtë nga bardhësia. Nisu!

Vjeshta po largohet ngadalë, e zymtë, e trembun nga ernet e ftohta, që lëshonte pa ja da në livadhet e Lumës së Gashit gryka e frikëshme e Herushtës. Në Shkëlzenin hierandë, në kresh-tën e tij 2000 metër të naltë, zbrisnin grumbuj resh të zeza, që kalonin ulët-ulët mbi stane e mandej zhdukeshin mbrapa Doberdolit e Koshticës për t'u shprazë në Dragobi e Cernicë. Ishin ditët e fundit të tetorit. Çobanët vështronin nga vrrija. Së shpejti do t'i lenin këto livadhe të shëndetëshme për t'i dimnue bagëtitë poshtë në fshat, pranë stallave të kooperativës, ndërsa këtu, për 5 muaj me radhë, si zot i plotfuqishëm do të sundonte bora, ortiqet, stuhia dhe lukunia e ujqë-ve.

Pikërisht në një nga këto ditë vjeshte, fillon historia e gjashtë çobanëve tanë të rinj, gjashtë anëtarëve të Bashkimit të Rinisë, që treguen një heroizëm të pashoq.

Legjenda e bariut trim

«Rronte një herë e një kohë, diku në këto anë, rranzë Shkëlzenit apo Dragobisë, një djalosh trim, një bari, që e quenin Balc. Ishte trim e fisnik,

njeri i shpatës dhe i fjalës, i dashun dhe bukë-dhanës. Supet e tij s'e prekën kurrë tokën, pa lav-di s'e nxuer kurrë shpatën nga milli, kish një vu-ragë në shpinë, por ate vetëm shokët e miqtë ja dinin, sepse anmiku s'ja pa kurrë shpinën.

Si çoban i zoti që ish, tufën e dhive e kulloste në pllajat ma të mira të Lumës, e ngopte me gjethe e mështeknës, me tufakët e pishës së butë dhe vetëm ujë bore u jepte të pijnë. Dhitë e tij ishin të majme. Si gjithë të tjerët, posa shkrinte bora e fillonte të avullonte lumi i Gashit dhe të lulëzonte ahu i Doberdolit, Baleci fillonte shtegtimin e tufës së dhive. Shtegtonte ngadalë, duke iu ngjitë Shkëlzenit ditë me ditë, që qershori ta gjente në stanin e tij, ke pllaja e Koshuticës. Atje kalonte verën e vjeshtën dhe kur afrohej dimni zbriste përsëri në fshat.

Nji herë nuk zbriti fare në katund. Vendosi të dimnojë në Lumën e Gashit, të bajë ate që s'e kish ba njeri, të matej me dimnin e Shkëlzenit. Dhe ja përse:

Atë vit dimni erdhi ma herët. Era dhe shiu e kalbi barin e bjeshkës, përrenjtë u rritën, çobanët u detyruen me lanë stanet, me braktisë bjeshkën.

— Sa keq na ndodhi sivjet! — thonin barinj-të.

— Do të na ligen bagëtitë! S'kemi gjethe!

— Kurse këtu ka sa të duesh! Këtu do të ngopeshin dhitë me gjethe, me tufakë pishë...

Baleci i ndigjonte me vërejtje ankesat e shokëve dhe u tha:

— A qëndrojmë, o shokë?

— Ku të qëndrojmë, o Balec! — u përgjegjën ata.

— Ja, këtu, në stanet tona, në Lumë të Gashit. Ta kalojmë dimnin së bashku.

Barinjte në fillim hapën sytë të habitun dhe mandej ja dhanë gazit.

— Nuk na asht mërzitë jeta, o Balec! Na vërtet jemi të vorfën, por e duem jetën. Mandej nuk jemi të vetëm në botë si ti. Kemi familje, gra, fëmijë. S'duem me i lanë jetimë.

— Unë nuk thashë të vdesim, por të dimënojmë, të shpëtojmë bagëtitë! — tha Baleci i fyem.

— Kjo do të thotë të vdesim me siguri. Këtu bora e kalon kulmin e staneve; bredhave u duken vetëm kreshtat, në mos të përtaftë orteku, të përtaftë ujku... Jo, bre djalë, nuk jemi çmendë me ba diçka që s'e ka ba njeri! — u përgjegjën barinjte. Atëhere Baleci u tha:

— Mirë pra, meqë keni frikë zbrisni në katund, unë do të rri vetëm, këtu. Do ta kem vështirë, por do t'ja dal në krye; vdekjes nuk i trembem. Veçse, më jepni fjalën që, vitin e ardhshëm s'do të më leni vetëm!

— Po shpëtove gjallë me gjithë bagëti, vitin e ardhshëm do të dimnojmë së bashku. Por ti mos u krekos, o Balec. Mos u mat me dimnin e Shkëlzenit, nuk bahet shaka me te.

— Edhe në vdeksha, nuk më qan njeri! — tha Baleci buzagas. — Ju e thatë vetë o shokë! Jam fill i vetëm në këtë botë...

Dhe qëndroi. Atë vit dimni që i llahtarshëm. Luftoi Baleci me dimnin dhe e mundi. Luftoi me ortiqet dhe i ndali. Luftoi me ujkun dhe e mbyti.

Luftoi me akullin dhe e shkriu. Por... kur luftoi me sëmundjen, ajo e vuni për fundi. Sëmundja kish qenë ma e fortë se Baleci. Djali s'kish armë për ta luftue sëmundjen, prandaj i pikonte zemra gjak tek i shihte dhinë që ngordhnin një nga një. Kur tufa u përgjysmoe, e la bjeshkën, e braktisi stanin dhe u kthye në fshat. U kthye i mundun me zemër të vrame, me fytyrë të prishun, me sytë të futun thellë ndër zgavra. Ishte e para herë që dilte i mundun në një betejë, dhe kjo e bante me vujtë djalin fisnik.

Shokët e pritën mirë, s'ja kujtuen bastin, nuk ja përmendën kthimin para kohe. I erdhën në konak për ta përshëndetë dhe urue që shpëtoi gjallë, por Baleci nuk i la të flisnin. Ish ba gati me ikë. Bagëtitë që i kishin mbetë, shtëpinë e ç'kish ua fali shokëve dhe iku e s'u pa ma në rranzat e Shkëlzenit. E munda mali me borë dhe shkoi me gjetë vorrin në fushën me vapë, në detin me ujë të njelmët...»

Kjo legjendë tregohet edhe sot nga pleqtë. Askush s'e shan Balecin, përkundrazi çmojnë trimminë e fisnikninë e shpirtit të tij. Por megjithatë pleqtë mendojnë se atë e munda bora e Shkëlzenit. E pra kjo e fundit, sipas tyre, qënka më e fortë se çdo kreshnik dhe askush nuk duhet të matet me të.

Prandaj, kur ernat e ftohta fillojnë të fryjnë dhe në stanet e Lumës vijnë gjëmimet e para të Shkëlzenit, barinjve u kujtohet Baleci dhe shpejtojnë të zbresin tufat në fshat.

Një mbledhje e papritun

Në kooperativën bujqësore të Kërnajës, buzë Shkëlzenit, në një nga mbramjet e fundit të tetorit, korieri vrapoi shtëpi më shtëpi dhe lajmëroi se ish vendos të zhvillohej një mbledhje e jashtëzakonëshme e kooperativistëve.

Mbledhje të tilla zhvillohen shpesh kur dalin probleme të ngutëshme, prandaj anëtarët, pa u çuditë aspak, shkuen të gjithë drejt dhe në mbledhje. Ata që erdhën ma herët, zunë vend nga fundi i sallës dhe tue ba muhabet tymosnin njena pas tjetrës cigaret e duhanit. Kur u mblodhën të gjithë, kryetari çeli mbledhjen.

— Jemi mbledhë sot, shokë, për një propozim të guximshëm që i ka ba kryesisë brigadieri i brigadës së blegtorisë, Rexhep Malaca. Ne, si kryesi, menduem me ju pyet edhe ju që ta shohisim ma mirë këtë punë. Përveç jush kemi thirrë këtu edhe pjesëtarët e brigadës së blegtorisë, bile kanë ardhë nga bjeshkët dy barinj të e dhive dhe veterineri.

Të pranishmit në sallë heshtën. Në tryezën e presidiumit ndriste e zbehtë një llambë me vajguri. Fytyrat e njerëzve që kishin ngelë në errësinë nuk dalloheshin. Kryetari vazhdoi:

— Fjalën, pra, po ja japim brigadierit.

Brigadieri, një burrë i hollë dhe zeshkan, me flokë të preme shkurt, u ngrit e foli nga tryeza e presidiumit. Foli qetë, gjakftohtë, i sigurtë se, për çka do të thoshte, kishte të drejtë.

— Së pari desha të ndreq një gabim që bani kryetari kur foli. Propozimi s'asht imi, por i rini-

së së brigadës që drejtoj unë. Çështja qëndron kështu: Po jua them shkurt, se edhe iu jeni të lodhun e doni me shkue me pushue. Siç e dini, me tufën e dhive të kooperativës nuk i kemi mirë punët. Nuk po na shtohen. Vitin e kaluem pollën vetëm tridhjet përqind të dhive pleja, pati pesëdhjet e tetë dështime, ndërsa shatëmbëdhjetë përqind të tufës u damtuen. Dhe shkakun ju e dini. Dimni asht i gjatë. Mullarët e gjethit që sigurojmë për dimën, nga fundi i janarit fillojnë të kalben. Dhive u mungon ushqimi, ligen, ngordhin, .. dështojnë.

— Ç'na i thue ato që i dijmë të gjithë! — e ndërpreu një grue nga mezi i sallës.

— Prit, shoqe, mos më ndërpre. E di se i dini këto fakte. Por duhen gjetë rrugët e shpëtimt.

— Kollaj fort, i ushqejmë dhinë me kallamoq në janar, shkurt e mars! — u hodh një plak. Rexhepi qeshi së bashku me të tjerët dhe kur u vendos një farë qetësie, vazhdoi:

Natyrisht, po të arrijë puna deri aty, por rinia ka mendue një rrugë tjetër zgjidhjeje.

— Pa ta ndigjojmë ç'paska shpikë rinia! — thanë disa me kureshtje. Brigadieri vazhdoi:

— Organizata e rinisë, tue iu përgjegjë Thirrjes së KQ të PPSH, në një mbledhje që pati, vendosi të propozojë që tufa e dhive të kooperativës të dimnojë në bjeshkët e Lumës së Gashit. Atje giethi i mështeknës, i ahut, dhe tufaku i bredhit të butë nuk do t'u mungojë dhive për gjithë dimnin.

Në sallë plasi gazi. Propozimi i të rinjve disave iu duk i çmendun. Filluen rromuzet:

— Prej ortiqeve si do të mbrohen? Apo mos vallë të rinjtë kanë gjetë ndonji metodë?

— Me se do ta mbrojnë tufën nga bisha?

— Po, kur bora t'i mbulojë stanet, çka do u japin bagëtive?

— E paskan harrue fatin e Balcit! Mos duen me dalë ma trima se Baleci të rinjtë e Kërrnajsës? — e sa e sa thumba të tjera. Kryetari kish vrejte vetullat dhe i binte tryezës që të mbahej qetësia. Rexhepi në kambë i djersitun, buzëqesh-te me zor. Për një copë herë qetësia nuk u vendos. Kryetari, u ngrit e foli me za të naltë:

— Po pushoni, bre! Pse flisni të gjithë njëheri! Fundi, le ta shqyrtojmë propozimin e të rinjve, nuk duhet hudhun poshtë pa e shoshitë mirë punën.

Dhe, kur të gjithë heshtën, kryetari u ul i skuqun nga një farë zemërimi.

Rexhepi vazhdoi:

Në shikimin e parë, mendimi i guximshëm i rinisë të duket si i çmendun. Edhe mue ashtu m'u duk. Por ata ma mbushën mendjen se kanë të drejtë.

— E si, demek? — pyeti dikush me ironi.

— Shumë thjesht. Atje ka ushqim të bollshëm për dhinë! Të rinjtë mendojnë se kooperativa ka mundësi me sigurue mjetet e nevojshme për dimnimin e çobanëve e bagëtive, dhe të rinjtë tanë trima nuk do të mungojnë me shkue në Lumë të Gashit me kalue dimnin. Ja, ky asht mendimi i rinisë. Ju mos u ngutni me folë. Peshojeni pu-

nën dhe do ta shikoni se nuk duhet hudhë poshtë ky vendim i guximshëm.

Kaq tha Rexhepi dhe u ul. Tani nuk tallej kush. Ato pak fjalë që tha brigadieri u peshuen në mendjen e secilit. Vërtet, kooperativa kish mjete me i ba ballë dimnit në bjeshkë. Baleci që i vetëm. Po të kish shokë e mjete...

U ngrit një plak.

— Besa besë, o burra, nuk duhet hudhë poshtë fjala e rinisë. Partia jonë, i qofshim falë asaj, ka rritë e po rrit Baleca të rinj që lanë nam gjatë luftës e po lanë nam edhe sot. Unë jam një plak, por i falemnderit rinisë që tregon kaq guxim. Eh, sikur të isha ma i ri do të shkoja me ta, që besa e zotit!

— Nuk mund të matesh me ortiqet e Shkëlzenit e me murlanin e zi të Herushtës, o Bajram! S'kalohet dimni në Lumë!

— Kalohet, o Murat, kalohet! Ju harroni shpejt. Afër staneve tona në Doberdol asht posta. Si jetojnë kufitarët atje në dimën? Si e ruejnë kufirin ata, kur gjimon orteku?

— Ata kanë armë, rrobe të trasha, ushqime të mira... pastaj postën e tyne s'e rreh murlani i zi, prandaj edhe orteqet nuk rrëzohen bri poste — u mbrojt Murati.

— E ç'na kushton ne t'u sigurojmë çobanëve armë, mjete, rrobe, ushqime? — ndërhyri kryetari. — Pastaj edhe stani ynë asht ndërtue në një vend që mbrohet nga ernat. Çdo verë ne e gjejmë atë shëndoshë e mirë. Pra aty afër nuk bijnë orteqe.

Biseda u gjallnue përsëri. Fjalët e plakut Bajram i dhanë një rrugë tjetër bisedës. Koopera-

tivistët filluen ta shikojnë me besim inisiativën e të rinjve.

... Pas dy orësh propozimi i rinisë u pranue me shumicë votash. Të rinjtë e brigadës, që ndodheshin në mbledhje, duartrokitën me gëzim. Atëherë lindi një vështirësi tjetër. Kur u shqyrtue çështja se kush do të shkonte në Lumë me kalue dimnin, dy barinj të e dhive që veronin çdo vit, u lëkundën. U pa se ata kishin frikë. Ishin me fëmijë, fundi, pse të rrezikoheshin?

— Natyrisht, dimnimi në Lumë asht me rrezik. Dy barinj të nuk i detyrojmë të shkojnë atje. Por, edhe tufën e dhive dikush duhet ta riejë e ta ushqejë. Le të dalin pra vullnetarisht barinj të që do të shoqnojnë tufën. Kush e merr guximin me kalue katër muejt e dimnit në Doberdol?

Heshtën të gjithë.

— Po nga organizata e rinisë kush del? — pyeti Rexhepi.

— Dal unë, — tha Hamdi Arifi.

— Edhe unë — tha Faslli Rama.

— Dalim edhe ne! — thanë të rinjtë Sylë Shabani, Muharrem Rustemi e Rustem Rustemi.

— Ju lumtë djelmosha! — u tha gjithë gaz kryetari. — Ta dini se po tregoheni burra të vërtetë. Nga ana jonë do të bajmë çmos të mos ju mungojë asgja.

Në një stan nuk shuhet drita

Kaloi një muej. Po afronte dhjetori. Rexhepi i kish marrë të gjitha masat. Së bashku me të rinj-

të që do të dimnonin në bjeshkë, prenë gjethe dhe siguruen shumë mullarë bri stanit. Nga fshati sullën batanije, dyshekë, miell, vaj, gjalpë, makarona, një dhi pastërma dhe një fuçi me vojquri. Sullën gjithashtu disa thasë me krypë për barinj të diene bagëtitë, si dhe një arkë me ilaçe.

Të gjitha ishin gati. Ndërtesa e madhe e stanit ishte nda në dhoma të posaçme për bagëtitë, barinj të si dhe për plaçkat e ushqimet. Një ditë erdhi edhe komandanti i postës kufitare, Sejдини, dhe i tha Rexhepit:

— Komiteti i partisë së rrethit «Bajram Curri» interesohet për nishativën që kanë marrë të rinjtë. Na ka porositë të kujdesemi për ju. Kam ardhë t'ju pyes: Ç'nevoja ju dalin barinjve të rinj?

Rexhepit i qeshën sytë dhe zemra i gufoi për kujdesin që tregonte Partia. Pra edhe ata e paskan pranue guximin e të rinjve. Iu përgjegj komandantit:

— I telefononi Partisë dhe e falënderoni për kujdesin që tregon për ne. Por kooperativa nuk ka nevojë për asgjë. Jemi përgatitë për të gjitha çka duhen. Po deshët, shoku Sejдин, u jepni çobanëve një armë.

— Jo një, po dy. Dhe ju i thoni kryesisë dhe familjeve tueja se posta s'do të mungojë t'ju plotësojë çdo nevojë që kini. Unë vetë, herë mbas here do të vij t'ju shoh. Posta jonë nuk asht larg stanit.

... Pesë të rinjtë Hamdiu, Rustemi, Faslliu, Muharremi dhe Sula shkuen pranë familjeve që të përshëndeteshin. Dy ditë ma vonë barinj të tjerë të tufave të kooperativave Kovaç, Shkëlzen, Myhejen, etj. po i linin stanet për të zbritun në fshat.

Ata e kishin marrë vesh se pesë të rinjtë e Kërrnajes do të dimnonin këtu, prandaj erdhën t'i përshëndesin.

— Lamtumirë, o trima!

— Edhe ne do t'ju bahemi shokë vitin e ardhshëm!

— Mundeni dimnin e Shkëlzenit.

Ndërsa disa të tjerë thoshnin me vete:

— Të mjerët këta! S'do të jenë të gjallë deri në pranverë.

Atë natë, stanet mbetën shkretë, pa bagëti, pa njerëz... Por vetëm në një stan drita nuk u shue. Ajo ngeli e ndezun atë natë dhe netëve të tjera. Brenda mureve të stanit kish jetë e gjallni. Bagëti-të blegëronin, zjarri bubulak ngrihej deri nëlalt ndërhata, ndërsa çiftelia e Faslliut tingëllonte ambël dhe përcillte deri thellë në pyllin e Doberdolit kangën e njohun të Bajram Currit:

*... Ushton gryka e Dragobisë,
nam po len trimi i malsisë...*

Lugina e Lumës së Gashit, për të parën herë atë dimën, kur bora e parë e mbuloi pllajën me shtresën e bardhë, u mbush me gjurma të vogla dhish që bridhnin nga njëni mullar tek tjetri. Familja e re e pesë çobanëve u lidh ngushtë. Të gjithë ishin djem të fuqishëm, të dashun dhe të papërtueshëm. Jetën e rregulluen ma së miri, porsi një repart i vogël ushtarak ku mbretnon parulla: «Një për të gjithë e të gjithë për një.»

Hamdiu ishte shpirti i grupit. Porsi një komisar i mirë dhe i dashun, me fjalën e tij të ambël dinte me mbajtë gjallë optimizmin dhe besimin

ndër zemrat e shokëve. Trupi i tij i lidhun e plot muskuj, këshillat e tij të pjekuna, buzëqeshja e ambël që zbukuronte gjithnji fytyrën e tij të zeshkët, të ngjallnin respekt.

Faslliu ishte artisti i grupit. Që në ditët e para ndërtoi vetë një lahutë, një çifteli, një fyell. Ai u binte që të trija veglave muzikore. Edhe të tjerët dinin me i ra, por jo me këndue aq bukur sa Faslliu. Shpesh Muharremi i thoshte:

— Ti, Faslli, përse nuk shkove në Liceun Artistik të Tiranës? Do të delje artist, artisti i Kërrnajes. Ç'dreq t'u tek me u ba bari i dhive?

Faslliu qeshte dhe fillonte kangën:

Mori e mirë që more bjeshkën...

— Ti na këndo ma mirë kangë trimnie, — ndërhynte Hamdiu. — Na këndo për trimat, o Faslli! Dhe Faslliu i gatshëm ja merrte:

*... ç'janë këta gjamë që po na çon era,
po luftojnë Rugova e Peja...*

Dhe kanga merrte bjeshkëve dhe zemrat e djelmoshave ndizeshin dhe netët e gjata kalonin njena mbas tjetrës.

Mëngjesi vinte përherë e ma i ftohtë. Bora e shtonte trashësinë. Por dimni i vërtetë ishte ende larg. Dhjetori po kalonte i butë, murlani i zi i Herushtës sikur po vonohej me rrahë Qafën e Doberdolit. Barinjët përfituen mjaft nga këto ditë. I shtuen mullarët me tufakë bredhash. Tufën e kullosnin tue lanë gjithnji një roje majë shkambit, ndërsa si

pararobjë linin dy qentë e mëdhenj të stanit, që e kryenin ma së miri punën e tyne.

— E ç'na duhet roja? — i tha një ditë Rustemi Hamdiut. Këtu përveç kufitarëve nuk vjen njeri i gjallë.

— Po kufitarët ke ruejnë atëhere? — iu përgjegj Hamdiu. Mos harro se edhe ne jemi kufitarë. Roja duhet gjithnjë. Do të fillojnë orteqet, roja duhet t'i bajë sytë katërsh me lajmërue shokët.

Kufitarët, pothuej çdo ditë kalonin nga stani dhe pyesnin:

— Ç'kemi o trima? Si jeni, si po ja kaloni? A i keni mirë bagëtitë?

— Çdo gja në rregull, o shokë — përgjigjeshin barinjtë.

Natën e vitit të ri, erdhi një kufitar dhe u tha:

— Më ka dërguar komandanti. Sonte ju ftojme në postë. Do të kalojmë së bashku mbrëmjen e vitit të ri.

— S'kemi kujt ja lamë bagëtitë! — u përgjegj Hamdiu. Por kufitari u tha:

— I kemi marrë masat. Afër stanit sonde do të bajë roje një kufitar.

Dhe barinjtë e festuen vitin e ri me kufitarët. Ishte një mbramje gazmore plot këngë, plot qyfyre... Hangrën, pinë nga konjaku i Korçës, ndigjuen deri vonë muzikë shqiptare që transmetonte Radio-Tirana, ngritën doli për Partinë, për shokun Enver...

Të nesërmen binte borë dhe frynte një çikë erë. Trashësia e borës arrinte një metër, kurse në disa vende të tjera, sidomos bri pishave, masa e borës i kalonte dy, bile tri metrë. Bora binte

gjithnji, një borë e imët, e thatë, flokëvogël.

— Borë murlani! — tha Hamdiu. — Mysafiri, që ja kishim frikën po vjen. Edhe një çikë erë ma tepër të fryjë e priti orteqet mandej... E ndigjoni si ushton Shkëlzeni?

Vërtet, në mjegullën e dëborës vinte një ushtimë e mbytur, e largët.

Barinjte vështruen njëri tjetrin. Të grumbulluem tek hymja e stanit, që tani dukej si tunel, ata shikonin për të parën herë dimnin e Lumës, atë dimnin e vërtetë, të cilit ja kishin frikën malësorët.

— Tashti, o burra, t'i përvishemi punës! — vazhdoi Hamdiu. — Nga mullarët të mos preket ma gjethi. Le të shpresojmë se edhe dy javë nuk do të shkëputemi nga bota. Por kini kujdes. Kjo asht borë murlani, e imët dhe gënjeshtare. Përgatitni rrathët.

Porsi ushtarë të vërtetë, barinjte iu bindën urdhnit. Me dru mështekne formuen ca rrathë, të cilët i lidhën tej e përtej me tela e spango. Formuen ca rrathë si raketa tenisi pa doreza. I vendosën nëpër opinga, muerën kmesat dhe duelën. Dhitë blegërinin; ato donin dhe ushqim në natyrë... Ora ishte dhetë e mëngjesit.

— Mbi shkamb të bajë roje Faslliu — urdhënoi përsëri Hamdiu.

Faslliu mori gunën, vuni pushkën në sup dhe hypi mbi një shkamb që gjindej jo shumë larg stanit, përballë pllajës dhe bredhave të parë të pyllit të Doberdolit. Shkambi ish mbulue nga bora. Faslliu, me ndihmën e rrathëve, u ngjit në majë të shkambit. Bora e shkrifët ngjishej nga

pesha e rrathëve dhe dalngadalë trupi i Faslliu u zhyt në borë, deri në brez. Faslliu me tytën e pushkës largoi borën dhe formoi një lloj postë-vrojtimi mbrenda në borë. Vështronte shokët. Ata, me Hamdiun në krye, në fillim rrafshuen borën dhe formuen ca tunele të vogla që niseshin nga stani në drejtim të pyllit. Kishin me vehte nga një kmesë. Filluen të formojnë tunele ndihmëse në drejtim të pishave të buta. Mbas formuën një dhetë të tillë nga do të kalonin dhitë, u ngjitën nëpër pisha dhe këputën tufakë (degë të vogla) nga fundi i kunorës së pishës. Tufakët i hidhnin mbi borë. Mbas pak, dëborë rreth pishave u ba e gjelbër nga tufakët.

Rustemi ish largue nga shokët dhe kish hy-pë në një pishë të madhe. Tek po këpuste me kmesë tufakë, dega ku kish vendos kambën u thye. Rustemi ra pa zhurmë. Faslliu e pa kur ra dhe u zhduk në masën e borës. U zhduk si ta tërhiqte dikush. Faslliu dha alarmin, por, nga gjëmimi i Shkëlzenit, nga era që frynte, shokët nuk e ndigjuen. Atëhere hoqi pushkën dhe e shprazi. Krisma çau hapsinën dhe Shkëlzeni gjëmoi mbytazi, por gjatë. Faslliu s'u mjaftue me kaq. Zbriti nga shkambi, çau borën deri tek tuneli kryesor dhe vrapoi në vendin ku ra shoku. Ndërkaq, tue ndigjue krismën, kishin lanë punën dhe po vinin në drejtim të rojes edhe Hamdiu, Muharemi, Sula.

— Ç'ka ndodhë? — bërtitën të tre.

— Rustemi ra nga bredhi e u zhduk në borë! — bërtiti Faslliu tue dihatë dhe u priu shokëve. Pishën e gjetën, por nuk e gjetën shokun.

Bora, mbasi e kish përpi djaloshin, s'kish lanë asnji gjurmë ku të gërmonin. Perimetri rreth pishës ish i gjanë, si një krater i madh. Po të hiqej gjithë masa e borës do të duheshin dy orë; shoku ndërkaq do të kish vdekë. Por Faslliu u tregue i squet. Ndërsa shokët këshilloheshin, ai vrapoi në stan e nxuer qentë. Dy qentë e murrme me veshë të premë, sikur ta kishin kuptue randësinë e detyrës që u ngarkohej, mbasi u sullën një herë rreth, tue ça me gjoks borën dhe tue u zhytë deri në fyt, u ndalën mbas pak në një vend të caktuem, i cili për çudi gjindej dy, tri metra larg perimetrit të kunorës së pishës.

— Të ketë ra vërtetë kaq larg? — pyeti Sula.

— Qentë nuk gabojnë! Shpejtoni, se Rustemi asht në rrezik — bërtiti Faslliu dhe i pari, me tytën e pushkës që e përdorte si lopatë, filloi të heqë borën. Të tjerët përdorën duert. Qentë nuk kishin gabue. S'kaloi asnji minutë e duert e Faslliut ndeshën në kokën e shokut. E qitën prej andej pa ndjenja.

Rustemi erdhi në vehte, mbas shumë kujdesesh të shokëve. Dikush i futi në gojë konjak nga shishja që u kishin falë kufitarët. Një tjetër i futi kambët në ujë të ngrohët.

Kur u ba mirë tregoi:

— S'e kuptova si ndodhi. Rashë dhe u gjenda pa pritë në një errësinë si prej vorri. Në fillim u mundova të dal, por u lodha shpejt. Më vinte gjumë, sikur s'kisha fjet shumë net me radhë. Kapakët m'u randuen... mandej s'mbaj mend asgja.

— E ti thojë, ç'na duhet roja? — e qërtoi

Hamdiu. — Po të mos ish Faslliu në postvrojtim, ti do të kishe vdekë.

Rustemi ndjehej i lodhun.

— Flej, flej! — Hamdiu e mbuloi me dy batanije, aty bri zjarrit, vuni një cung të madh dhe u suell nga shokët. — Ti Sulë, rri në stan, na gatuej mish me groshë për darkë dhe kujdesu për Rustemin. Ti Faslliu vazhdo rojen, ndërsa unë e ti, Muharrem, po nxjerrim dhitë në tufakë. Bora kish pushue. Era nuk frynte ma. Nji diell i ftohtë, por verbonjë, pasqyrohej mbi sipërfaqen e borës. Nga dreka, mbasi dhitë kishin kullotë mirë dhe u ishte dhanë krypa, Faslliu lajmëroi se nga shegu i zallit po vinte nji njeri.

— Ndoshta sjellin postën! — tha Hamdiu.

Megjithse nga Kërrnaja në Lumë ishin 35 km. rrugë, kooperativa u dërgonte çdo javë barinjve gazeta dhe ndonji ushqim nga familja.

Ai që erdhi suell gazeta dhe nji letër nga kryetari. Por nuk ishte korieri. Barinjtë u çuditën kur panë Sulejman Zeqirin.

— Po ti, more Sulejman?! U lirove nga ushtria? — e pyetën mbasi u përqafulen.

— U lirova!

— Që kur?

— Ka nji javë!

— Dhe fillove punën?

— Siç e shikoni!

— Korier të caktuen?

— Jo bre, pse korier? Ç'jam unë, sakat që të bahem korier. Mbasi u çmalla me familje dhe fa-refis shkova ke kryetari e i thashë të më cakton-te përsëri bari, siç kisha qenë para se të shkoja

ushtar. Kryetari më foli për ju dhe unë vendosa të vij këtu. M'u desh të luftoja pak me familjen dhe kryetarin por i munda. Kam qenë kufitar. Këtu e kam vendin.

— Po ti pse s'na thue, o byrazer që paske ardhë me ndejë me ne!? Të lumtë. Ja, tash u barnë gjashtë, — i tha Hamdiu.

E përqaftuen përsëri, e pyetën gjanë e gjatë për jetën në ushtri, pastaj lexuen gazetata. Hamdiu çeli letrën e kryetarit dhe e lexoi. Si e mbaroi u drejtue nga shokët:

— Kryetari thotë se së shpejti rrugët do të ndërpriten nga bora. Pyet a jemi në rregull me çdo gja.

— Në rregull jemi! — tha Muharremi.

— Jo! Nuk jemi në rregull. Na mungojnë disa lopata dhe një spatë e një kazëm. E patë ç'hoqëm me largue borën? Po kur të rritet bora? Me se do t'i hapim tunelet? Veglat janë të domosdoshme! — tha Faslliu.

Hamdiu tundi kryet në shenjë pohimi. Si nuk u kish shkue mendja për lopata? Po tash? Ç'të bartin?

— Dhe e keqja asht se korieri s'do të vijë ma. Kështu më tha kryetari. Nuk vjen, sepse rruga mund të zihet nga çasti në çast, — tha Sulejmani.

— Edhe kjo na u desh! Po tash? — turfulloi Hamdiu.

— Unë mendoj të nisim njanin.

— Patjetër ta nisim, bile që nesër. Të përfitojmë nga koha e mirë! — u hodh Muharremi.

— Po sikur të zihet rruga? — pyeti Hamdiu.

— Përse të mendojmë të keqen! Koha tash u hap. Kjo premtion se nuk do të prishet për një javë. Po shkoj unë, bile që nesër në mëngjes. Për pesë dit jam këtu — tha Muharremi.

— Ta mendojmë sonte! — e mbylli bisedën Hamdiu. — Ndërkaq, ti Faslli na e merr njëherë atë çifteli. Kemi tri gëzime sonte: Dita e parë e vitit të ri, shpëtimi i Rustemit nga vdekja dhe forçimi i grupit me një shok të ri, me një kufitar të por-sa liruem.

Po ngrysej. Errësina po zbriste nga Shkëlzeni për të mbulue pllajën. Hana, një hanë e plotë po e zbehtë, vezullonte përmes pishave. Erë nuk frynte. Temperatura po ulej gjithnjë ma poshtë. Bora kish fillue të ngrijë. Mbrenda në stan një zjarr i madh ndriçonte dhomën. Dhinë blegrinin herë mbas here. Kusia e groshës, varë në varganin e hekurt që zbriste nga tavani mbi votër, ziente ambël. Bri dyshekut të Rustemit, të shtrimë me fytyrë nga zjarri, me kokën të mbështetun ndër duer, barinjte, në heshtje ndigjonin kangën e bukur të Faslliut:

*... Të shtatë krajlrat kanë pëvetë
Kët Gjini Lekën ç'e ka gjetë,
n'saraj t'Shkodrës, n'odë t'valisë
vrau një beg prej Tepelisë...*

Një udhëtim i rrezikshëm

Farkëtari i kooperativës së Kërrojës e la çekainin me të cilin godiste një bosht qerreje dhe suell kryet me pa kush hyni në farkëtari. Ndoshta nga

drita e zjarrit të farkës apo se sytë e tij nuk shihnin larg, nuk e dalloj dot atë njeri të gjatë që po shkundte borën nga supet, aty bri dere.

— Kush asht ai? — pyeti ndihmësin.

— Paska ardhë Muharremi nga Luma! — u përgjegj ndihmësi.

— Pa afrohu këtu, o kaçak! — i tha buzagas farkëtari.

— Mirëdita, mjeshtër! — përshëndeti djali dhe i qoku dorën farkëtarit.

— Kur dhe pse ke ardhë? Mos të trembi Shkëlzeni?

— Jo, mjeshtër, nuk më trembi asgja. Kam ardhë dje, por, përveç familjes dhe jush nuk e di njeri tjetër që kam ardhë.

— Mos ke ikë? — e thumboi ndihmësi.

Muharremi e vështroi me qesëndi.

— Nuk jam nga ata unë, or piçirruk! — dhe tue iu drejtue mjeshtërit, i tha:

— Më duhen katër lopata, një kazëm, dy spatat. Po ta firmoj unë fletëdaljen. M'i jep tash dhe mos i trego kryesisë deri nesër. Do të nisem tash për bjeshkë!

— Mos ke luejtë nga mendtë? — A nuk e sheh ç'borë bie?! A nuk e ndigjon murlanin e zi?! — i tha farkëtari.

— I ndigjoj, i ndigjoj fare mirë. E bash pse i ndigjoj, më duhet të nisem tash, si kaçak.

— Po a mund të nisesh? Mbramë ka ra borë gjithë natën dhe vazhdon të bjerë.

— Kam lanë shenja ndër shtigjet. Do të arrij ose do të vdes. Shokët nuk i la në baltë. M'i jep veglat, se do të nisem tashti!

Kovaçi po i mbante me zor lotët. I vinte ta përqafohte këtë trim fisnik që po shkante drejt vdekjes pa frikë, vetëm për të shpëtue shokët. Mirëpo, që të mos e tradhëtonin lotët, nuk e përqafoi. Shkoi në fund të lokalit, zgjodhi nga veglat ma të mira që kish, e, pasi ja futi në torbë, i tha:

— Nisu bir! Kështu veprojnë burrat. Hajt, udha e mbarë! Ecë gjithnji, mos u ndal kurrkund! Po u djersite mos ha borë. Vetëm sytë fërkoj vazhdimisht me te që mos të të mirren mendtë nga bardhësia. Nisu!

Muharremi mbasi u shtërngoi dorën duel nga dyqani me çap të vendosun. Bri farkës, mjeshtri iu drejtue ndihmësit të ri që vështronte portën:

— E shikon! Ky asht kreshnik. Ja kështu si të them unë! Mos e harro këtë që pe...

...Kish fillue të errej, por ishte një errësinë e bardhë. Për fat, dëbora pushoi, përndryshe djali nuk do t'i dallonte hujt që kish ngulë ndër shtigje e që tash u dukeshin vetëm majat. Mbasi udhëtoi deri afër mesnate, u ndal. Dëbora ja filloi përsëri. Tani nuk shihej asgja për qark. Nji errësinë e frikëshme. Pylli ulurinte për tmerr. Kish dymbëdhjetë orë që udhëtonte. Tash e ndjente veten të lodhun. I ndalun buzë një pishe, tue lëvizë në vend numuro po mendonte se si ta kalonte natën që i ngelej. Po të rrinte në një vënd dëbora mund ta mbulonte fare. Ajo binte e shpeshtë, e imtë, dhe murlani ja përplaste shkulma shkulma në fytyrë dhe trup.

Mbas një gjysmë ore filluen me e lanë fuqitë. Rrathët nuk i ngrinte dot ma. I vinte gjumë. E kuptoi se po ngrinte. Po vdiste në mes të pyllit,

në gjysmë të rrugës, pa e krye detyrën, tue u rrezikue jetën pesë shokëve dhe bagëtive të kooperativës.

I dukej një vdekje e turpëshme, pa lavdi. Iu kujtue ushtar Hekuran Zenuni. E ku mund të barazohej ai me te?! Hekurani ishte hero, sepse i përdori të gjitha mjetet dhe luftoi me vdekjen deri në çastin e fundit. Po Muharremi a i kish përdorë të gjitha mjetet që kish për të shpëtue, për ta mundë vdekjen që i kërcënohej?

Ju kujtue torba që i randonte mbi shpinë. Nji mendim i ndriti fytyrën. Po sikur të gërmonte borën dhe të formonte një kolibe prej bore?!

E hoqi torbën, këputi nji degë ahu, e përdori si bisht lopate dhe filloi të gërmojë. Forcat sikur iu përtrinë. Gjumi iu largue. Mbas nji ore kish formue nji dhomëz të vogël. U fut brenda dhe hyrjen e zuni me borë. Vuni shenjë ke rranja e ahut, që në se bora binte gjithnji, të mund të dilte në drejtim të pemës, ku mund ta çelte daljen kollaj. Filloi të djersijë. Muharremi hoqi xhaketën prej lëkure dhe e shtriu nën borë. Torbën e vuni si jastëk dhe fjeti...

Ish nji gjumë i randë, me andra të këqia, me vapë...

Kur u zgjue, ishte la në djersë dhe i merrej fryma nga ajri i keq. Nga nxehtësia e shpellës, bora rreth e rreth kish nisë të shkrijë, tavani i bardhë vende-vende pikonte.

Sa kish fjetë? Kushedi! Orë nuk kishte, edhe sikur të kishte s'do ta dallonte në errësinë.

U ngrit, veshi xhaketën, çeli shtegun dhe dudel. Kishte zbardhë. Bora vazhdonte. Nga torba

nxuer një misërnike me djathë dhe e hangri. U nis përsëri. Tash mund të shihte, por shtigjet ishin zanë krejt. Hujt që kish ngulë si shenja dalluese, kur kish ardhë, ishin zhdukë nën borë. Trashësia e borës mund të ishte tri-katër metër. Me ndihmën e rrathëve që kish ndër kambë zbriti në prronin që ndante Doberdolin. Tash stanet nuk i kish larg. Në kohë vere, prej këtu mund të arrinte për dy orë.

Në verë?! Eh, vera! Tash as që duhej mendue për verën. Po ta mbërrinte stanin pa u ba natë mund të shpëtonte, përndryshe do të vdiste. Pylli i Doberdolit asht «Shkëlzen», nuk kalohet nata në borë, atje, sepse murlani i zi i Herushtes ta shemb kasollen e borës. Pastaj ortiqet!... Po të mori ndonji me vehte, kufomën tande veç në qershor e gjejnë çobanët, të freskët fare, të paprishun.

Kështu mendonte, kur po kalonte prronin e Gashit, që e kish ngri të ftohtit dhe kish zanë një shtresë të vogël bore. Akulli ishte i trashë, edhe qerren e mbante, jo ma Muharremin. Por, ndodhi diçka e papritun. Jo shumë larg, diku mbas kthesës së përronit, ushtoi mali me një ushtimë tmerrojëse.

— Orteku! — mendoi Muharremi i zverdhun dhe u shtri në borë. Po ta zinte orteku do ta bante petë. Por masa që muer nuk ishte e kotë. Djaloshi veçproi me mend. Orteku ra diku pranë, dhe po të mos ishte shtri, presioni i ajrit do ta përvolaste ndër pishat e prronit. Shtrimja e shpëtoi nga përplasja. Por nuk e shpëtoi nga një rrezik tjetër, jo ma i vogël. Orteku, tue ra në prrue, kish thye akullin në një rreze të gjanë. Muharremi, ashtu i shtrimë ndjeu



se po i lageshin kambët, e pastaj gjithë trupi iu fundos në një pellg uji përzi me borë. U ngrit menjëherë, ashtu si ishte, me rrathët ndër opinga, të cilat zunë shtratin e prronit. I qullun duel në breg. Rrobet i ngrinë menjëherë. U mundue me ecë, por rrobet e pengonin. Pantallonat prej shajaku ishin ba si dërrasa, po ashtu edhe xhaketa, edhe torba...

Hoqi pantallonat, xhaketën e i vuni mbi shpinë. Eci shpejt që të nxehej trupi i lagun. Dhe vërtet filloi me u nxe. Nji mendim i vërtitej në mendje: të mbërrinte në stan para se të errej. Bora gjithnji binte me furi. Megjithse mesditë, kish fillue të errësohej. Doberdoli, me të përpjetën e tij thue s'kish mbarim. Shkëlzeni që s'dukej, po ndjehej, gjimonte pa ja da dhe lëshonte mbi pllajë orteqe vdekje prurëse që merrnin me vete masa bore, gurë dhe drunj që i thyenin pa mëshirë.

Djali udhëtonte, i lodhun, i këputun, por me besim e forcë. Luftonte me vdekjen, me forcat e fundit që i kishin ngelë.

Në muzgën e mbramjes dalloi dritën e stanit...

Rrethimi i bardhë...

Muharremi hapi portën e stanit dhe ra përmbys, gjysmë i vdekun.

E shtrinë bri zjarrit, e uruen për shpëtimin e i dhanë të hajë. Por, gjatë mungesës së tij, në grup kish ngja një fatkeqsi. Faslliu, tue pre tufakë pishe me kmesë, kish plagos kambën. E kish

pre keq. Afër kycit të kambës, kmesa ish futë në mish dhe kish prek kockën. Tash rrinte i shtrimë, pa mundun me lëvizë nga vendi. Ndjente dhimbje të mëdha, por s'ankohej. Si burrë i vërtetë, duronte në heshtje mjekimet që i banin shokët si dhe kufitarët e postës. I kishin thanë ta dërgojnë në Tropojë, që atë ditë. Bile kishin ba gati edhe vigungun. Por Faslliu nuk dëgjoi.

— Pranoj ma mirë me vdek këtu se sa me u kthye në katund. Ju lutem mos më dëboni. E di se nuk mund të dal ma në kullotë por, sëpaku këtu në stan ju vlej. Do t'ju gatuej bukën dhe gjellën. Do të mundohem mos me u randue shumë.

Shokët, të pikëlluem për fatin e keq të shokut, nuk e kundërshtuen. Fundi, le të rrinte në stan. I shëndoshë erdhi në bjeshkë, i shëndoshë duhej të kthehej në katund nga bjeshka. Mandej si do ta nisnin në gjithë atë borë që kish ra?! Janë tridhjetë e pesë kilometra, s'i thonë shaka.

— Rri pra me ne — i tha Hamdiu. — Ne do të kujdesemi për ty. Do të shërohesh shpejt.

Jashtë bora vazhdonte me ra, murlani i zi ulurinte dhe herë mbas here ushtonte stani nga ortiqet që rrëzoheshin.

— Si ja ka nisë, s'ka mend me pushue kjo borë! — tha Sulejmani.

— Le të bjerë! Tani që na erdhën lopatat e sopatat nuk kemi frikë! — u përgjegj Hamdiu.

Bri votrës, afër dyshekut të Faslliut, dy qentë e stanit hungrojshin herë pas here përvaishëm.

— Po këta, ç'kanë? — pyeti Faslliu dhe u lëmoi krenët qenve që, të qetësuem nga përkëdhelja, luejtën bishtin të kënaqun.

— Parandjejnë kohë të keqe! — tha Sula.

— Pse, e mirë asht koha tash?

— E keqe asht, por qentë paralajmërojnë se do të vazhdojë!

— Dhitë përtypen të qeta — vazhdoi Rustemi.

— I snihni, thue se s'ndodh asgja. Hanë sa ngopen, do ta kalojnë si s'ka ma mirë!

— Nesër duhet t'ua dlimir plehun. Kjo do të ishte mirë edhe për to edhe për ne, — tha Hamdiu.

— Nesër duhet të çelim përsëri rrugët. Me këtë borë që bie dhe stani mbulohet — vërejti Rustemi.

Dhe vërtet, të nesërmen bora kish kalue portën e stanit. Puna e parë që banë ishte me u vue nga nji bisht druni lopatave. Këte e banë me qejf të madh, si mjeshtra të vërtetë. Pastaj secili muer lopatën e vet, dhe hapën shtegun. Atëherë në portën u futën shkulma bore. Bora binte si e çmendun, murlani vazhdonte të fryjë me tërbim. Barinjt, me përjashtim të Fasliut e Muharremit që qëndruen në stan, duelën përjashta me ndihmën e rrathëve. Me lopata hapën rrugën kryesore që të çonte ke druajt e parë të pyllit. Tash s'kishin nevojë me hy ndër pemë. Gjysma e bredhave ishin nën borë. Tash edhe me dorë mund të këputje tufakë.

I nxuerën dhitë dhe për nji orë të tanë i ushqyen me tufakë. Mandej i futën brenda dhe ua mbushën grazhin me gjethe ahu e mështekne që i nxuerën nga njeni mullar. Tash, edhe ditën ata mund të qëndronin në stan, të kuvendonin, të lexonin ndonji libër...

— Kjo asht jetë! — qeshi Sula. — Ha, pi, rri. Si me qenë kamp pushimi.

Të tjerët qeshën me këtë shaka. Vërtet kishin mjaft kohë të lirë, por bora që vazhdonte të binte i shqetësonte. Kur vallë do të pushonte?

Për tri ditë me radhë ajo nuk pushoi. Tash kish mbërri në vende-vende pesë metër. Stanit nga larg i dukej vetëm pullazi. Dritaret ishin zanë nga bora. Drunjve të pyllit u dukeshin vetëm majat.

Dhitë vazhdonin t'i ushqenin me gjethet e mullarëve. Herë-herë, u jepnin edhe tufakë, por tash ishte zor me i pre. Barinjte shkonin deri ke bredhi dhe, me që degët e para ishin mbulue nga bora e hiqnin ate me lopata dhe formonin përqark bredhit një gropë të madhe. Atëhere njeni hynte në gropë dhe që andej u ngjiste shokëve tufakët që priste nga degët.

— Si me nxjerrë ujë nga pusi! — qeshi Sula.

Vështirësitë shtoheshin gjithnji, por ata nuk epeshin. Entuziastë dhe guximtarë, ata vazhdonin normalisht jetën e tyne. Pasi i ngopnin dhitë, futeshin në stan dhe merreshin me ndonji punë.

Faslliu ndërtoi edhe një lahutë të re me dru mështekne. E punoi me kujdes, i vuni edhe kokën e dhisë, të cilën e skaliti bukur.

Hamdiu dhe Sulejmani lexonin me za librin «Re të zeza», ndërsa Muharremi dhe Sula kujdeseshin për dhitë, i kontrollonin, i mjekonin, po të qe nevoja, u jepnin krypën... Nga mesi i janarit dëbora pushoi. Dielli i ftohtë ndriti përsëri mbi borën e ngrime. Temperatura zbriti dhjetë gradë nën zero.

Atë ditë, me ndihmën e shokëve duel edhe

Faslliu për të pa. Pylli dukej si i fjetun. Asgja s'pipërinte. Drunjve u dukeshin vetëm majat. Rrezet e diellit, tue u pasqyrue në borë të verbonin sytë.

*... Randojnë ahat për me u thye,
Kin çetinat vetëm kreshtat
Ushtojnë lugjet prej ortiqesh,
prej ortiqesh kah bijnë ndër gropa...*

recitoi Faslliu dhe shtoi:

— Ndoshta këndeje nga Luma e Gashit e nga Shkëlzeni do të kenë jetue Muja e Halili.

Dhe, meqë shokët nuk e dinin, u lexoi atë natë rapsodinë «Martesa e Halilit». Por koha e mirë nuk mbajti shumë. Pas tri ditësh murlani fryni përsëri. Nga gryka e Herushtës u dyndën re të zeza bore. Si familjarë të mirë, gjashtë shokët e kursenin ushqimin dhe hanin me racion si bukën, ashtu edhe mishin e fasulet. Mirëpo një fatkeqësi i pllakosi papritmas. Nga lagështina, nga era e plehut të dhive dhe avullimi i dheut të dyshemesë kur ndiznin zjarr, thesi i miellit zuni myk. Një ditë, Faslliu provoi kaçamakun që gatoi dhe e volli. Mielli ishte idhëtue e nuk hahej. Provuen ta hapnin miellin, por myku nuk hiqej. Ishte myk i zi, helm i idhët.

— Edhe kjo na u desh! Po tash si do t'ja bajmë? — pyeti Hamdiu.

— Do ta hamë ashtu si asht! — tha Rustemi.

— Në asnji mënyrë! Do të sëmuremi të gjithë brenda ditës.

— Po ahëre ç'të hamë?

— Jetohet edhe pa bukë. — tha Faslliu. — Fasule kemi, ca kërtolla e mish kemi...

Ranë të gjithë në mendime. Ishte një problem serioz. Patatet ishin në mbarim, pastërma kishin fare pak. Propozimi për të pre ndonji cjap të tufës u hudh poshtë. Nuk u pranue gjithashtu as mendimi që çfaqti Sulejmani që t'u drejtoheshin kufitarëve.

— Jo, tha Hamdiu, Kufitarët nuk kanë ushqim të tepërt. Atyne u duhet ushqimi ma tepër se neve. Ata ruejnë Atdheun, na ruejnë edhe ne. Në asnjë mënyrë nuk duhet të dinë se jemi pa bukë.

— Na thuej pra, si të bajmë? — pyetën shokët.

Hamdiu, serioz, por i vendosun tha:

— Të paksojmë racionin. Fundja ne nuk punojmë, pra edhe ushqimi që do të hamë na mjafton. Do të hamë vetëm një herë në ditë, në darkë. Në vend të bukës, do të hamë makarona ose nga një patate. A ka ndonjë kundërshtim?

— Dakord, thanë të gjithë. Dhe, për të largue shqetësimin, që u shkaktoi kjo bisedë, Faslliu muer fyllin dhe i ra melodisë së njohun të kangës partizane — Lule Sofo, lule djalë. Barinjtë, nën ritmin e fyellit u zunë dorë për dorë dhe filluen të kërcëjnë.

Ndërkaq bora binte me furi, murlani ulurinte dhe Shkëlzeni i pamëshirshëm trandte luginën me ortiqet. Kështu kaluen gjashtë ditë. Ushqimi i pakët dhe sidomos mungesa e bukës i dobësoi barinjtë. Fytyrat e tyne u zverdhën. Por fatosat nuk epe-shin. Ata vazhdonin jetën e përditëshme. Vetë nuk kishin ushqim, kurse dhitë ngopeshin.

Mëngjesin e ditës së shtatë barinjtë ndigjuen një krisëm pushke. Mandej dikush trokiti në pullaz dhe bërtiti:

— A jeni gjallë, o kreshnikë?!

— Qenka komandanti i postës! — tha Hamdiu.

U ngritën të gjithë dhe hapën portën. U desh gati një orë të hiqej bora që e kish zanë. Komandanti Sejdin, së bashku me një kufitar u futën në stan.

— Mirë se ju gjejmë! A jeni shëndoshë të gjithë? — pyeti Sejdini.

— Mirë jemi, shoku komandant — u përgjegj Hamdiu.

Sejdini i vrejti pjestarët e grupit dhe i ra në sy fytyra e tyre e zbehtë, sytë e futun thellë në gropa, shikimi i trishtë. Megjithatë buzëqeshnin, të gjashtë barinj të nuk ishin ata të parët. Ç'të kishin vallë? Mos u mungonte ushqimi?!

Komandanti, për të përshkue 800 metrat që e ndanin postën nga stani kish ba plot dy orë. Dëbora kish mbërritur në disa vende gjashtë metra. Stanit i dukei vetëm kulmi. Komandanti kish arritur në pullaz dhe meqë s'kishin ndigjue zhurmë, kish qitë me pushkë.

— Po ç'keni? Qënkeni zgjue vonë sot! Mos jeni ba dembela apo u mungon ushqimi?, — pyeti ai me shaka.

— Jo, ushqim kemi, sot u zgjuem vonë, sepse s'kemi punë.

— Ju diçka më fshihni! Pse jeni kështu të zbehtë?

— Keni ardhë nga drita dhe tani në errësinë ju dukemi të zbehtë! — tha Faslliu.

Por Sejdini nuk gënjehej lehtë. Sot ai kishte marrë një radiogram nga sekretari i komitetit të

partisë së rrethit. Partia ishte e shqetësuar për fatin e barinjve. Prandaj Sejдини erdhi t'i shohë.

— Përse nuk tregoni të vërtetën? — i qortoi.

Më tregoni ku e mbani miellin. — tha komandanti. Barinjtë vështruen njani tjetrin. Sytë e të gjithëve u drejtuen ke Hamdiu. Atij i përkiste me gënjje përsëri. Dhe Hamdiu i vendosun u përgjegj:

— Ç'nevojë keni me pa deri sa ne po ju themi se s'na mungon asgja?!

— E pra, unë nuk besoj! — bërtiti Sejдини dhe iu drejtue Sulejmanit. — Meqë Hamdiu nuk tregon, të përket ty Sulejman me u përgjegjë. Deri dhe ishte ushtar. Pra, përgjigju, siç i përgjigjet ushtari komandantit. A keni ushqime?

Sulejmani ngriti kryet:

— Ushqim kemi, shoku komandant, por... mielli... ka një javë që na u prish.

— I the keni qëndrue një javë pa bukë?! — bërtiti komandanti i nxemë. — Si nuk ju vjen turp?! Përse s'keni ardhë të kërkoni ke ne?

— Ju keni nevojë ma tepër se ne!

— Po të mos kishim ne kufitarët bukë, e t'ju kërkonim, a do të na jepnit?

— Patjetër.

— Pra, paskeni veprue si çilimij! Kjo nuk ju falet. Edhe ju, njisoj si ne, në këto kushte jeni ushtarë. A e dini se komiteti i partisë pyet për fatin tuej? Ç't'i përgjigjem unë? Se keni një javë pa bukë?

Barinjtë ngritën kryet të gjithë menjherë. Sytë u ndrisnin nga gëzimi e lumtunia. Zemrat e tyre gufonin plot dashuni për Partinë.

Gëzimet e para

Iku janari, iku dhe shkurti. Barinjve u dolën krahë të rinj. Posta kufitare u dha 2,5 kv miell gruni dhe ca ushqime të tjera. Tani nuk vuenin ma dhe hanin tri herë në ditë. Bora ndërkaq kish puschue dhe rrallë binte. Koha kalonte e bora kish fillue të shkrijë e vende vende u dukën gjurmët e shkambinjve të murmë.

— Nji ditë kur po u jepnin dhive tufakë, Hamdiu bërtiti:

— Shihni, nji dhi po shtërzon!

Iu afruen të gjithë dhe tue e fërkue e ndihmuen të lindte. Nuk kaloi shumë dhe dhia polli nji kec të zi, që dridhej nga të ftohtit. Rustemi e kapi dhe filloi ta fërkojë. Mirëpo dhia vazhdonte të dihaste.

— Ore, më duket se ka edhe nji tjetër?! — tha Hamdiu.

Vërtet, pas njizet minutash dhia polli kecin e dytë, po të zi.

Të çmendun nga gëzimi, barinjt i kapën edhe dhinë edhe kecat në krahë dhe vrapuen në stan. I afruen bri zjarrit. Dhia, e kënaqun nga nxehtësia e zjarrit blegërinte dhe lëpinte kecat e saj. Barinjtë e shihnin gjithë gëzim. Ishte lindja e parë në tufë, lindje në bjeshkët e Lumës, në mes të borës.

Gëzimin e parë e ndoqën gëzime të tjera. Dhitë filluen të pjellin njena pas tjetrës. Disa dhi lindën nga dy keca. Ishte i pari vit që ndodhte kështu.

U harruen ngjarjet e kalueme. U shtue puna e barinjve. Tash s'kishin kohë as të flinin. Me ra-

dhë banin roje natën, sepse dhitë që lindnin du-
beshin afrue pranë zjarrit.

Por së bashku me mundin, u shtue edhe ush-
qimi. Tani kishin edhe qumësht. E çfarë qumështi?
Kulloshtër dhie! Barinjte ngopeshin me qumësht.
Shpesh gatuenin qumështuer, i çili, edhe pse nuk
kishte vezë, dilte i shijshëm.

Mbas disa ditësh u çel edhe rruga. Mbas dy
muejsh, erdhi në stan krieri i kooperativës. Atë
ditë e kthyen në festë. Krieri suell letra e lajme
nga familjet. Kooperativa i përshëndeste Balcët e
rinj që triumfuen mbi Shkëlzenin. Në familjet
e bainjve të gjithë ishin mirë. Krieri, së bashku
me lajmet, solli cigare dhe gazetata.

Heronjtë u çmallën, lexuen, kuvenduen me ko-
rierin, kënduen kangë trimnie. Tash që rruga u
hap, korierët vinin njani mbas tjetrit. Erdhi edhe
brigadieri. Rexhepi, ma vonë edhe vetë kryetari.
Edhe komiteti i partisë i rrethit i uronte barinjte
për fitoren që kishin arritë mbi dimnin e Shkël-
zenit.

Gjashtë barinjte ishin të lumtun. Ata e kishin
krye si burrat detyrën që u ngarkoi kooperativa...

Epilogu ngjall shpresa

Në prill, çobanët e rinj, pas katër muej e
gjysmë largimi, u kthyen në Kërrnajë me tufën e
kooperativës. U pritën me gëzim nga gjithë koo-
perativistët. Lajmi muer gjithë krahinën. Kudo
pëshpëritej me çudi:

— E muerët vesh, kooperativa e Kërrnajës i dimnoi dhitë në Lumë të Gashit dhe s'pati asnji dantim.

— Nga dyqind e dhjetë dhi, muerën dyqind e katër keca.

— Dhjetë përqind e dhive pollën nga dy Dhitë shtuen një peshë prej 5 kg.

— Edhe rendimenti i gumështit u shtue.

Ishte me të vërtetë sukses i madh. Kooperativa e Kërrnajës nuk kish pasë një sukses të tillë asnji vit tjetër. Tufa e dhive e kaloi dimnin shëndoshë e mirë, kecat u dyfishuen, shpenzimet për ushqimin e dhive në dimën qenë të pakta. Suksesi i Kërrnajës u ba objekt bisedimi në rreth. Kryeagronomi i komitetit ekzekutiv të rrethit «Bajram Curri», anëtar i byrosë së komitetit të rinisë në rreth, u nis për në Kërrnajë për të bisedue me barinjte. Mandëj agronomi i entuziazmuem nga sa dëgjoi u nis me pa vendin ku dimnuen dhitë dhe ndejti në Lumë të Gashit disa ditë...

Gjashtë djelmosha të rinj, anëtarë të BRPSH-së, me heroizëm të pashoq treguen se rinia e ditëve tona, nën udhëheqjen e Partisë triumfon mbi çdo vështirësi, për të mirën e përbashkët, të atdheut dhe të socializmit.

Ja se çfarë të rinjsh, çfarë revolucionarësh edukon sot Partia jonë kreshnike.

(«Zëri i Rinisë» korrik 1966)

VATH KORESHI

MARSHIMI I MADH

«...Ju pyes për të fundit herë në doni të kthemi mbrapsht apo të vazhdojmë rrugën për të mbritur objektivin?»

Në rrugën e brigadës së parë sulmuese

16 Shkurt 1966

Kanë kaluar 22 vjet nga koha kur brigada e parë sulmuese, e komanduar nga shoku Mehmet Shehu, bëri inkursionin e saj të lavdishëm për t'i ardhur në ndihmë një pjese të Shtabit të Përgjithshëm që ndodhi i rrethuar në malet e Shëngjergjit dhe të Orenjit të Çermenikës. Partizanët e brigadës së parë kaluan vështirësi të panumurta në muajt shkurt — mars të vitit 1944, ata luftuan hap pas hapi me armikun, përballuan dimrin e madh ashtu të çveshur, të zbathur e të pangrënë, bënë natë e ditë rrugë të gjata përmes maleve e shtigjeve të mbuluara me dëborë.

Dhe ja, mbas 22 vjetësh, 1000 e ca të rinj e të reja të Shkollës së Bashkuar «Enver Hoxha» dhe të qyteteve të ndryshme të vendit tonë, nisen në këto gjurmë të lavdishme për t'u njohur me vështirësitë e panumurta që kaloi brigada, të kaliten dhe ata nën shembullin e partizanëve, nën shembullin e forcës së tyre të madhe morale e shpirtërore, të guximit dhe të trimërisë së tyre të rrallë,

13-14

të ndërgjegjes dhe pjekurisë së tyre të lartë politike. Duke kaluar në rrugën e brigadës së parë sulmuese, të rinjtë dhe të rejat do të shohin me sytë e tyre se ç'kalitje fizike dhe vullnet të hekurt kanë pasur partizanët, ç'moral të lartë dhe të paepur për të kaluar çdo vështirësi e pengesë.

Të rinjtë e të rejat, të veshur e të armatosur, me shamitë e kuqe në qafë e me këngë partizane në gojë, nisën ditën e parë të marshimit të madh.

Kolona ecën përmes rrugëve të kryeqytetit të mbushura plot e përplot me njerëz dhe drejtohet nga Peza. Kudo njerëzit urojnë udhë të mbarë, hedhin lule, nënat dalin nga trotuaret dhe i kapin në qafë këta partizanë të rinj që u sjellin ndërmend ditët e paharruara të luftës. Banda, që ecën në krye, ekzekuton marshe partizane e në këto çaste, të pushton një emocion i thellë.

Populli e përcolli kolonën gjer më të dalë të kodrave të kombinatit e më andej ajo nisi shtigjet ku kaloi brigada e parë sulmuese në shkurtmars të vitit 1944.

Në ecim në kolonë dhe mundohemi të marrim me mend rrugën që na pret, malet dhe luginat, të ftohtet, dëborën e shiun, netët pa gjumë, vendet e heroizmave të panumurta të partizanëve.

... Kemi katër orë e ca që udhëtojmë. Jemi afër Pezës. Rrugët janë me baltë, kollona është zgjatur shumë; tani ecim në rresht për një. Disa kanë filluar t'i vrasin këpucët, po ata e dinë se së shpejti këmbët do të mësohen e nuk tregojnë.

— Ç'ke ti shoqe? — e pyeti mjeku një vajzë që i ka dalë një fluckë në këmbë.

— Asgjë! — thotë ajo, — kisha lidhur pecet keq e tashti po i rregulloj.

— Dale ta shoh këmbën!, — i thotë prapë mjeku.



Atëhere ajo s'mund ta fshehë më.

— Po ti trego, — i thotë mjeku. — Ja, ta mjekojmë që tani, se pastaj të bëhet plagë.

Në Pezë hamë drekë dhe nisemi drejt fshatit Pajon. Një pjesë e brigadës do të flejë aty. Është errur, rrugët janë me baltë. Relievi është jashtëzakonisht i çrregullt. Këmbët rrëshqasin në baltë, dikush rrëzohet, po dheu është i butë e i rrëzuari nuk dëmtohet.

17 shkurt 1966

Mbrëmë fjetëm në Pajon. Një grup tjetër fjeti në Pezë, kurse grupi i tretë në Grecë.

Fjetëm në shtëpinë e një fshatari. Shtëpia ishte e re, ende s'i ishte hedhur tavani e nga hatllat frynte erë.

Me ne ish dhe sekretari i partisë së kooperativës së bashkuar të Pezës, Mersin Sinani. Ai tregonte:

«Unë isha i vogël, kur erdhi Brigada e parë në Pezë, e mbaj mend mirë e më kujtohet si tashti. Ceta e Pezës asokohe se ku kish shkuar për aksion e në fshat kishin mbetur vetëm pesë partizanë: katër pushkatarë e një mitralier. Unë rrija me partizanët; ndër ata të pesë njërin e kisha vëlla. Në krye të fshatit dalluam një kollonë të madhe. Kujtuam se ishin gjermanë. Partizanët u bënë gati të hapnin zjarr, bile shtinë nja dy herë në erë. Kollona ndali. Mbasi u muarën vesh, ata erdhën. Shoku Mehmet ishte në krye. U thotë partizanëve:

— Si? Me pesë vetë do t'i hapnit zjarr gjithë këtij vargani?

Njëri nga partizanët iu përgjegj:

— Nja dy orë do të qëndronim po të ishin gjermanët. Pastaj do të ngrihej gjithë fshati e do të na vinin në ndihmë».

...Rrijmë rreth zjarrit që bubullon në oxhak e dëgjojmë histori nga të Brigadës së parë.

Gjeneral-major Vehbi Hoxha, duke sjellë ndër mend vitet e luftës, si pjesëtar i Brigadës së parë, tregon për ardhjen në Pezë.

Nga ora nëntë ramë për të fjetur, ashtu partizance, shtrirë nëpër qoshe me gjithë rroba. Mbas udhëtimit të ditës së parë, na zuri një gjumë i thellë dhe i këndshëm.

... Dikush ngrihet dhe shkel në dysheme me këmbët zbathur. Vesh këpucët, del jashtë, merr ca shkarpa dhe vjen e ndez zjarrin. Zgjohe mi një nga një. Ora ende s'ka shkuar 4,30 e jashtë është errët. S'jemi mësuar të ngrihemi kaq herët, sytë na dje gin. Po sot kemi për të bërë rrugë të gjatë.

Nisja bëhet në orën pesë. Kodrat janë ende të zeza e në qiell yjet e rralla dridhen e vezullojnë me një dritë të ftohtë. Ecim. Zërat në mëngjez herët dëgjohen gjer larg. Zërat e këndezeve nga fshatrat përreth lajmërojnë agimin. Udhëtojmë drejt Grecës. Rruga dredhon në faqe kodrash dhe herë-herë varet anës përrenjve me brigje argjilozë. Sa vjen e terreni bëhet më i vështirë. Para ca ditësh ka rënë shi e ne e kemi të rëndë ngjitjen në shpate. Këmbët rrëshqasin, herë-herë na futen në baltë gjer në nyje, po ky është vetëm fillimi. Rruga është tepër e gjatë dhe ne mbahemi fort. Kemi kaluar Grecën. Udhëtojmë drejt Kaziasit. Ky fshat është shumë larg. Përshkojmë një luginë ku dredhon një përrua me ujë të turbullt. Përroi është shumë i bezdisëshëm, ai, si për inat, na del gjithmonë përpara e ne po e kalojmë atë në vah përmbi 40 herë. Pastaj i ngjitemi një kodre mjaft të vështirë. Këtu kollona sa vjen e rrallohet dhe bëhet më e gjatë. Ajo dredhon, si një shirit i pasosur, nëpër monopate, ashtu me uniformë kaki, plot shalle të kuq e armë që herë-herë shkëlqejnë në diell. Të përpjetat thi-

kë janë të vështira për t'u ngjitur. Këtu s'fryn asnjë grimë ere, ke nevojë të mbushesh me frymë. Djersa na rrjedh në fytyrë, na hyn në sy e sytë ra djegin. Herë-herë dëgjohen thirrjet e komandantëve: «Mos e këputni kollonën, shokë! Ecn! pak më shpejt!»!

Kalojmë Kazijasën e në orën 18, mbas 12 orë udhëtimi, arrijmë në Çepan, buzë Shkumbinit. Në këtë fshat do të flemë, për të vazhduar udhëtimin më tutje, drejt jugut.

Në qiell mbledhen re. Bien pikat e para të shiut.

18 shkurt 1966.

Mëngjesh me shi. Ai ka rënë gjithë natën, vazhdon të bjerë dhe tani me ca pika të dendura e të imta. Fushat, arat, rrugët janë mbytur nga ujrat e turbullta e atje poshtë, mbas xhadesë, rrjedh Shkumbini i fryrë breg më breg.

Kështu i fryrë breg më breg ish Shkumbini edhe 22 vjet më parë, kur Brigada e parë sulmuese, pasi përfundoi me sukses inkursionin, u hodh në Pezë e prej këndej mori rrugën për në Jugë. Ish një natë e errët si pus, kur partizanët iu afruan Shkumbinit. Dallgët përplaseshin me një uturimë shurdhonyjëse. Koha nuk priste. Çastet sa vinin e bëheshin më kritike. Pikërisht në vëndin ku kaloi para pak kohe Brigada, ndaloi një auto-blindë armike që hodhi një raketë të kuqe. Duhej kaluar sa më shpejt Shkumbini. Po me se? Urë nuk kish, varkë nuk kish. «Batalioni i parë të kalojë

lumin!» urdhëroi komandanti i Brigadës. U kontrollua vahu dhe partizanët notarë e më të fortë fizikisht formuan një «gardh» tejpertej lumit. Pranë tyre të kapur dorë për dore kaluan partizanët në atë ujë të akulltë e në ato dallgë që ishin gati të të përplasnin në breg. Por dallgët, ah këto dallgët, çë rrëmbyen një luftëtar dhe e morën me vete! Ai ishte Muharrem Gjerbësi, që i qëndroi aq trimërisht inkursionit. Por brigada shpëtoi edhe njëherë, pa i dhënë kohë armikut ta rrethojë. Edhe vetë armiku u çudit me këtë manovrim të shkëlqyer të partizanëve të Brigads së Parë. Ja ç'thuhet në një dokument: «Çuditemi si Mehmet Shehu brenda dy ditëve të ketë kalue Shkumbinin me 500 veta, kurse lumi asht ende i pakalueshëm dhe të mos jetë diktue tue kalue me ura e barka».

E shoh Shkumbinin të fryrë breg më breg e mundohem të gjej atë vend ku kaluan partizanët, të shoh atë vend ku valët e pamëshirëshme e shkëputën nga gjiri ynë partizanin trim...

...Në Shtërmën arritëm në mbrëmje.

19 Shkurt 1966

Kemi udhëtuar rreth 100 km. Një pjesë e brigadës kaloi Devollin në vah e u nis drejt kodrave të Sulit, kurse pjesa tjetër udhëton drejt Darzezit. Ne ecim paralelisht me batalionin, që ka kaluar Devollin e me ta, do të takohemi ose sonte natën në Lubinjë, ose nesër në mëngjes në Tunjë.

Kemi filluar ta ndjejmë lodhjen më tepër, po të gjithë ecim normalisht e asnjëri s'mbetet mbas

kollonës. Me peshën që mbajmë po mësohemi e supet s'na dhëmbin më. Koha vazhdon të mbajë mirë, rruga është e shtruar, po së shpejti dhe batalioni ynë i dytë do të hidhet në bregun e majtë të Devollit e që andej nisin të përpjeta të thepisura.

— Kollona, pregatitu për të kaluar përruan! — urdhëron komandanti i batalionit që nga kreu i kollonës. Kemi arritur buzë një përroi që rrjedh rrëmbyeshëm në shtratin gjithë gurë të përhimë e që degëzohet në disa vende. Marshonjësit vijnë e grumbullohen buzë përroit, heqin këpucët e futen në ujin e ftohtë që të mpin këmbët. Disa s'i heqin fare këpucët e futen duke hedhur këmbët në gurë të mëdhenj, po uji u futet në këpucë e këmbët u lagen. Shokët i marrin në shpinë e i hedhin në bregun tjetër ata që i kanë këmbët e sëmura.

Mbas kalimit të përroit na duhet të hedhim Devollin në një urë teli, shtruar me dërrasa. Ura është e gjatë, ujrat e Devollit rrjedhin të turbullta, plot dallgë e zhurmojnë me një uturimë të mbytur. Kalojmë në urë një nga një, ura lëkundet e të mirret mendja, kur shikon poshtë atë masë ujrash që rrëshqet midis dy brigjeve të gjëra. Shumë nga «partizanët» të zënë dorë për dore mbajnë njëri tjetrin.

— Ej, kini kujdes, mos u nxitoni!

— Mos vështroni poshtë, po përpara, diku tek ato kodra!

— Pa, pa... — ja bën një tjetër që sapo e ka kapërcyer Devollin. — Më zuri lumi.

Kalimi i lumit na hëngri shumë kohë. Mbas tij na u desh të çvishemi prapë e të kalojmë në një përrua tjetër.

Devoll! Devoll! Me sa gëzim do të të kenë kaluar partizanët e Brigadës së parë natën e 21 marsit. E kishin të drejtë! Pas një muaji vështirësish të mbinatyrëshme, ti ishe pengesa e fundit, por një pengesë e vogël me ato mure vigane të maleve të Shebenikut, Qarrishtës, Gështenjasit, Letmit, Kaptinës që kapërcyen heronjtë.

Një nga pjesëmarrësit e këtij marshimi na tha:

— Si kaluam Devollin, hymë në zonën e lirë të Sulovës. As unë nuk mund ta shpreh dot atë gëzim që ndjemë kur hymë në këtë zonë, ku frynte flladi i lirisë. Këtë ndjenjë do ta kuptoni më mirë, kur të njiheni me gjithë rrugën e inkursionit. Qe një rrugë shumë e vështirë. Do ta shihni edhe vetë... Ja arritëm në Darzezë. Këtu batalioni qëndron për të ngrënë bukë. Në një lëndinë të madhe «partizanët» ulen, hapin çantat e nisin të hanë.

Mbas buke dëgjohet boria: «Bëhu gati për marshim!» dhe pak më vonë: «Kollonë, marsho»!

Kjo është e katërta ditë e marshimit e sot nis një ndër pjesët më të vështira të rrugës sonë. Kodrat e Darzezit, ca kodra argjilozë plot përrenj e shkarrëzima, janë të larta dhe të thepisura. Ngjitja është shumë e lodhëshme. Udhëtojmë drejt fshatit Kudriqar e pastaj për në Lubinjë ose në Tunjë. Në se marshimi s'do të jetë shumë i lodhshëm, ne do të shkojmë në Tunjë, ndryshe do të ndalemi në Lubinjë. Pyesim se sa mban Tunja e na thonë se është nja tri orë larg, po ne kemi dy orë e ca që udhëtojmë e prapë na thonë se ajo mban po tri orë larg.

Në Kudriqar arrijmë me nja një orë ditë. Aty s'ndalemi fare e ecim më tutje. Rruga tani është më

e përpjetë, ajo herë kalon në kurrize me bojë hiri, herë nëpër shtigje të ngushta e me baltë dhe herë buzë humnerash, ku bien ca si katarakte me ujra të shkumbëzuara.

Po të gjithë janë shpirtërisht të vendosur për ta kaluar këtë udhë të vështirë, e kollona ngjitet e ngjitet.

Para meje ecën një vajzë. Atë e quajnë Floresha, punon në Kombinatin e Tekstileve «Stalin». Floresha është e fortë dhe asnjëherë s'mbetet prapa.

— Më jep mua ta mbaj pushkën! — i thotë një shok.

Po Floresha s'dëgjon.

— Jo, — thotë — pushkën e mbaj vetë, unë s'jam lodhur.

Mbrëmja na zuri larg Lubinjës, në një luginë rrethuar me kodra plot dushqe të çveshura. Këto kodra ngjajnë me koka të qethura karë. Mbrëmja është e butë, qielli skuq andej nga perëndimi e rrugët janë kredhur në hien e maleve. Tani e kemi vështirë të udhëtojmë. S'shohim ku hedhim këmbët, shpesh rrëshqasim, sepse dëllinjat i kujtojmë për gurë, vëmë dorën të mbahemi e sakaq zhytemi në degët e dëllinjës.

«Shok, mos e këput kollonën!» — thotë dikush nga kreu. Kjo fjalë kalon gojë më gojë deri në fund e të gjithë nxitojnë të rrinë njëri mbas tjetrit. Rruga herë-herë futet në pyje shkorretash e dëllinjash, degët të përplasen në fytyrë e po u largove 3-4 metra s'e sheh më shokun që ecën para teje.

Nga thellësia e luginës vjen e dëgjohet gjith-

monë e më fort një zë që e përsërisin me radhë marshonjësit:

— Kujdes nga e djathta! Humnerë!

Ecim. Të dridhen gjunjët kur buzë humnerës shikon një pus si të zi. Gjashtëdhjetë a shtatëdhjetë metra thellë rrjedh një përrua. Rruga, që kalon në buzë të saj, është dy-tri pëllëmbë e gjërë, nga e majta qëndron shkëmbi e këtu gabimi, pakujdesia më e vogël, është fatale. Fshatari që na shoqëron tregon se aty është rrëzuar një dhi që është bërë copë-copë.

Kalojmë Kudriqarin, Sulthin e tani rruga do të na xjerrë në fshatin Dushan. Është bërë natë me kohë, një natë e errët dhe e qetë malesh. Kemi gjithë ditën që udhëtojmë, muskujt na dhëmbin e tani të përpjetat sa vijnë e bëhen më të thepisura. Para nesh duket një kodër e zezë, ajo është e lartë e ne, për të arritur në Dushan, duhet ta kapërcejmë edhe atë. Nga Tomorri fryn një erë e ftohtë po ne jemi të nxehtë dhe kënaqemi me atë duhi ledhatare.

— Ej, Stefan!

— Nuk jam Stefani.

— Po kush?

— Jam një shok tjetër.

— O Stefan!

— E, ore!

Këtu, në marshim e sipër, s'e njeh dot shokun. Të gjithë janë veshur njësoj, pastaj është dhe natë. Përpara nesh u rrëzua një vajzë. Asaj i rrëshqiti këmba e pushka e vrau pak në gju.

— Ç'pate?

— Asgjë, asgjë! — thotë ajo duke u ngritur

e duke rregulluar pushkën në sup. Niset, po çalon. Atëhere i afrohet një shok; i merr pushkën; e kap për krahu dhe e ndihmon të ecë. Të gjithë këtu e quajnë veten pjesëtarë të një familjeje, motra dhe vëllezër.

Në Dushan arrijmë vonë. Aty mbetën dy kompani për të fjetur, kurse të tjerët vazhduan rrugën për në Lubinjë. Ajo që këtu, mban ende dy orë...

Fshatarët na presin kudo mirë, me bujarinë karakteristike të shqiptarit.

Nesër nisemi për në Jançë e pastaj në Dardhë, në rrëzën e Tomorrit.

Mbas kësaj lodhjeje të madhe, na kap një gjumë i thellë dhe i rëndë.

Në gjurmët e Brigadës së parë sulmuese

20 shkurt 1966.

Sot rruga është shumë e bukur. Unë udhëtoj me batalionin e parë. Pjesëtarët e tij janë djem të gëzuar, të fortë, të paepur para vështirësive.

Më afrohet një kursant që mban pushkën dhe një çantë në kurriz. I ngjitemi një të përpjete të lodhëshme. Kursantin e quajnë Petrit Dervishi.

— Ma jepni ta mbaj pak çantën tuaj — më thotë ai.

— Po ju keni peshë të rëndë vetë.

— Jo, s'ka gjë — ma pret ai — ne jemi mësuar.

Dua s'dua i jap çantën ta mbajë për ca kohë. Andej nga mezi ja marrin një këngë. Këndojnë këngë partizane dhe këngë popullore. Tenori e dredh bukur zërin. Ai është një djalë i gjatë me flokë të verdha.

— Këndoni një këngë popullore si andej nga ana juaj! — i thonë.

Dhe ai ja merr:

«Më rrite, moj nënë, më rrite...»

Zëri i dytë i vete pas, shumë i ëmbël, si gurgullimë e thellë përroi. Këto këngë i bëjnë të bukura, të lehta udhëtimet tona.

Pas pak arrijmë në malet e fshatit Gjançë. Që këtej hapet një panoramë e bukur dhe e gjërë. Nga perëndimi syri të zë Shpiragun, Therepelin, një liqen zhytyr i tëri në një mjegull të kaltëreme, një mori fshatrash me shtëpi të bardha; rezervuari i Thanës dhe Semani që dredhon tutje kodrave, duken teposhtë.

Ndërsa ecim dëgjojmë dy breshëri automatiku. Zhurma e të shtënave merr grykat dhe luginat e shkon tutie maleve. Mbas dy breshërive të para dëgjohet dhe një breshëri tjetër. «Ç'të jenë këto të shtëna — pyes — në lartësi të maleve, në rrugën e butë që gjarpëron mes pyjeve e shkoretave?»

Ecim dhe ca e në të majtë të rrugës, në mes të një lëndine të vogël mbuluar me bar ngrihet një lapidar me gurë të përhimtë. Inkursionistët vihen në radhë pranë këtyre gurëve të çmuar, që na kujtojnë shokët e rënë. Rrimë një çast të heshur, duke vështruar pllakën dhe pastaj ecim prapë.

Në pllakën përkujtimore shkruhet: «Lavdi dëshmoreve që dhanë jetën për lirinë e popullit».

Gjithmonë e më shpesh takojmë gjurmët e luftës partizane. Po hyjmë në zonën e Tomorricës. Përballë ngrihet Tomorri dhe të tjera male të larta mbuluar me dëborë. Këto maja janë të rrepta e ngrihen në qiell si bedenat e një kalaje vigane. Lartësia që udhëtojmë ne është 1000 e ca metra mbi nivelin e detit, megjithatë Tomorri duket mjaft i lartë.

Mbasdite vonë arrijmë në fshatin Dardhë. Ky është një fshat rrëzë Tomorrit dhe këtu të lind përshypja se të gjitha tokat janë me taraca, që vijnë shkallë shkallë njëra pas tjetrës.

Më qëlloi që në mbrëmje të shkoja në shtëpinë e ish kryetarit të këshillit nacional-çlirimtar gjatë kohës së luftës, në shtëpinë e Tefik Ballanit. Xha Tefiku është rreth 60 vjeç. Ne pyesim në mban mend gjësendi për Brigadën e Parë.

Ai përgjigjet: — Posi jo, more bir, më kujtohet, posi. Një ditë këtej nga ana e Tomorrit erdhi Brigada e Parë. Shoku Mehmet erdhi në shtëpinë time. Ai më tha:

— A ka vend për nja tetëmbëdhjetë veta?

Unë ja ktheva:

— Bujrum, po konaku që kam s'i nxë të gjithë.

Në ato kohra s'kisha këto shtëpi që kam, po një palë të vjetra e një konak përdhes.

E mora shokun Mehmet dhe shokët e i çova te Ali Benallari. Aliu është dhëndri im. Atje i çova të gjitha shtresat e mbulesat që kisha.

Xha Tefiku tregon ngadalë dhe sjell ndër mend kujtimet e atyre viteve. Në mëndjen e zem-

rën tonë ato kujtime kanë mbetur gjithmonë të freskëta. Kur pyet njerëz të ndryshëm për ato vite, ata tregojnë edhe detajet më të vogla.

21 shkurt 1966.

Jemi në Qafë-Dardhë. Këtu vendi është i sheshtë, plot lëndina me bar. Pisha të larta mbushin ajrin me aromë rrëshire. Jemi pikërisht në vendin ku 22 vjet më parë, 21 shkurt 1944, Brigada e parë u nis në inkursionin e saj drejt veriut. Rruga që kemi kaluar gjer tani, është rruga që ka bërë brigada mbasi kreu misionin e saj. Sot dita është e bukur me qiell të qëruar. Në atë ditë të shkurtit 1944 këtu në Qafë-Dardhë kishte 50 cm. dëborë. Është ftohtë. Këtu shoku Vehbi Hoxha u tregon inkursionistëve për gjendjen e Shqipërisë në atë kohë, për detyrën e rëndësishme luftarake që iu ngarkua Brigadës së Parë në ndihmë të Shtabit të përgjithshëm. Në detyrë thuhej se një pjesë e Shtabit të përgjithshëm, midis të cilëve ndodhej edhe shoku Enver Hoxha, kishte mbetur i izoluar në malet e Shëngjergjit dhe të Orenjit të Çermenikës. Brigada e Parë Sulmuese duhej të arrinte me çdo kusht objektivin e caktuar dhe të siguronte kthimin e kësaj piese të shtabit në jugë. Në letrën që shoku Mehmet Shehu mori nga Shtabi i Përgjithshëm thuhej: «Shtabi i Përgjithshëm ka mbetur i izoluar, jeton nëpër pyje. Sikurse na lajmërojnë ka rënë disa herë në përpjekje me gjermanët dhe ballistët, pra shtabin e kemi në

rrezik. Duhet ta shpëtojmë patjetër. Shpëtimin e shtabit duhet ta bëjë Brigada e Parë.»

Pastaj në shenjë nderi dhe rifillimi të kësaj rruge të lavdishme nga inkursionistët e rinj, dëgjohet një buçimë. Tani nis pjesa më e vështirë e marshimit tonë. Përballë nesh ngrihen male me dëborë, luçina të thella, ku rrjedhin përrenj të rrëmbyeshëm, oafa të larta mbuluar nga pyjet. Sot duhet të arrijmë në Gurazezë. Udhëtojmë duke zbritur një rrugë plot gurë në shpat të Tomorrit. Marshonjësit ecin në njëshkollonë e kjo zgjatet e zgjatet një km. e gjysëm.

E zbritura thikë t'i këput gjunjët, të lodh e të raskapit. Nxitoimë që përroin e Tomorricës ta kalojmë me ditë. Ky është i rrëmbyeshëm, me ujë të ftohtë e me një shtrat plot gurë. Në vaun e përroit arrijmë në orën 16,30.

Të gjithë heqim këpucët, përvishemi deri në giu dhe hyjmë në ujë që të ngjeth mishtë. Në bregun e djathtë grumbulli i atyre që presin për të hedhur vaun bëhet gjithnjë e më i madh.

Përroi kalohet në 3-4 vende. Jepet urdhëri që marshonjësit të mos xhvishen, po ta hedhin vaun si janë. Inkursionistët futen në ujë me gjithë këpucë. Kollona lëviz me shpejtësi.

Anës së përroit duket një helikopter. Ai ndez motorin. Elika e madhe nis rrotullimin dhe mbas pak, helikopteri ngrihet e duke çuar pluhurin duman vjen drejt nesh. Pastaj ai ulet pranë kollonës sonë.

Sot tek ne ka ardhur kandidati i Byrosë Politike shoku Petrit Dume. Mbas takimit që patëm në Shkollën e Bashkuar «Enver Hoxha» në Tiranë,

ky është takimi i dytë. Ai zbret nga helikopteri dhe futet midis nesh e na pyet si e kemi kaluar gjatë kësaj kohe. Pastaj na flet për vështirësitë e reja që na presin, të cilat ne duhet t'i kapërcejmë duke vënë të gjitha forcat tona. Ne duhet të arrijmë në Tiranë në ditën e caktuar e këtë qëllim do ta realizojmë. Takimi me shokun Petrit Dume që i papritur dhe na përtëriu forcat.

Vazhdojmë të ecim. Nata na zuri pa kaluar vahun e përroit të Tomorricës. Kollona fillon të ngjitet shpatin e djathtë të përroit, një shpat i veshur me pyje të dendura e të errta.

Ajo që na pengon shumë tani është balta. Këpucët tona futen thellë në batak, mezi i heqim këmbët duke u mbajtur në degët e shkurreve. Nata është pa hënë, qielli plot yje dhe këtu në mes të pyllit mezi dallon vetëm dy tre metra për rreth.

Herë pas here në pika të ndryshme të kollo-nës dëgjojmë fishkëllima të zgjatura që çajnë hesh-tjen e natës. Janë sinjale për të mos humbur rru-gën. Duhet të nxitosh që të mos humbasësh nga sytë shokun që ecën para teje, ndryshe mund të ndrrosh drejtim e të mbetesh nëpër pyje që hesh-tin me një qetësi të thellë.

Rruga është jashtëzakonisht e vështirë. Ora është 19 dhe ne s'kemi arritur ende në fshat. Si duket sonte s'do të shkojmë në Gurëzezë, po në Gieric e Zhepë, dy fshatra që janë po aqë larg, po që janë më pranë Gurit të Prerë, nga do të kalojmë nesër.

22 shkurt 1966

Në Gjericë e Zhepë arritëm në orën 9 të mbrëmjes. Këto janë dy fshatra të Skraparit, futur thellë midis malesh.

Dita e shtatë e marshimit tonë. Udhëtojmë nër në Moglicë të Korçës. Rruga në drejtim të Gurit të Prerë është shumë e përpjetë dhe na lodh së tepërmi. Ja, para nesh, duket një gur i madh si një trung gjigant pa degë. Në këtë vend është bërë një ndër betejat më të mëdha të Luftës Nacional-Çlirimtare, një ndër përpjekjet më të përgjakëshme të partizanëve me forcat gjermane gjatë operacionit të qershorit.

Forcat gjermane kishin për qëllim t'i rrethonin dhe t'i asgjësonin partizanët në zonën e Tomorricës së Tomorrit dhe në malet e Lenies. Përveç forcave që kishin në Shqipëri, gjermanët prunë nga Greqia dhe dy divizione malore dhe u nisën drejt këtyre zonave, në drejtim të Tunjës, Shëmbërdhenjës dhe Beratit. Forcat partizane përbëheshin nga forcat e Brigadës së I, të V dhe të IV. Këtu luftuan me bajonetë, trup me trup. Partizanët e tri brigadave treguan shembuj heroizmi dhe guximi të rrallë. Nga Brigada e I mbetën tetë shokë të rënë, nga e V mbi njëzet vetë.

Inkursionistët tani janë ulur në një shesh e dëgjojnë shokun Vehbi Hoxha, që flet për këtë betejë. Pastaj, në shenjë nderimi të thellë, çohemi në këmbë e qëndrojmë një minutë në heshtje.

Grupi i inkursionistëve bën një të shtënë me mortajë.

Që këtu duket Moglica. Arat e saj janë për-

hapur në faqet e maleve të Lenies. Duhet të zbre-
sim një tatëpjetë shumë të madhe deri në brigjet e
Devollit dhe të ngjitemi prapë lart. Dy batalionet
e brigadës sonë vihen në lëvizje. Në lokalitetin e
Moglicës kishin dalë shumë fshatarë, të rinj e të
reja, për të na pritur. Ata erdhën me të na parë.
Në sheshin para lokalitetit u formuan grupe me
inkursionistë e fshatarë. Inkursionistët flisnin për
rrugën e tyre, por edhe fshatarët tregojnë me sa
mbajnë mend, për ditët kur Brigada e Parë kaloi
këtej...

Mbas një pushimi të gjatë nisemi për në Go-
besh. Aty arrijmë në mbrëmje. Në fshatin Go-
besh shkova në shtëpinë e Veli Pulës, ku në marsin
e vitit 1944 ndënji tri ditë shoku Enver Hoxha
me disa shokë të komandës së Shtabit të Përgjith-
shëm, pasi ikën nga malet e Renjës, ku ishin të
rrethuar.

Xha Veliu, një plak gjashtëdhjetë vjeçar, ësh-
të i mbajtur mirë, me fytyrë të mbushur e të ku-
qe. Ai flet shtruar.

Sonte në shtëpinë e Xha Velikut jemi trembë-
dhjetë veta dhe provojmë një emocion të veçantë
që flemë në shtëpinë ku ka fjetur dhe shoku Enver.

Xha Veliu tregon:

— S'e mbaj mend mirë, po më duket se ka
qënë fundi i marsit, kur shoku Enver erdhi në shtë-
pinë time. Vëllaj im, Jakupi asokohe kish shkuar
te një miku ynë, Tare Dvilmishti, në fshatin Zo'aj.
Në shtëpinë e Tares takoi shokun Enver me sho-
kët. Shoku Enver donte të hidhej në zonën e To-
morricës, po Devolli ishte fryrë me ujë e nuk ka-
lohej dot. Atëhere Jakupi i shoqëroi që të hidhe-

shin në anët tona e pastaj të shkonin nga Lozhani. Erdhën këtu në qafën e Shënepremtes shoku Enver, shoku Spiro Moisiu e të tjerë.

Ishte mëngjes e binte një vesë shi. Jakupin ata e veshën si partizan që të mos e njihte fshati dhe zbritën poshtë. Në krye të fshatit u takuan me një fshatar e shoku Spiro i tha:

— Mos e dini shtëpinë e një Veli, Veli Pulës? E kam mik, po s'kam qënë ndonjëherë.

— Ja, po ju çoj unë — u tha fshatari.

— Jo, jo se e gjejmë vetë, thanë ata dhe u nisën e erdhën.

«Kishin udhëtuar gjithë natën përmes vendeve ku ishin ballistët dhe ishin vrarë e dërmuar nga këmbët. Shoku Enver kishte mbathur një palë këpucë që ishin me grykë (me qafa), një xhamadan e një qeleshe të bardhë si elbasanlli. Të them të drejtën, unë s'e njoha kush ishte shoku Enver. Mbas buke më tha se ishin partizanë dhe aq. Një natë, si e kishin pikasur se unë kisha partizanë në shtëpi, erdhi tek unë një Hasan, që ishte komandant i çetës partizane në këtë vend.

— Çfarë je? — i thotë shoku Enver.

— Jam komandant i vendit — ja pret Hasani.

— Po ti kush je?

— Unë jam Hasan Hoxha nga Elbasani — ja ktheu shoku Enver.

«Komandanti i vendit u ngrit, iku dhe unë e dija se burri me qylaf të bardhë ish Hasan Hoxha. Ndenjën tri ditë në shtëpinë time. Ata s'kërkonin gjë, u epnim ç'hanim vetë dhe rrinin tok me çiliminjtë tanë.

Por nga shtëpia nuk dilnin. Nganjëherë rrinin

në oborr. Kishin automatikë. Vetëm një partizan, që i shoqëronte, një djalë i ri nga Berati, mbante pushkë.

«Pas tri ditësh u ngritën e ikën. Hëngrën drekën dhe dolën përmes shiut. U dhamë nja dy kafshë dhe ata zbritën nga Gobeshi në Vërri e në xhade. Shkonin për në Lozhan. Pas një muaji e mora vesh se ai kishte qënë shoku Enver Hoxha.

Male, o male!

Shkelim në rrugë malesh, shtigje malesh. Është e dhjeta ditë që para syve tanë ngrihen vazhdimisht të përpjeta të thepitura, maja të mprehta dhëmbë-dhëmbë mbuluar me dëborë, lugina të gjata, plot brinja si damarë që bien thikë në shtrete përrenjsh.

Është e dhjeta ditë që ne shohim gurë të përhimtë nëpër rrugë dredha dredha, e dhjeta ditë që kemi pranë hiet e maleve të rrepta, vargjet e tyre të pasosura që çajnë kryq e tërthor relievin e fortë të Shqipërisë.

Në ditët e para sikur na trembte ashpërsia dhe lartësia e maleve, po tashti këmbët na u mësuan e këto pirqje vigane, që çojnë kryet gjer tek retë, na janë të dashura dhe të buta. Ne hypim e zbrezim nëpër dredhat e rrugëve, e pas mbeten njëri pas tjetrit malet e forta dhe të larta. Kur kthen kokën prapa e sheh vargjet e tyre të murrme, që shkëlqejnë në horizont, sikur s'të besohet që në to ka kaluar kollona jonë e gjatë dhe e fortë.

Male, o male!...

Kur na del përpara një shtrat dëbore, ne shtrëngojmë kollonën, ecim pranë njëri tjetrit. Pas mbetet vazhda e gjatë e gjurmëve tona. Në u rrëzofsh, shpejt të zgjatet dora e shokut që ecën pas teje, në ke nevojë të mbahesh për të zbritur diku, prapë dora e shokut zgjatet e të mban. Dhe këtu jemi miq të ngushtë, miq me të 1000 marshonjësit. Gjatë një rruge kaq të gjatë, të vështirë dhe të bukur është e pamundur të mos bjerë rasti të mbahesh tek supi i një miku, të mos i kërkoksh thikën një tjetri për të prerë bukën, të mos kërkoksh pak ujë nga paguri i një marshonjësi, të mos këmbesh dy fjalë me një njeri që ecën para teje me torbën e ushqimeve në shpinë dhe me pushkën në sup. Dhe kështu nis e lind një miqësi e vërtetë, miqësi shokësh, që shkojnë të gjithë në një rrugë.

Në fillim ne s'dinim të ecnim si duhet nëpër një të përpjetë mali plot gurë që rrokullisen, s'dinim të ngjithnim një të përpjetë të lodhëshme dhe tani ne të gjithë u mësuam si të mos na shkasë këmba, me çfarë hap të marrim të përpjetën, në ç'kohë duhet të bëjmë pushim.

Dhe kudo që shkojmë, na presin me atë bujarinë karakteristike të shqiptarit: me bukë, kripë e zemër.

Sonte jemi në shtëpinë e Adem Kastriotit në fshatin Çezëm e Madhe të Mokrës. Në mes të dhomës bubullon soba, mbi oxhak ndriçon një llambë vajguri. Me mua janë dhe shtatë shokë të tjere.

Malet e Lenies me maja të mbuluara me dëborë duhet t'i kalojmë nga qafa e Kroit të Bardhë. Sot në mëngjes fryn nga lindja një erë e ftohtë dhe e fortë. Në qiell janë mbledhur disa grumbuj resh bojë hiri. Shi a dëborë do na zërë rrugës?

Sot në kollonë u bë një ndryshim. Deri këtu rrugën e ka udhëhequr batalioni i parë, i përbërë nga kursantët e Shkollës së Bashkuar «Enver Hoxha», kurse që këtej e tutje, do ta udhëheqë batalioni i dytë, i përbërë nga të rinjtë e të rejat e qyteteve të ndryshme. Batalioni i dytë merr urdhër për të nisur marshimin e kolona nis të lëvizë drejt fshatit të Kroit të Bardhë.

Në këtë batalion do të gjesh kaq e kaq të rinj e të reja të palodhur, që kanë ecur edhe zbathur, që s'kanë marrë parasysh asnjë dhëmbje, por kanë marshuar hap pas hapi me kollonën.

Ja, i afrohem i një djali me trup të gjatë, me flokë të zinj e me një vështrim të qeshur. Atë e quajnë Qemal, është një i ri nga Durrësi.

— Si Qemali s'kemi më të fortë, — na thanë ata të kompanisë së tij.

— Po pse?

— Ehu! Ai që nga Tirana e gjer këtu s'e ka hequr kurrë mitralozin nga supi. Gjithmonë vetë e mban, megjithqë mitrolozin duhet ta mbajë me radhë e gjithë skuadra.

Qemali buzëqesh e ecën me çap të lehtë, duke shkelur mbi gurët e rrugës. Ai është i fortë dhe energjik.

Po si Qemali ka kaq e kaq të rinj. Për ta mund të bëhej një listë shumë e gjatë.

...Disa Qafën e Kroit të Bardhë e kaluan e kështu u futën në malet e Gorë-Oparit. Era vazhdon e furishme. Të rinjtë mbahen njeri pas tjetrit gjatë kohës që ecin nëpër një luginë. Ata kanë ngritur jakat e peliçeve. Në kokë kanë vënë kokoret prej leshi. Rruga është e vështirë; mbrëmë ka rënë shi e tani balta s'na ndahet në asnjë vend. Ja, tani ndodhemi në zonën me dëborë. Ajo është e trashë dhe e ngrirë. Në mbrëmje arrijmë në Velçan të Gorës. Sonte do të flemë këtu. Unë me tre veteranë e disa shokë të tjerë do të shkojmë në shtëpinë e Hekuran Sadikllarit.

Veteranët janë shokët Hamit Kotoni, Sarafin Meçja dhe Sotir Andoni. Ata kanë qenë pjesëtarë të Brigadës së parë sulmuese dhe i kanë përshkuar këto anë në dimrin e vitit 1944, gjatë inkursionit të lavdishëm. Mbas njëzet e dy vjetëve ata e përshkojnë përsëri këtë rrugë dhe janë ende të fortë e të palodhur. Ata ecin njëlloj me ne e herë pas here tregojnë episode të ndryshme.

Shoku Hamit Kotoni është një burrë rreth dyzetepesë vjeç, me trup të bëshëm dhe të fortë. Ai ka qënë në batalionin II të Brigadës I Sulmuese dhe, duke bërë fjalë për inkursionin e 1944, nis e tregon:

«Kur u muar urdhëri për t'u nisur në veri, batalioni ndodhej në Vërzhezhë të Skraparit. Me të marrë urdhërin, batalioni ynë u nis e kaloi Qafën e Kulmakut që kishte pothuaj një metër dëborë, kaloi Ujanikun, Romasin, Dobrenjën e doli në Moglicë të Korçës. Aty ne u takuam me dy batalionet e tjera. Aty shoku Mehmet na tha se Brigadës I i duhej të kalonte rrugë të gjatë, të vështirë, për-

mes zonave të armikut, se atë do ta prisnin përleshje të vazhdueshme me armikun. Të gjithë ne çfaqëm gadishmërinë të shkonim në këtë rrugë të vështirë, pa marrë asgjë parasysh. U nisëm. Asokohe anët që përshkuam sot, nga Moglica e gjer këtu në Velçan, ishin të mbuluara me dëborë. Veshje nuk kishim si këto që kemi sot. Të ftohtit ishte më i madh. Unë isha zëvendës komandant kompanie e mbaja mitroloz.

«Në Dunicë na qëlluan ballistët. Çeta e Mokrës asokohe s'ishte aty, ndodhej në Llëngë. Batalionit tonë iu dha urdhëri të sulmojë ballistët që na hapën zjarr. I spastruam...

«Në Trebinjë na dolën përpara përsëri ballistët. Po ata, me të dëgjuar emrin e Brigadës I, ja dhanë vrapit për në Pogradec. Nga Dunica e Trebinja dolëm në Çezëm të Mokrës, ku u bë mbledhja e tri batalioneve. Mbasdite u nisëm për të kaluar rrugën Elbasan-Korçë. Në 4 të mëngjesit hymë në Skroskë. Ecëm gjatë një perroi të thellë e aty s'dëgjohej asnjë zhurmë. Po, me t'u ngjitur në faqen e kodrës, ballistët, që ishin mbledhur pa u vënë re nga ne, hapën zjarr papritur. Ne iu ngjitëm kodrës e dolëm në majën e Dragoshtunit. Përpara na doli një kollonë gjermane. Gjendja ishte e vështirë dhe jashtëzakonisht serioze. Aty shoku Mehmet na tha që rruga më e shkurtër dhe më e lehtë ishte të ktheheshim pas, andej nga kishim ardhur, por rruga e lavdishme që i shkonte për shtat brigadës së parë ishte që të shkonte përpara dhe vetëm përpara. Të gjithë partizanët në atë gjendje aq të rrezikshme, thirrën njëzëri: «Të shkojmë përpara!». Për herë të parë në jetën time pa-

shë shokun Mehmet, që i mallëngjyer nga kjo gadhëmëri e pashoqe e partizanëve të Brigadës së parë, t'i binin lot...»

24 shkurt 1966

Buletini meteorologjik njoftonte mbrëmë se sot do të ketë shi në vende-vende. A do të bjerë në rrugën tonë? Ecim gjatë bregut të një përroi të rrëmbyeshëm për të dalë në Podgozhan të Mokrës. Ka baltë. Zuri dhe shiu. Shi i vazhdueshëm, i imtë dhe i ftohtë. Nxjerrim nga çantat pelerinat dhe i hedhim krahëve, në kokë vëmë kapuçet.

Ne tani s'e ndjejmë aq rrugën. Na pengon më shumë balta, këmbët rrëshqasin. Gjunjët na lagen.

... Na kanë caktuar gjashtë veta të flemë në shtëpinë e Naun Hilës. Dhe plaku, xha Nuni, si i thonë, një burrë thatim, veshur me shajak të zi, ka dalë dhe na pret me dashuri dhe me buzëqeshje. Ai bën shaka:

— Kujdes, djema! Matanë kemi ballistët.

Bën fjalë plaku për ato ditë të luftës kur vinin e strehoheshin partizanët. Në Podgozhan vinin partizanë, kurse në fshatin fqinjë ishin ballistët. Ose anasjelltas. Ne e kuptojmë shakanë e plakut. Qeshim.

Pastaj me të bashkë shkojmë në shtëpinë e tij. Heqim këpucët me baltë, pecet e lagura dhe i lemë jashtë derës. E shoqja e xha Naunit, Nastasia, një grua e mirë dhe e urtë, na thotë dhjetra fjalë të embla, fjalë si të nënave tona. Ajo merr pecet e lagura e të ndotura e shkon të na i lajë, të na i thajë, që t'i kemi gati për nesër.

...Malet e Gorë-Oparit mbaruan, tani fillojnë malet e Mokrës. E përpjeta, një gjysëm ore e ca, në qafat e Gurit të Kamjes është thikë dhe shumë e lodhëshme. Pastaj dalim në zonat e dëborës. Shtrati i saj është 1/2 m. i lartë. Kollona çan një vazhdë të ngushtë bojë kafe.

Ecim drejt Çezëm të Mokrës, ku duhet të arrijmë në mbrëmje. Këtu në Çezëm të Mokrës shoku Mehmet Shehu u komunikoi për herë të parë detyrën luftarake partizanëve të tri batalioneve që ishin rreshtuar në një shesh të mbuluar me borë. Komandanti i Brigadës u foli kështu partizanëve: «Shtabi i Përgjithshëm na ka ngarkuar me një mision me shumë rëndësi. Kjo barrë i ngarkohet Brigadës së parë. Misioni ynë është me aq rëndësi sa që mjafton të kryhet edhe sikur dy batalione të asgjësohen për ta mbrëtur objektivin. Përpara nesh ndodhen pengesa gadi të pakapërxyeshme: porse ne duhet t'i kapërcejmë, po të duam dhe besoj se të gjithë duam që t'i kapërcejmë dhe do t'i kapërcejmë; do të udhëtojmë shumë larg, do të kapërcejmë lumenj, male me borë, do të udhëtojmë me ditë dhe netë të tëra, pa bukë, pa giumë, zbathur e zhveshur; kështu siç jemi do ndodhemi në zona të sunduara nga forcat e Ballit, të rrethuar nga ballistë dhe gjermanë. Kjo është gjëndja përpara nesh. Tashti, secili nga ju të mendohet mirë, para se të flasë dhe të gjithë ata, që nuk e shohin veten në gjëndje të marrin pjesë në këtë marshim heroik, të dalin mënjanë e të mbeten këtu në Mokër.»

Një nga të pranishmit në këtë mbledhje na tha: «Mënyra me të cilën shoku Mehmet na komunikoi detyrën luftarake na elektrizoi të gjithëve. E pa pritur e pa kujtuar rreshtimi i partizanëve u kthye në një miting të fuqishëm. Brohoritjet e luftëtarëve tregonin gadishmërinë e tyre, tregonin vendosmërinë dhe vetmohimin për të kaluar çdo pengesë».

... Arrijmë në Çezëm. Në sheshin e shkollës tetëvjeçare është mbledhur e gjithë brigada. Panorama sot është mjaft e larme. Dikush lahet në çezmë, dikush lan pecet e këmbëve, këmishën, peshqirin, njëri rruhet para një cope të vogël pasqyre, diku një grup këndon, para shkallëve të shkollës jep çfaqje grupi i estradës së Pogradecit...

Gjymtyrët bien në qetësi, grumbullohen forca të reja...

... Sa për mjekun e brigadës edhe sot është ditë pune. Ai viziton... jo më marshuesit, ata të gjithë e ndiejnë veten mirë, po ndonjë fshatar a fshatarkë. Mjeku kudo që shkon, në çdo shtëpi ku e zë nata për të bujtur, jep ndihmën e tij.

Drejt rrugëve më të vështira

26 Shkurt 1966

Shumë nga ne kanë nga një hartë të vogël në xhep ku shënohet rruga, që ka bërë Brigada I Sulmuese në dimrin e 1944-ës. Sot fillon etapa e dytë e marshimit tonë të madh, etapë disa herë më e vështirë se sa ajo që kemi bërë gjer më sot. Kjo quhet etapa e dytë e marshimit, pasi Brigadës I sapo doli nga Çezma e Mokrës, e, gjersa arriti në objektivin e saj, iu desh ta çajë çdo metër të in-

kursionit të saj me luftë, iu desh të hyjë në prapavijat e thella të armikut, ku e pritën me pushkë herë ballë për ballë, herë anash, herë prapa, pabesisht, e herë nga frëngjitë e shtëpive balliste. Në këtë etapë partizanëve iu desh të udhëtojnë me ditë e me net pa pushuar në asnjë bazë, iu desh të çanin dëborën një metër e gjysëm të trashë, të zbathur, të xhveshur, të uritur e pa gjumë. Në rrëpirat e maleve i grinte tufani dhe cikma e dëborës. Këmbët e zbathura, të ënjtura, linin pas një vazhdë të gjatë, të qëndisur me njolla të kuqe e të vakta. Dhe kollona, duke shtërnguar radhët, nuk u përkul përpara asnjë force të armikut e të natyrës, por çau përpara si një ortek i fuqishëm që çan nëpër shtigjet e maleve...

...Dhe sot ne do të nisim pikërisht këtë etapë. Përpara nuk kemi armik si në dyzet e katrën, as dimër të fortë e uri, po, megjithatë, rruga është e vështirë, shumë e vështirë. Do të na duhet të ecim edhe neve natën, të flemë diku jashtë natën; herë në shtratin e murmë të tokës, herë në shtratin e bardhë të dëborës.

...Nisemi. Mokrën sot do ta lëmë pas. Përpara kemi Sllabinjën, Qukësin, Pishkashin, Skroskën, Hotolishtin... Numuri i fshatrave që mund të përmenden është i gjatë, në horizont duken male me profile të thyera, të ashpra, bojë hiri. Ora shënon katër mbasdite. Gjer në Pishkash janë dyzet e ca kilometra. Kuptohet, nata do të na zërë diku afër, pastaj pjesën që mbetet do ta bëjmë natën.

Zbresim nga malet e Mokrës rresht njëri mbas tjetrit, zbresim nga fshatrat aq mikpritës që na hapën portën po me atë dashuri e bujari siç prisnin dikur partizanët. Mokrarë, mirëmbeçi!

Dielli ulet dalngadalë e nëpër lugina bie muzgu i kaltër. Nata afron e në kollonën partizane, që udhëton drejt veriut, ka gjallëri të madhe. Këngët nga kompania në kompani s'kanë të mbaruar. Nata na zuri në Sllabinjë. Nga larg ne pamë një grumbull njerëzish që kishin dalë për të na pritur me fenerë. Ne dallojmë fytyrat e tyre, buzëqesurjet e tyre. Kalojmë pranë grumbullit njëri mbas tjetrit e përshëndetemi me radhë. Na bën shumë përshtypje kjo pritje natën.

Pastaj shkojmë më tej. Nata është e oetë, ne nuk ua dimë emrin fshatrave që përshkojmë, një-rëzit që mund të pyesim, tashti flenë se ora po shkon niëmbëdhjetë.

Herë dalim në ndonjë grykë, herë dëgjojmë majtas e djathtas gurgullima ujrash, herë-herë era trazon në pyje gjethet e drurëve e, që andej, vjen një shushurimë e mbytur dhe e shurdhët. Natë! Po kollona ecën. Këmbët na janë lodhur shumë, thirrjet për të mos e këputur kollonën dëgjoohen më shpesh, gjumi na rëndon mbi qepalla... Ecim!

...Ora 2 e mëngjezit... Mbas mesnate fryn një fllad që mban erë dëbore. Na vjen të ulemi diku, të mbështillemi me peliçe e të marrim ndonjë sy gjumë pranë ndonjë mezhde ku ka zënë të rritet bari i ri. Për shumë nga ne kjo është ndër netët e pakta që i gdhimë pa gjumë. Në netët që do vijmë, ne do të mësohemi ta gdhijmë natën pa e ndjerë fare... Ecim!

Para nesh duket një si qytet malor. Shtëpitë e këtij qyteti i kanë të gjitha dritat ndezur, andej vijmë plot reflekse të kuqe e të ndritëshme... Jo, jo! Nuk është qytet malor, është një kodër përballë

nesh në të cilën, batalioni i parë, me të arritur, ka ndezur zjarret. Është vend pushimi. Kemi arritur në Pishkash, nja dy-tre kilometër më të djathtë të Qukësit. Nga kreu i kollonës dëgjohet boria, partizanët prishin rreshtin, ngjiten në kodër e nisin të ndezin zjarre të tjera. Për pak do të gdhijë. Ndjehemi të lodhur. Pranë zjarreve mbuluar me pelerinë të zë një gjumë i ëmbël.

27 shkurt 1966

Në orën katër, kur ende zjarret s'ishin ndezur mirë, e kur ende s'i kish marrë të gjithë gjumi, u dëgjua sërishmi boria e zgjimit.

— Ej, çohuni! Shuani zjarret!

— Ëm? — përgjigjet dikush përgjumësh.

— Çohuni, shokë!

— Ta marr zjarrin me vete? — pyet dikush andej me shaka.

— Jo, zjarrin mos e merr — përgjigjet tjetri përgjumësh. Mbas një gjysëm ore jemi prapë në kollonë, prapë në rrugë duke udhëtuar.

Arrijmë tek lapidari i Pishkashit, ku plot 22 vjet më parë, aty nga ora tre mbas mesnate, kaloi Brigada I Sulmuese rrugën Elbasan-Korçë. Ajo u hodh në malet e Librazhdit në drejtim të Skroskës, Hotolishtit...

Ora shënon 5,45'. Brigada është mbledhur e gjithë në sheshin e vogël të lapidarit. Në kthesë duken makina. Një gëzim i papritur. Shoku Mehmet Shehu erdhi të takohet me ne. Zbret nga makina e hyn në mes të grumbullit të partizanëve dhe të popullit, që e presin me brohoritje. Janë çaste mallëngjimi. Përpara ne kemi ish komandantin e Bri-

gadës, komandantin trim që udhëhoqi me guxim e mençuri kollonën partizane mes shtigjeve të maleve, mes zonave armike.

Shoku Mehmet i afrohet një partizani, i merr pushkën dhe e vështron në është mbajtur pastër apo jo. Pastaj i thotë një partizaneje:

— Di ta heqësh shulin?

Ajo kap me gishtrinj sigurecën, mundohet ta heqë, por është e mallëngjyer... Shoku Mehmet buzëqesh me dashamirësi, e merr vetë pushkën në dorë dhe heq sigurecën. E ndjejmë vehten të gjithë si në një vatër të ngrohtë familiare...

Shoku Mehmet na foli për rëndësinë e madhe të kalitjes fizike.

Ai na pyeti se si e kaluam rrugën gjer aty e na tha se pjesa që na mbetet është të paktën nja pesë herë më e vështirë.

— A do të shkoni të gjithë përpara? — pyeti ai.

— Po, do të shkojmë përpara — u përgjigjën gjithë njëzëri.

— Jua bëra këtë pyetje, — tha shoku Mehmet, sepse kështu i kam pyetur dhe partizanët njëzet e dy vjet më parë...

Dhe ai tregon për vështirësitë e mëdha që kaluan atij dimri, tregon për Skroskën e Qarishtën, tregon për guximin dhe vetmohimin e partizanëve, që s'u kthyen kurrë nga rruga.

Pastaj, shoku Mehmet, i mallëngjyer që ndodhet midis nesh na uron rrugë të mbarë.

... Nisemi në drejtim të Skroskës. Skroska nuk mban shumë, aty do të arrijmë rreth orës njëmbëdhjetë. Ne nuk qëndrojmë në Skroskë. Zbresim një të tatëpjetë që bie në një përrua të thellë.

Kreu i kollonës ka nisur t'i ngjitet shpatit të djabatit të përroit. Rruga është shumë e vështirë. Heshtja papritur thyhet: Nga shpati i majtë nisi të shtien mitrolozët dhe pushkët. Imitohet zjarri i ballistëve që shtinë kundër Brigadës I sapo ajo kaloi përroin e nisi t'i ngjitet shpatit të djabatit. Krismat janë të dendura. Kollona çau përpara. Asokohe Brigada e parë u ndodh në një rrezik serioz në këtë vënd. Gjëndja ishte shumë kritike. Brigada goditej nga tri anët prej armikut dhe nga njera anë, në të djabatit, i qëndronin përsipër shkëmbinjt e pakalueshëm të malit të Shebenikut, të mbuluara me borë. Sulmet e armikut që u përsëritën disa herë, u shpartalluan nga partizanët, të cilët i mbrojtën me vendosmëri pozicionet e tyre. Por armiku, po e shtrëngonte gjithënjë e më tepër darën e rrethimit. Në këto kushte të rënda Komandanti i Brigadës mbledhi komandantët e batalioneve dhe të kompanive e u foli për gjëndjen e vështirë. Komandanti i Brigadës vendosi që të bëhej një mbledhje me të gjithë partizanët dhe pjesërisht t'u tregonte edhe qëllimin e misionit. Komandanti si u tregoi malet e larta të Orenjit që zbardhnin nga bora, u tha partizanëve se duhej të arrinin atje për të përmbushur një mision shumë të rëndësishëm. Pastaj ai foli me një zë të tillë që partizanët nuk do ta harrojnë tërë jetën: «Jemi të rrethuar. Tash do të shifet në se e meritojmë të quhemi partizanë të Brigadës së parë, në do ta mbajmë betimin tonë. Të mos harrojmë misionin që na është ngarkuar. E përsëris për të fundit herë se misioni është me shumë rëndësi. Jemi të rrethuar, porse çdo problem e ka një zgjidhje. Lenini i madh ka thënë

se s'ka problem pa zgjidhje. Partia na mëson se s'ka rrethim pa një të dalë për trimat. Rrethimin do ta çajmë, vetëm kërkohet nga çdo përgjegjës ushtarak e politik, nga çdo partizan e partizane, vendosmëria më e madhe, shpejtësia në lëvizje, durim në vuajtje, duhet mbi të gjitha vetmohim. Ju pyes për të fundit herë në doni të kthehemi prapsh apo të vazhdojmë rrugën për të arritur objektivin.» Zëri i partizanëve buçiti i fortë në përgjigje të kësaj thirrjeje për të ecur përpara, për të mos ndalur përpara asnjë pengese. Pasi u la një praparojë e fortë, partizanët e tjerë, duke çfrytëzuar rënien e dëborës, pa u diktuar fare nga armiku dolën nga rrethimi. Kështu pas 7 orë luftimesh rrethimi i Skroskës u çka dhe brigada vazhdoi t'i ngjitej Shebenikut me këmbë e me duar...

.... Inkursionistët përsëri pas njëzetedy vjetësh kapërcejnë përroin e Skroskës dhe i drejtohen Hotalishtit, ku do të flejnë sonte.

28 shkurt 1966

Mbas një nate pa gjumë, mbrëmë fjetëm mirë. Sot nisemi për në stanet e Dragoshtunit, po në atë ditë, si Brigada e Parë njëzet e dy vjet më parë. Koha vazhdon të na ndihmojë. Në rrugën tonë s'ka dëborë, me përjashtim të ndonjë vëndi të vogël, kurse asokohe binte herë dëborë, e herë shi, nga e majta e kollonës partizane lëviznin gjermanë e ballistë që mundoheshin t'i prisnin rrugën, dëborë ish pothuaj një metër e trashë, partizanët ishin të

pangrënë që nga Çezma e Mokrës, të xhveshur e pa gjumë. Në këto kushte ishte e pamundur transportimi i armëve të rënda si i mortajave 82 mm., ashtu dhe i kafshëve. Mortajat i shkatërruan kurse kafshët i pushkatuan. Mëgjithatë dy partizanë të vjetër nuk pranuan që t'i shkatërronin mitrolozët e tyre të rëndë. Ata u lejuan t'i merrnin me vete. Po rruga që e vështirë, shumë e vështirë. Ja ç'thuhet në një dokument: «Forcat tona e kaluan natën e tmerrëshme të 27-28 shkurtit përjashta mbi dëborë, pa ushqim, pa strehë». Ndërsa një pjesmarrës i këtij inkursioni na tregoi: «S'do ta harroj kurrë atë natë, kur humbën gjashtë shokë, të cilët e ndjenin veten aq të pafuqishëm sa mbetën në rrugë.»

Në stanet e Dragoshtunit arrijmë në orën katër mbrastite. Stanet, ca ndërtesa të vjetra me gurë, mbuluar me dërrasa, janë të vendosura në një shesh, në një lartësi 1300 m. Këtu kanë dalë shumë banorë të fshatrave përreth e na presin me daulle.

Inkursionistët e rinj mblidhen në sheshin e gjerë mbuluar me bar dhe aty ia nisnin këngës dhe valles. Pastaj, megjithëse, vonë, hahet dreka.

Po erret. Batalioni i parë u nis për në Qafën e Shapkës ku do të kalojë natën jashtë, kurse batalioni i dytë do të flejë këtu, jashtë. Tani ne po mësohemi të flemë pranë zjarrit në natyrë të hapët.

Nga stanet e Dragoshtunit në Tiranë

1 mars 1966

Siç shihet edhe nga ditari ne i qëndrojmë besnikë itinerarit të Brigadës së Parë. Ecim në atë ditë dhe afërsisht në atë orë. Por datat pas 28 shkurtit nuk përputhen më disa herë sepse njëzetedy vjet më parë ky muaj pati 29 ditë. Kështu ndërsa Brigada e parë u nis nga Dragoshtuni për në drejtim të Qarishtes në orën dymbëdhjetë të natës të datës 29 shkurt, ne na takon të nisemi më 1 Mars. Por ç'e shtyti Brigadën të merrte udhën në këtë orë, duke qenë krejtësisht e rraskapitur, e pangrënë dhe pa gjumë? Vonesa në këto stane ish vdekjeprurëse pasi armiku përsëri po e rrethonte me forca të shumta. I duhej shmangur me çdo kusht këtij rrethimi. Prandaj brigada u vu përsëri në një nga marshimet më heroike të saj. Në Vlashë të Dragoshtunit, na thonë, mbeti në rrugë dhe një partizan tjetër i ngrirë. Duhej të kalohej sa më shpejt Shapka për t'iu shmangur rrethimit, që i kish pregatitur armiku. Në këto rrethana vetëm shpejtësia mund ta shpëtonte brigadën nga kurthi ku kish menduar ta fuste armiku. «Kështu në mëngjez, kur gjermanët dhe ballistët, ka shkruar shoku Mehmet, ishin në kasollet e Dragoshtunit, kollona jonë ndodhej katër orë larg në Shapkën e Librazhdit dhe kur armiku doli në Shapkë, ne ishim tri orë larg kësaj pike, në Qarrishte».

...Pra edhe ne do të kalojmë sot pikërisht në këtë rrugë të gjatë, ku çdo pëllëmbë vend, çdo gur

dhe shkëmb na sjell ndër mënd lavdinë partizane. Këtu nga stanet e Dragoshtunit do të nisemi në orën katër të mëngjezit e në Qarrishtë parashikohet të arrijmë në orën dymbëdhjetë. Do të pushojmë pak atje e pastaj do të nisemi për në Zabzun, në një fshat në malet e Dibrës, që mban 6-7 orë nga Qarrishta.

Borija e zgjimit në stanet e Dragoshtunit ra në orën tre të mëngjezit. Nisi përgatitja për rrugë. Marshonjësit lanë zjarret që skuqnin në mugëtirën dhe u vunë në rresht. Megjithse fjetëm jashtë, prapsepapë e ndjejmë vehten të freskët e të ngopur me gjumë.

Nisemi. Dielli ende nuk ka dalë e toka është e butë dhe e lagësht. Rruga shkon përmes pyjesh me dru ahu që rrallë shkelen nga këmba e njeriut. Zbresim. Duket që Qarrishta ndodhet diku në ndonjë rrëzë mali, prandaj rruga sa vjen e ulet vazhdimisht. Për marshonjësin kjo është e mërzitshme. Por ç'të bësh? Kështu është relievi i vendit tonë: i thyer dhe i ashpër me të përpjeta dhe tatëpjeta. Bile tashti kemi nisur të mos i vëmë re shumë këto. Këmbët na janë forcuar, pulsi na rreh normalisht e frymëmarrja sa vjen e bëhet më e rregullt. Na janë pastruar mushkëritë nga ajri i pastër i maleve...

Në orën 12 u duk Qarrishta. Vendi këtu është shumë i thyer. Nga e majta shkëmbi është i prerë thikë. Rruga që të çon përpara është e vështirë për t'u kaluar, duhet të mbahesh me duar që të kalosh përmes shkëmbinjve. Më tutje vendi është i thellë si greminë. Të shikosh majtas të merren mëndtë dhe po të të shkasë pak këmba mbi dëborën e ngrirë fluturon poshtë në humnerë. Ja, pikërisht

në këtë vend, njëzetedy vjet më parë, armiku i kish zënë pusi brigadës së parë sulmuese, duke e rrethuar nga të gjitha anët. «Që nga Qarrishta na mbetet vetëm një shteg për të kaluar: ai i malit të Letmit. Të gjitha rrugët e tjera janë të pakapërcyeshme nga bora. Për të dalë në majë të Letmit 1500 m. lartësi, na duhet që të kalojmë nëpër një lagje të katundit t'Azis Biçakut e pastaj nëpër një rrugë dhish drejt malit përpjetë, nëpër disa shkallë, që edhe dhitë mezi i kalojnë...» Kështu e përshkruan shoku Mehmet Shehu giëndjen e vështirë në të cilën u ndodh brigada në Qarrishtë... «Në shkallën e Lispriskës të Letmit, na tregoinë, partizanët sulmuan përpara dhe, në Qarrishtë preparoja e rrethuar luftoi kundër qindra ballistëve e gjermanëve duke kryer detyrën e saj luftarake me një heroizëm të rrallë... Nga të gjitha anët vazhdon lufta... «Brigada është në rrezik të madh — ka shkruar shoku Mehmet Shehu. — Zëri i komandantëve dhe i komisarëve përzihet me alarmin e bories për sulm. Janë çaste rrënqethëse e vendimtare». Në këto çaste dramatike, partizanët e dobësuar nga lodhja dhe pagjumësia, pas katër ditësh pothuaj pangrënë, gjetën në vetvete fuqi fizike dhe morale të tilla, saqë e thyen armikun, duke zënë pozicionet e tij dhe duke e ndjekur atë... Në luftën për daljen nga rrethimi i Qarrishtës, Brigada humbi krejt preparojën, të përbërë prej njëzet partizanëve të batalionit të parë...

Hëngrëm drekë në livadhet e blerta, e pastaj kolona u nis drejt malit të Letmit. Në të dalë të fshatit duket një lapidar i bardhë. Aty marshonjësit vunë kurora e shtinë me batare pushkësh. Lapidari

është ngritur në kujtim të dëshmorëve të brigadës së parë Sulmuese. Ne kaluam në heshtje pranë lapidarit e na ngjante sikur njetjetohehim me shokët që flenë aty përjetësisht. Ne ecim në rrugën e tyre, ne vazhdojmë rrugën që ata s'mundën ta bënin, sepse ua shoi jetën dora tradhëtare...

Arrijmë tek Shkalla e Gështenjës, në qafën e malit të Letmit. Gjer më sot kam bredhur shumë male, në veri e në jugë, kam parë të përpjeta të frikëshme e gremina të errta që hapen si puse në gji të maleve, po rrugë si në Shkallën e Gështenjës s'kam hasur gjëkund. Në momentin e parë, kur shikon Shkallën që ngrihet pothuajse vertikalisht në faqen e shkëmbit plot thepa, të duket e pamundur dhe e pabesueshme që aty të kalojë një kolonë e tërë. Po ja, nis e ngjitet i pari. Ai mbahet me të dyja duart e vë këmbët duke shkelur me kujdes. Mbas tij nis e ngjitet i dyti e mbas ca kohe Shkalla mbushet me njerëz që lëvrijnë si një vargan mizash në një trung të madh. Dhe e përpjeta është afro një kilometër e gjatë.

Ngjitemi në majën e Letmit. Këtu ka një metër dëborë. Po rruga tashti s'është e keqe e ne ecim drejt Zabzunit, aty ku njizet e dy vjet më parë jentonte në ilegalitet shkrimtari Haki Stërmilli. Ai ka shkruar kështu për partizanët e Brigadës së parë: «Disa s'kanë as opinga në kambë, por kanë zemra ndër krahnorë. U kullon gjak prej kambëve, janë t'unshëm e të lodhun, pse nuk kanë hangër, nuk kanë flejtë dhe s'kanë pushue, veç kanë udhëtue e kanë luftue. Me gjith këte janë të fortë e të naltë moralisht. Janë titanë».

2 mars 1966

Rruga që do të bëjmë sot, s'është dhe aq e gjatë. Na thanë se nga Zabzuni gjer në Okshtun s'mban më shumë se 4 orë. Në ngjitemi në ca koda me drurë të çveshur. Jemi të gëzuar. Këngët dhe shakatë s'kanë të sosur. Mbasdite mbrijmë në Okshtun. Po Okshtuni është një fshat me tri-katër lagje që mbajnë nga një orë e gjysëm larg nga njëra tjetra. Kështu që një pjesë e brigadës mbetet në lagjen e parë, kurse ne të tjerët udhëtojmë për më tutje. Mbi ne ngrihen malet e larta të Martaneshit mbuluar me dëborë. Nesër ne do të kapërcejmë Kaptinën e Martaneshit. Për të ne kemi ditë që flasim, flasim për vështirësitë që na presin aty. Dhe ja më në fund jemi në rrëzën e saj.

3 mars 1966

Sot për herë të parë shumica e marshonjësve veshën dorezat e leshit, kokoret i rrasën fort në kokë e i lidhën nën gushë, rripat e mesit i shtërnguan sipër peliçeve. Të gjithë jemi të përgatitur shpirtërisht për të kaluar një pjesë shumë të vështirë të rrugës sonë. Pecet e këmbëve i rregulluam më mirë se në ditët e tjera, kambalet i uthitëm mirë mbas këpucëve që të mos na hyjë dëborë.


Pëllëmbë e gjak është kjo historia e Brigadës së Parë Sulmuese. Sa doli nga rrethimi i Qarrishtës, armiku po i përgatiste një kurth të ri në Okshtun. I duhej shmangur dhe këtij rrethimi. Po si? Duke kaluar në atë vënd, ku për armikun është e pamun-

dur. Atij s'i shkonte kurrë nëpër mënd se Brigada e Parë do të merrte guximin t'i ngjitesh Kaptinës së Martaneshit. Bile edhe fshatarët e këtyre anëve tregojnë se gjer atëhere ata kurrë nuk kishin parë që të kalohej nga ndonjë njeri Kaptina e Martaneshit me kaqë borë. Por ndodh që çdo rregull të ketë ndonjë përjashtim. Kaptina e rënduar nga bora u kalua dhe partizanët duallën përsëri triumfonjës mbi natyrën. Manovrimi i Brigadës së Parë në drejtim të Martaneshit bëri që të dështojë dhe kësaj radhe plani i armikut. Duke ngjitur Kaptinën u shkëputën nga kollona edhe dy partizanë që u kishin ngrirë këmbët...

Grumbullimi i brigadës u bë në Kodrën e Butë. Dita është e vrejtur dhe e ftohtë. Fryn një erë që bie cikmë dëbore. Kaptina e Martaneshit ngrihet mbi ne e zhytur në miegull. Nis ngjitja drejt saj. Kollona e gjatë gjer në dy kilometër ecën ngadalë, në faqen e një gryke. Shtrati i dëborës sa vjen e bëhet më i trashë. Ata që ecin në fillim e kanë zor. Dëbora vende-vende të lëshon, këmbët futen gjer në gju. Në krye ecën batalioni i dytë i përbërë nga të rinj e të reja të qyteteve të ndryshme. Ky është një nder që i bëhet atij, është nder se i besohet të çajë i pari këtë rrugë të vështirë.

Sa më lart ngjitemi, aq më shumë të than era e aq më e fortë bëhet ajo.

Mbas një ore kemi dalë në fushën e Zidolit. Këtu shtrati i dëborës është gati dy metra, një shtrat i bardhë e i pashkelur nga këmbë njeriu. Kjo fushë e gjatë dhe e rrethuar nga dy anët me breza të dëndur ahesh ngjan si një rrugë automobilistike e mrekullueshme. Ajri është i ftohtë dhe pa grimë



lagështie. Kollona ecën përmes kësaj shkretëtire të bardhë dhe e mbush me jetë e gjallëri këtë kënd të heshtur. Tani rrjeshti mbahet shumë mirë, sepse të gjithë ecin në gjurmët e njëri-tjetrit. Kur futemi në pyje, tingulli i zërit tonë bëhet më i qartë e kumbon gjer tej. Kalojmë fushën e Zidolit e ngji-

temi drejt një maje tjetër. Është pika më e lartë e Kaptinës së Martaneshit. Dëbora vende-vende arrin gjer në tre metra. Mjegulla bëhet e dendur e s'mund të shohësh më tepër se dhjetë metra përpara. Herë-herë bien kristale të rralla dëbore. Kufiri i qiellit nuk duket gjëkund, ai shkrihet e bëhet një në atë mjegullirë ngjyrë qumështi.

Papritur ne dallojmë përpara një rresht me njerëz. Ky resht mezi shquhet përmes mjegullës. Ata brohorasin e shtjenë në ajër me automatikë e pushkë. Janë të rinj e të reja të rrethit të Matit që kanë dalë të na presin në këtë pikë të lartë mbuluar me dëborë. Vendi quhet Fusha e Kishës. Ne hymë në mesin e tyre e përshëndetemi me radhë. Takimi është shumë i përzemërt në këtë majë afër 2000 metra mbi nivelin e detit.

Që këtu rruga nis të bjerë në luginë. Nga Fusha e Kishës zbresim në fushën e Pelave, pastaj bëjmë më poshtë drejt fshatit Lenë.

Edhe në këto vënde iu desh të luftojë Brigadës, të derdhë gjak dhe të çajë një nga rrethimet e fundit që të arrinte në Shëngjergj ku e kish objektivin. Një nga veteranët e këtij marshimi na e shpjegoi kështu natën e 2-3 marsit: «Brigada u gjend e rrethuar plotësisht pasi armiku me forca të mëdha, i zuri të gjitha vendkalimet e mundëshme. Gjendja ishte me të vërtetë kritike. Duhej vepruar përsëri në mënyrë të rrufeshme për të mos i dhënë kohë armikut që të na priste rrugën. I vetmi shteg për të dalë nga ky rrethim ish shka-lla e Valës. E kjo duhej kaluar me çdo kusht natën, një natë e errët si pus. Sulmi i shpejtë i partizanëve, duke shfrytëzuar errësirën bëri që armiku të

tërhiqej, duke lënë shumë të vrarë. Nga Brigada jonë u vra komunisti trim Kamber Sadiku. Kështu Brigada e Parë Sulmuese hyri në Martanesh nga sipër, nga mali i Kaptinës»... .

Në fshatin Peshk arrijmë mbasdite vonë. Kap-tina e Martaneshit u kalua. Rruga që mbetet për në Tiranë s'ka më vështirësi të tilla.

Ne shkuam për të fjetur në shtëpinë e Zenel Gjonit.

Në këtë shtëpi e në këtë dhomë, ku jemi ne sonte, njëzet e dy vjet më parë ka vdekur dëshmori Kamber Sadiku, i plagosur rëndë nga ballistët, gjatë kohës që brigada kaloi në këtë fshat.

E ëma e Zenelit, Zyhra Gjoni na tregon:

«Ja, tek kjo qoshja këtu ka qënë shtrirë. He, çfarë djali ishte. Ma prunë dy partizanë e më thanë: Është një vëlla yni dhe juaji. Po të ngjallet ai do t'i gjejë vetë shokët, po vdiq, ju lutem e varrosni siç i ka hie. Ata ikën, po Kamberi s'e pat të gjatë. Plum-bi e kish mbërthyer keq në shpatull e vdiq mbas dy orësh. Një herë nuk ja bëri of, po rrinte e shtër-ngonte dhëmbët, duke e mbajtur brënda gjithë dhëmbjen. E përgjova tek koka sikur ta kisha dja-lin tim, gjersa mbylli sytë...»

Nënë Zyhraja tregon këto dhe sytë i njömen. Ajo është një grua e mirë dhe e dhëmbshur.

4 mars 1966

Jemi nisur nga Peshku i rrethit të Burrelit për në Gurabardhë. Sapo dalim nga fshati, ngjitemi në një shkallë malore plot dredha: në shkallën e Valit.

Kjo ka 79 kthesa që bëjnë zikzake në shpatin e malit. Dhe këtu armiqtë hapën zjarr mbi Brigadën I Sulmuese. Sot ne imitojmë përpjekjen e atëherëshme: marshonjësit shtien me pushkë, automatikë e mitroloza. Gryka zjen nga krismat e armëve, ca krisma të dëndura e shurdhuese. Po veshët na u mësuan me krisma armësh gjatë marshimit tonë dhe ne ato i dëgjojmë fare të qetë. Ndonjë vajzë që në fillim mbyllte veshët, tashti shtie vetë me dorë të sigurt. Dhe jehona e armëve tona përhapet gjer tej lugjeve të thella.

Kalojmë shkallën e dalim në fshatin Val. Një vajzë katërmbëdhjetëvjeçare del para kollonës. Atë e quajnë Saide. Saideja është një malsore e qeshur dhe gëzohet shumë kur takohet me shoqet partizane. Ajo merr tri katër nga ato dhe u lutet që të kthehen në shtëpinë e saj, për të ngrënë drekë. Partizanet nuk ja prishin qejfin vajzës. Shkojnë me të. Po para nesh dalin dhe shumë fshatarë të tjerë që s'na lënë pa kthyer në shtëpitë e tyre për të ngrënë drekë. Na presin me përzemërsi të madhe. Plakat dalin tek portat e na mbushin paguret me ujë, djemtë e vegjël vërtiten rreth nesh e na shikojnë me kureshtje...

Vazhdojmë rrugën për në Gurabardh, fshati i shkrimtarit tonë të vjetër Pjetër Budi. Atje arrijmë në mbrëmje. Populli kish dalë i gjithë të na priste. Ja këtu për herë të parë komandanti i Brigadës, pa marë parasysh se ndodhej shumë thellë në prapavijën e armikut, vendosi që forcat e brigadës të bënin një pushim prej dymbëdhjetë orësh, me qëllim që të çlodheshin dhe të hanin. Ky qëndrim i shkurtër i përtëriu partizanët. Inkursionit, po i afrohej fundi....

5 mars 1966

Sot hymë në rrethin e Tiranës. Mbas 18 ditë rrugë nëpër Shqipëri ne po i afrohemi prapë kryeqytetit.

Marshimi ynë po i afrohet fundit, ashtu si Brigadës së parë njëze' e dy vjet më parë. Po më këtë datë Brigada doli në atë kohë në zonën e lirë të Shëngjergjit. Këtu për herë të parë pas këtij inkursionit të gjatë brigada mori frymë lirisht. «Kollona gjarpëronte mbi luadhet e Selitës, e aty nga ora një pas dreke arrin në Shën Mëri e Shëngjergj. Ndër partizanët ndihet një gëzim i madh... Populli na pret me gëzim të madh... Për një çast atmosfera mbytëse e tradhëtarëve ishte shpërndarë. Kudo duket një atmosferë e lirë...» ka shkruar më vonë shoku Mehmet Shehu për këto çaste.

Kështu Brigada e parë pas pesëmbëdhjetë ditësh marshimi me luftë, në kushte klimaterike shumë të vështira dhe e ndjekur këmbakëmbës nga gjermanët e ballistët, urdhërin e Shtabit të përgjithshëm për të arritur në Shëngjergj e zbatoi me nder. Një gëzim i jashtzakonshëm i pushtoi të gjithë partizanët kur mësuan se shoku Enver Hoxha bashkë me shokët e tij ndodhej në këtë kohë jasht çdo rreziku, në zonat e lira të Shqipërisë së Jugut...

6 Mars 1966

Hymë në krahinën e Shëngjergjit, në krahinën mikpritëse ku u strehua dy herë Brigada e parë Sulmuese gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Rruga

nga Selita në Shënmëri s'është e gjatë. Ne ecim rrëzë Malit me Gropa. Bie një shi i imët e i ftohtë. Në një vend është parashikuar të bëhet qitje me fishekë luftarakë. Njëzet tabela janë vendosur radhë e radhë njëqind metra larg pozicioneve të qitjes. Jo vetëm duhet të marshosh, po duhet të mësosh dhe të shtiesh me pushkë.

Njëqind e ca të rinj presin radhën të shtjenë, 20 të parët hyjnë në pozicion, marrin fishekë, mbushin armët. Janë gati për qitje.

I afrohem një vajze me trup të pakët, është një e re nga Korça. E quajnë Afërdita. Ajo merr nishan dhe shtie. Një, dy, tri predhat fluturojnë drejt tabelës përmes dhjetra krismave të tjera. Pastaj bëhet qetësi. Si dualën? A shkuan predhat në objektiv? Afërdita është e mallëngjyer. Një ushtar që kontrollon rezultatet e që ngre flamurin për çdo të qëlluar në tabelë, po i afrohet tabelës së saj. Ai ngre flamurin një herë, dy .. Nga tre fishekë, dy kanë qëlluar në shenjë. Kjo e gëzon vajzën e ajo ikën duke buzëqeshur...

Mbas qitjes ne arrijmë në Shënmëri. Populli na pret, si gjithmonë, shumë mirë.

Dikush avitet pranë meje e më thotë:

— Merrni një karamele, ju lutem.

Ajo është një vajzë e gjatë, me leshra të lëshuara e me fytyrë të rrahur nga era e nga dielli. E quajnë Drita.

— Ju falemnderit! — i them unë duke marrë karamelen — po me ç'rast?

— Sot kam ditlindjen, — thotë ajo, — mbush nëntëmbëdhjetë vjeç.

E uroj këtë vajzë që feston ditlindjen e saj

gjatë marshimit. Drita buzëqesh e shkon tek çdo partizan e partizane që janë aty përrreth e u jep karamеле. Një ditlindje që s'do të harrohet kurrë.

7 mars 1966

Etapa e parafundit. Shënmëri-Ibë. Kollona sot do të bëjë një rrugë të gjatë.

Në fillim i ngjitemi dy orë malit të Shën Gjinit, pastaj zbresim në Vakumon. Herë-herë bie shi. Është e 20-ta ditë e marshimit tonë. Lodhjen s'e ndjejmë më.

8 mars 1966

Mbaruan të përpjetat e të tatëpjetat, mbaruan shtegtimet nëpër male e lugina, kapërcimet e përrrenjve e majave me dëborë. Marshimit tonë të madh po i vjen fundi, ne ndjejmë një lloj mallëngjimi kur mendojmë se së shpejti do të ndahemi, kur mendojmë se s'do të jemi më bashkë të njëmijë siç ishim gjatë këtyre njëzet ditëve që shkuan. Sjellim ndër mend gjithë rrugën që kemi bërë, sjellim ndër mend Pezën nga e nisëm, Çepanin, Lubinjën, Tomoricën, malet e Skraparit, Moglicën e Korçës, Skroskën e stanet e Dragoshtunit, Qarrishtën e Zabzunin, Kaptinën e Martaneshit... Sjellim ndër mend gjithë rrugën tonë, ditët e marshimit të gjatë e netët pa gjumë, pritjet e përzemërta të popullit, këngët tona partizane, ndërsa kollona çante nëpër shtigje e lugina, shakatë tona, sjellim ndër mend

atë miqësi që lidhëm me njeri tjetrin në vështirësi e sipër.

Dhe ja sot bëjmë pjesën e fundit të rrugës që na mbetet, sot u shtojmë nja 20 kilometra atyre 500 e sa kilometrave që kemi bërë. Tirana na pret sërish mbas 21 ditëve.

Ndjehemi të fortë e të kalitur, fytyrat tona kanë marrë ngjyrë të zeshkët, sepse na kanë rrahur erërat e rrezet e diellit, na ka nxirë dëbora e na kanë forcuar rrugët e gjata. Dikush pastron këpucët nga balta. Një shok thotë:

— Ej, ti! Lëre lluksin. Në Tiranë do të shkojmë kështu siç jemi, do të çojmë baltën e kaq rretheve të ndryshme të Shqipërisë.

Po i afrohem Tiranës. Gjatë këtyre njëzet ditëve ne rijetuan inkursionin e Brigadës së parë me të gjitha vështirësitë e peripecitë që ajo kaloi. Gjatë këtyre ditëve ne bëmë më shumë se 400 km. në këmbë në zona mjaft të vështira, ecëm shumë kilometra në zona të thyera, kaluam dy lumenj, Shkumbinin dhe Devollin, ashtu siç i kaluan partizanët. Rreth 300 km. rrugë nga këto qenë të mbuluara nga bora dhe në shumë vënde terreni qe aq i vështirë sa edhe kafsha me zor se mund të kalojë. I tillë qe udhëtimi ynë. Por i gjithë programi gjatë këtij marshimi këtu synonte: të kalitemi me vështirësitë, të zbulonte përpara nesh veprën heroike të partizanëve, të cilët nuk përfillën asnjë vështirësi, rrezik dhe pengesë për të arritur qëllimin e caktuar. Ne do ta ruajmë për tërë jetën si gjënë më të shtrenjtë këtë marshim të madh. Përshtypjet dhe ndjenjat që provuam do të mbeten të paharruara për të gjithë ne që provuam me këtë rast se ç'do

të thotë shkollë burrërie e trimërie, që mësuam se
ç'do të thotë të jesh revolucionar e t'i shërbesh re-
volucionit gjer në fund me gjithë forcat tona.

Ja tek duket Tirana. Pas pak me mijra njerëz
do të na presin dhe do të na shtrëngojnë duart me
ngrohtësi ne të rinjve që ecëm në rrugën e heroiz-
mit, në rrugën e lavdisë partizane.


IRFAN BREGU

NË GJURMET E FRESKËTA

«...Hej vajzë e vogël, vajzë e vogël, babai është vërtet në ato male. Era që fryn grykës, duket sikur është fryma e të rënëve për liri. Sikur thotë: «Ndaluni. Shikoni. Pishat kanë plumba. Shkëmbinjtë kanë plumba».

Unë nuk kam qenë partizan. Jam i dëshëruar të njoh gjurmët partizane. Ashtu, i etur pas tyre, së bashku me 500 të rinj të shkollave, u nisa nëpër gjurmët e Brigadës V Sulmuese. Rreshti ynë do të ngjitej grykave, maleve, do të zbriste rrëpirave.

... Ishte mbasdite. Vlora ishte e emocionuar. Brigada jonë V u radhit në Sheshin e Flamurit. Nën at nuk na dallonin dot nga njëri tjetri. Të gjithë ishim veshur njëllor. Të njëjtat mendime. Të njëjtat emocione. Na përshëndeti gjeneral-major Sulo Ko-



zeli. Pastaj rreshti lëvizi. Në parkun «Liria» fëmijët kishin ngritur ballonat; ata e ndejnë më parë se kushdo pranverën. Ne ecnim. Herë pas here vështroja nga ballonat. Rreshti ynë shëmbëllente me një lokomotivë me vagona të gjelbërt. Arritëm në Jonufër. Këtu më 14 korrik 1943 partizanët çarmatosën shtatë italianë, që po vinin me një triçikël. Kur partizanët po ngjitnin malin, në xhade arriti një kollonë italiane. Filluan t'i qëllojnë edhe anijet nga deti ndërsa nga ajri qëllonte aeroplani. Pas po u shkonin ushtarët italianë. Vapa s'durohej. Po tanët ishin të fortë. Më të fortë se vdekja, që i kish rrethuar. Dhe aksioni mbaroi me sukses. Populli i Vlorës gëzoi. Armiku u tmerrua...

Po ecja anës kollonës. Poshtë ishte deti. S'gjej figurë për të treguar kaltërsinë e tij dhe ato valët e bardha. Sipër, qielli i kaltër dhe ky, me disa re të bardha të shpërndara. Në xhade jemi ne, rinia, me pushkë në krahë. Tutje në det vështroj dy vaporët italianë të mbytur pa lavdi këtu, në gjirin e Vlorës.

Në krye valëvitej flamuri ynë i kuq si flaka. Në qiell filluan të shëmbëllejnë me copëza të kuqe retë e shpërndara nga era. Dielli po jep përshëndetjet e fundit. Ç'më shqetësojnë kujtimet. Hej shkolllarë, mos harroni atë sheshin atje tej. Kanë qenë depo të ushtrisë italiane. Një shkollar, kaq sa ju, i bëri shesh. Nënë Aisheja e kish të vetëm, si dritë syri. Natën duke u gdhirë 22 korriku i vitit 1942, vendi gjëmoi. Depot e armikut shpërthyen aq fort, sa edhe xhamat e shtëpive të fshatrave aty pranë u thyen. Anijet armike në det u tmeruan dhe lanë

molon. Tym. Flakë. Gjëmime. Ku e gjeti gjithë atë guxim shkollari hero? Shqiponjë e vogël me zemër të madhe. Jetën ja dha nënë Aisheja; guximin ja dha partia, optimizmin shokët. Dhe ai, Shyqyri Alimerkua, ja kushtoi jetën atdheut, komunizmit. Ra kundër armiqve.

Kjo fushë, mbuluar nga nata ç'më tërheq tutje... Kolona ecën, ecën nëpër natë. Dëgjoj zhurmën e këmbëve të «partizanëve» dhe detin që përkëdhel bregun. Dhe ashtu, nëpër natë, më bëhet sikur vijnë me ne Kastriot Muço, Zonjë Çurre, Fejzo Gjomemua dhe Shyqyri Alimerkua, i djersitur. Ai sikur po vjen nga djegia e depove të Radhimës. Ka shumë gjëra të thotë. Por heronjtë s'flasin. Historitë e tyre tregohen nga të tjerët. Kujtimi i zjarrit të depove të armikut që digjeshin, më jep vapë të madhe. Ndjej të nxehtë. E përpjeta qënka e lodhëshme. M'u penguan këmbët në një gjështër. Desh rashë. Dëgjova një zë: «Kujdes, shokë, mos u shkëputni nga njëri tjetri». Ishte komandanti ynë, kolonel Adem Xhaka. Heshtje. Dhe pastaj prapë nëpër natë unë ndjej frymën e heronjve që më dukeshin sikur hynin nëpër rrjeshtat, në mendimet dhe zemrat tona...

Ne ecim drejt Tragjasit. Tragjasi, që ka qenë baza e çetave partizane, na pret. Vështrojmë dritaret plot dritë, që duken si ca sy të dhëmshur, si sytë e nënave që na përcollën. Tragjasi ka festë. Tragjasi i dëshmorëve, Tragjasi i partizanëve. Megjithëse të lodhur, tragjasiotët na presin, këndojnë së bashku me ne. Të rinjtë kanë organizuar edhe mbrëmje vallëzimi. Aty takohem edhe me shokun tim, që erdhi vullnetarisht në fshat me thirrjen e

Partisë, komunistin Ismail Rrapin. Këtu gjithëka është e re. Së shpejti do të hapet edhe vatra e re e kulturës. Kam dëshirë të bredh nëpër Tragjasin e shumë historive të pakënuara, e historive partizane. Komandanti urdhëroi të shkojmë për të fjetur tamam ashtu si në kohën e luftës, kur «partizanët» i shpërndanin nëpër shtëpira. Shkova dhe unë me disa shokë në një shtëpi. Gjumi nuk më zuri gjithë natën. I zoti i shtëpisë sigurisht që çuditej dhe ndofta thoshte: «Djalë qyteti ky... Nuk e zë gjumi me velenxë. Kushedi, mund t'i çajnë edhe këmbët nga lodhja...». Dhe unë i flisja me vete: «Jo, nuk është puna aty. Ti mos ma merr për keq. Fli, se nesër do të dalësh në arë. Por s'më zë gjumi se po mendoj burimin ku i gjeti forcat populli i kësaj krahine, që iu dorëën shtënitë me jetoi shpellave, që iu vranë djemtë e vajzat dhe iu zhurit shpirti, po kurrë nuk u mposht dhe gjithnjë u përtërit». Dhe, mendja bredh monopateve e ngiitet lart në fshatin e djegur nga armiqtë e kthehet prapë e zemëruar këtu në fshatin e ri. Kështu kaloi ajo natë. Në mëngjes u mblodh brigada. Partizani i vjetër, komandanti ynë Adem Xhaka, na foli për aksionin e Radhimës. Pastaj, të rinjtë dëgjuan nga ai si erdhi në fshatin Tragjas themeluesi i Partisë, shoku Enver. Ishin vitet e vështira të luftës. Armiku i partisë dhe i popullit Sadik Premtja donte ta minonte Partinë. Po Partia i kishte rrënjët tek populli. Populli është i pavdekshëm. Partia jonë është e pavdekëshme. E ku nuk ka shkelur këmba e udhëheqësit tonë të madh për lirinë e lumturinë tonë.

Sadik Premtja u fshi nga dora e revolucionit. Partia jonë triumfoi...

Tragjasi mbeti prapa... Ne ecim përnjetë përroit të Gërzhinës. Ai qënka shumë i gjatë dhe i mërziqshëm. Filluan të na vriten këmbët. Ripat e pushkëve na vrasin supet. Trastat na rëndojnë. Vetëm era e freskët e maleve sikur na qetëson. Shokët ndihmojnë njëri tjetrin. Shumë nga vajzat ecin z bathur, megjithatë nuk i japin pajimet. Tek ecja me komandantin, përpara nesh rendte një vajzë e vogël. Komandanti tha: «Qënka e vogël, por e fortë si shoqja jonë partizane Violeta». Një djalë iu përgjegj: «Shoku komandant, edhe ajo quhet Violeta». «Interesant», tha komandanti. Unë mendoja: «Sa bukur që brezat vazhdojnë gjurmat e njeri tjetrit».

E përpjeta sa vinte bëhej më e lodhëshme. Dikujt pranë meje i shkau këmba. Kalojmë mbi shkëmbinj, mes drurësh që mpleksen njëri me tjetrin, megjithatë rrjeshti nuk këputet. Ngjitim qafën e Gërzhinës. Poshtë duket Dukati. Ja dhe rruga drejt Llogarasë duket si një litar i përdredhur që pjesë-pjesë e fshehin kodrat. Kurse ne duhet t'i ngjitemi Kozarës. Përpara meje ecën Violeta Mane, vajzë e një dëshmori të sigurimit, e cila nuk pranon ta ndihmohet. Ka hedhur automatikun krahtë-qafë. Është e djersitur. Më duket sikur vrapon, sikur e thërret një zë atje lart. Mos është zëri i babait në ato gryka? Hej, vajzë e vogël, vajzë e vogël, babai është vërtet në ato male. Era që fryn grykës, duket sikur është fryma e të rënëve për liri. Sikur thotë: «Ndaluni. Shikoni. Pishat kanë plumba. Shkëmbinjtë kanë plumba». Ata dëshmojnë, megjithëse s'kanë gojë. Kësaj qafe shumë herë u

ngjitën dhe luftuan çetat partizane. Këtej kaloi dëshmori Rrapo Hasimi me shokë, duke luftuar me armiqtë. Këtej Zonjë Çurrja ngriti shokët. Ajo ngjiti Majat e Zeza të Tërbaçit dhe doli në qafën e Stogoit. Atje tek shpella mbetën Kujtim Hoxha, Lilo Asllani, Azbi Hyseni dhe një partizan tjetër. Më vjen keq që s'ja mësova emrin. Po një ditë do ta mësoj. Dhe do të shkruaj për të. Ecim drejt Qafës së Shëngjergjit. Më pihet ujë. Bora qëndron nëpër pisha. Më duket sikur mbi kokë kemi jo borë, por trëndafila të bardhë. Qafa e Shën Gjerqit paska qënë shumë e vështirë. Po partizanët si e kanë ngjitur mes borës, mes shiut, erës dhe vapës? Ç'këmbë të fuqishme dhe ç'zemër heronjsh kanë pasur! Këmbët disa të rinjve u janë mpirë. U merret fryma. U pihet ujë. Por ujë s'kanë ku gjejnë, as borë s'mund të hanë. Thonë se të bën dëm në marshim. Durojnë. Qafa është akoma larg. Megjithëse era godet e ftohtë, prapë kemi vapë. Duhet të ecim me kujdes, që mos u rrëzojmë gurë shokëve që vinë pas. Shtegu është i ngushtë. Disa mezi ecin. Tani ne pyesim: Ç'bënin partizanët në këto raste? Marshonin, mbronin, jetonin për njeri tjetrin. Po ne nuk jemi pasardhësit e tyre? Ashtu bëme. Ja, Ylli ka ngritur pajimet e dy shoqeve dhe i mban përdore. Ai është i shkurtër. I djersitur. Megjithatë ecën përpjetë qafës. Më duket si një shqiponjë e vogël dhe dy krahët e tij si krahët e shqiponjës që janë gati të mbrojnë shoqet në çdo çast. Ecim. Përpara meje, është shoku im Dasho. Ai është rritur në këto gërxhe. Kërcen porsì një dre nga një shkëmb në një shkëmb tjetër. Gjithmonë prin përpara. Ç'zemër të fortë paska! Ja kam zili. Ja, më

në fund, Qafa e Shën Gjergjit. Poshtë rruga vazhdon në rrëpirë. Ah, qafë e Shën Gjergjit, qafë e Shën Gjergjit! Këtu kanë kaluar qindra herë partizanët. Ka plasur gjaku i kuq partizan. Le të vijë këtu skulptori të gdhëndë mbi shkëmb partizanin e Partisë që s'e theu as bora, as vapa, as uria, as armiku. Ky ujë që rrjedh, di shumë legjenda partizane. Tej vështroj majën e Qores dhe të Çikës. I kam ngjitur ato maia. Mbrëmja filloi të derdhë një si pëlhurë të zezë të hollë.

Mbahemi me njëri tietrin. «Kujdes shokë», flet pa reshtur komandanti. Rreshti është i gjatë. Rruga e ngushtë. Duhet të kalojmë një nga një. Disave u janë ënjtur këmbët dhe u dhëmbin. Unë e di. I shikoi. Po asnjëri nuk tregon. Ecim në heshtie. Dikush ja nisi këngës: «Dalëngadal po vjen behari» dhe gjithë rrieshti e pasoi «dalngadalë po na vjen». Unë i shikoj. Unë mësuesi, që dvshoia në forcat e tyre. Ata janë tërë plagë nëpër këmbë, të diersitur. Këndoinë dhe ecin. Nxënës revolucionarë, tani ju dua dhe më shumë. Jam shoku juaj. Këndoju dhe unë. «Nëpër fusha rritet bari» dhe mendia më shkon te shkollarët dëshmorë, Lef Sallata e Mit'hat Dauti, të cilët luftuan kundër 60 karabinierëve të kavalerisë italiane. Ishte 8 shkurt i motit 1943. Ata ranë heroikisht në katundin Ceprat të Vlorës. Dhe ishin të rinj, dhe mbetën të rinj. Të rini si këta që po zbresin qafën dhe këndojnë. Kënga sikur i lidh të pesëqind zemrat me njera tjetrën. Dhe zbresin qafën e Shën Gjergjit si një trup i vetëm. Tërbaçi po na pret. Është fshati ku lindi komisari i brigadës sonë të V, shoku Hysni Kapo. Përqafohemi me fshatarët. Nis shpërndarja nëpër shtëpitë. Tërbaçi

qenka shumë i përhapur. Më dhëmbin këmbët. Pjesa më e madhe e «partizanëve» u strehuan shpejt. Unë eca me disa të tjerë përpara. Ja vendi që quhet Lëkudhe. Atje ka qenë konaku i komunistit të mërguar Halim Xhelo. Në atë vend tani është bërë shkollë. Dikush më foli për djalën e Halimit, Nusretin, i cili jetoi në një varfëri të madhe së bashku me gjyshen. Kishte vetëm pesë cangalle për dhallë dhe një gomar. Ai doli malit që katërmbëdhjetë vjeç, ashtu si dikur i ati. Luftoi dhe ra me mitroloz në dorë kundër armiqve të komunizmit. At'e bir, dy zemra e një ide. Pasi ecëm dhe ca, pjesa më e madhe u strehuan. Mbetëm pak. Më thanë se duhet të ecnim edhe ca përpara drejt një shtëpie. Sa dëshirë kisha të shtrohesha këtu në këta drurë të vegjël që s'dalloheshin se ç'ishin. Në atë shtëpi paskëshin çuar «partizanë» të tjerë. U bëmë shumë. Desha të kthehesha. I zoti i shtëpisë na ndali. Megjithëse ishte mesnatë, fshatari na bëri bukë. Hoqëm këpucët dhe ramë të flemë ashtu siç ishim. Duhej të qetësoheshim. Të nesërmen do të vinte komandanti i brigadës së pestë sulmuese, Shefqet Peçi. Ndofta secili shikonte në ëndër ato çaste, kur ai do të takohej me ne në Bramysh. Unë nuk e kam dëgjuar si flet, kam lexuar vetëm shkrimet e tij; ai është edhe poet, këngët i thuri në luftë dhe jo vetëm në luftë. Të nesërmen e presim me padurim. Shkuam në Bramysh. Këtu takuam njerëz krenarë dhe zemërbardhë, midis tyre edhe xha Muçon, që shëmbëllen me një lis, i ka rrënjët në të thellat e dheut. Muço Delua ka ardhur vullnetar me thirrjen e Partisë. Vullnetar ka qënë ai gjithë jetën për të mirën e Atdheut. Luftoi më 1920-tën,

luftoi partizan. Lufton edhe sot... Ra qetësi. Erdhi komandanti i etërve dhe vëllezërve tanë, i Brigadës V Sulmuese shoku Shefqet Peçi. Brigada jonë, bijë e asaj Brigade legjendare, është e emocionuar.

Shoku Shefqet Peçi u foli të rinjve si u formua Brigada V S. më 20 janar të vitit 1944. Inaugurimi i brigadës, u bë me vonesë, sepse operacionet naziste të njëpasnjëshme në qarkun e Vlorës, penguan shumë. Abas Shehu, që qe caktuar komandant i Brigadës V, nuk arriti të shikonte ditën e inaugurimit, sepse ra kundër fashizmit gjerman në Gjorm. Në librin: «Kujtime dhe dokumenta nga lufta Nacional-Çlirimtare» shoku Shefqet Peçi shkruan: «Unë u njoha me luftëtarët e Brigadës V S. që i dhanë nder e lavdi emrit të tyre partizan, që nga Vlora e deri në tokat e Jugosllavisë, që nuk lanë vend, nga do që shkuan, pa e larë me gjak, që nën udhëheqjen e ndritur të Partisë sonë, me shokun Enver Hoxha në krye, mbuluan me lavdi armët e tyre». Ai u foli të rinjve që të kaliten fizikisht, të studjojnë historinë e luftës Nacional-çlirimtare, t'i ruajnë traditat luftarake e revolucionare. Pas bisedës, me shokun Shefqet Peçi, Brigada u ul për pushim. Shoku Shefqet këndoi labçe së bashku me ne.

Desha të takoj ndonjë nga familja e Resul Ve-liut, por s'qe e mundur. Kam qënë fëmijë kur kam njohur xha Resulin. Më kujtohet trupi i tij i lartë, mustaqet e zeza, qosteku i sahatit dhe përkëdhelitë e dhëmshura. Megjithëse pak e mbaj mend, ai mbeti si një kujtim i dhëmshur për fëmijërinë time. Xha Resuli i qëndroi besnik Partisë Komuniste. Në kohën e fraksionit të Sadik Premtes, ai nuk u lëkund.

Ai u tha: «Unë i kam dhënë fjalën Partisë. Unë nuk ju besoj pa ardhur këtu Hysni Kapua». Ardhia e shokut Hysni dhe biseda e tij, i bindi të gjithë për drejtësinë e vijës së Partisë. Xha Resuli s'është më. U vra në qafën e Këçokut së bashku me Kastriot Muçon kundër gjermano-ballistëve. Mbetën prapa vetëm kënga dhe liria që dëshëronte.

U takova këtu edhe me Ibrahim Dervishin, njeri shumë i qeshur. Këta, njerëzit që bënë luftën, janë shumë energjikë, megjithëse janë edhe të mocëm. Kam dëgjuar shumë histori për doktorin e partizanëve. Ai vetë s'tregon. Mësova se ai, më 28 nëndor 1942 në Brataj uli flamurin italian dhe ngriti flamurin shqiptar. Doktorin u shpëtoi jetën shumë shokëve gjatë kohës së luftës. Ai u lidh për jetë me njerëzit e varfër të maleve. Luftoi, vojti, jetoi, gëzoi së bashku me lebërit. Ai sot, me thirrjen e partisë erdhi prapë nëpër male, midis njerëzve të maleve, se ai e lidhi për jetë fatin e tij me këto male.

...Koha s'pret. Ne duhet të ikim. U bë vonë. Na përcolli vetë komandanti i Brigadës V S. U ndamë në tri grupe. Një në Vranisht, një në Kallarat e tjetri në Kuç. Pas një udhëtimi të gjatë, të shpërdhurit sikur të rëndon më shumë këmbët. Trupi të mpirhet, megjithatë, duhet ecur. Brigada u nis drejt qafës së Pëllumbit. Te kjo qafë, më 28 shtator 1942 u godit një kullonë armike, ku u çarmatosën 35 ushtarë fashistë italianë. Në fillim dikush u thirri italisht të dorëzoheshin. Pastaj nisën të shtënat partizane. Ata thërrisnin «Mama mia, non sparate, siamo fratelli»¹⁾. Ç'vëllezër, more, mund të ishin

1) Nëna ime, mos qëlloni, jemi vëllezër.

partizanët me pushtonjësit. Ujku mbetet uj. Ak-
sioni mbaroi me sukses. Këtu ka marrë pjesë edhe
Ademi. Ç'guxim që kanë pasur partizanët! Karro-
ceria e maqinës ishte më lart se prita që kishin zënë
ata. Megjithatë, të gjithë italianët u çarmatosën.
Komanda italiane u alarmua. Vunë në krye një to-
ger ballist dhe shkuan e dogjën shtëpitë e komu-
nistëve të Tërbaçit. Ecim dhe këndojmë. «Ulen retë
e vrejtet qielli sterë. Dhe andej nga mali «nis lufta
e paprerë». Fshatarët, që na shohin, krenohen, u
mbushen sytë me lot, kushedi ç'kujtojnë!
Ndofta 63 vranishjotët që pushkatoi gjermani. Këtu
në afërsi të katundit Vranisht, më 20 shkurt 1944,
ra duke luftuar kundër armiqve Laze Nuro Feraj
nga Brataj.

Duke ecur rrugës, m'u kujtua kënga e poetit
popullor, xha Selimit, nga Brataj:

*Partia kur u fillua,
Laze Nurua u kërkuua,
Si person fort i besuar...
Laze Nurua kaçandoni
Një komandant batalioni...*

Dhe ne ecim. Na mbulon pluhuri, djersa, kui-
timet. Ja, atje lart edhe Vranishti, fshati i Sali
Kapedanit, që kënga popullore e këndon:

*Kush njuh kapedan Salinë
Trimn' e madh zemër çelikhë
Bombat e gjylet e grinë.
Tha me tel çorra kërcinë
Të mos helmonj shoqërinë*

*Kapedan Sali Vranishti
Sa rrove punoi gishti.*

Atje ka ardhur edhe djali i Sali Kapedanit, Mamani, i cili me thirrjen e partisë nisi një jetë të re së bashku me njerëzit e maleve. Grupi, ku isha unë, u ndal në Kallarë. Kërkova vetë të isha këtu. Në rrugë pashë varrin e deputetes Duze Bajrami, gruas luftëtare, nënës së mirë të Muminut. Një plak tregonte se Muminut i pëlqente shumë një pyll, aty në të dalë të fshatit. Aty ulej dhe diçka shkruante në një fletore. Çfarë shkrimesh ishin ato? Vjersha, tregime, apo skica? E ku ta dish, gjersa edhe fletorja nuk është gjetur? Të gjithë fshatarët flisnin me admirim për të. I kanë thurur edhe këngë:

*Bogonica me Cipinë, ç'kanë që qajnë me lot?
Qajnë me lot për Muminë, që nuk ndodhet këtu sot:
Të na mblidhte djalërinë, se kishte që t'i thosh plot,
Të bëj grupe me rininë, si bënte para një mot...*

Bogonica është mali përballë nesh. Në rrëzë të malit ka qenë fshati i vjetër, i djegur nga shovinistët grekë në motin 1914. Kanë kaluar këtej shovinistët grekë, italianë, gjermanë, ballistët dhe i kanë djegur këto fshatra. Po malet s'digjen. Dhe njerëzit janë si malet.

Të kënaqur nga mirëpritja e Kallarëtit u nisëm për në Ramicë. Rrugës pashë një vajzë të dëshpëruar që ecte ngadalë, sikur në Kallarë kishte harruar diçka të dhimbëshme. Pa e pyetur më tha: «Mbrëmë fjetëm tek një plakë. Ajo kishte djalin

dëshmor. Vajzat i janë martuar. Tani rri vetëm. Më erdhi keq». «Pse?» e pyeta. «Që është vetëm». Mbrëmë ajo më tregoi historinë e djalit. Ç'zemër kanë këta njerëzit e labërisë! Atë që kishte më të shtrenjtë, djalin, ajo ja fali lirisë. Në çdo moment na thoshte: «Partizankat e nënës, më ka marrë malli shumë për djalin. Mbrëmë kur ju pashë, desha t'ju përqafoja të gjithëve, të gjithëve, se ju jeni tani bijt e mi...» E çuditëshme! Ç'zemër të madhe kishte! Ajo na fliste plot entuziazëm për ndryshimet që do të pësojë fshati. Kudo që ne shkelëm, gjetëm nëna të dhëmshura, sa nënat tona, gra burrërore, krenare, ashtu si malet... Unë heshtja dhe dëgjoja. Pastaj ajo vajza eci përpara. Mundohesha gjithë rrugës të përfytyroja atë nënën plakë, tek vështron e përлотur, po entuziaste, rrjesh-tin tonë. Ç'kërkon ajo me sytë e saja nëpër rrjesh-tat tona? Mos vallë të gjejë birin e saj që iku e s'u kthye më? Jo, ajo nuk rron me iluzione! Ajo e di që djali iku në rrugën e lavdishme. Ajo nënë tashti ndjek rrugën tonë. Shikon ne, bijt e saj, që erdhëm nëpër male... Doja t'i gjeja tiparet e atij partizani të Partisë, që la nënën vetëm, tek ata që po kalojnë Buronjat e Kuçit, lumin e Smokthinës, dhe ngrenë në kurriz shokët e tyre. Hyra në lumë. M'u thanë këmbët. Është mars. Po ata, partizanët, si e kanë kaluar në dimër?

...Duhet të ecim përpara. Kjo e përpjeta e Ramicës qënka e vështirë dhe e mërzitëshme. Duke ecur të përpjetën, më shkon mendja te xha Zotua, për të cilin tregon Shefqet Peçi në librin e tij. «Xha Zotua ishte plak i zgjuar dhe në jetë të tij kish kaluar shumë halle, tregonte shumë historira dhe

me fjalët e tij ta hiqte lodhjen e mërzinë.» Sot më treguan që xha Zotua qënka i ati i Sadik Zotos, që u vra së bashku me Shyqyriun kundër xhepistëve¹). Kjo familje trimash nuk mund të të hiqet nga mendja. Ajo sakrifikoi shumë për ditët e mira që kalojmë. Të rinjtë duhet ta dinë këtë. Ja tregova një grupi. Të tjerët ecin përpara, madje me këngë. Kur po hyja në fshat, lart në mal, përballë nesh dukeshin shpellat. Mendova: Atje do të ketë qenë spitali partizan, për të cilin kisha dëgjuar shumë gjëra.

Pluhuri na është ngjitur në fytyrë e jemi djer-situr. Dikush kërkon të lahet. Nuk i lejova, se kam frikë se pijnë ujë e ftohen. Ata, të bindur, ecin. Ramica ka qenë si qendër prej nga shokët udhë-heqës të Vlorës drejtonin luftën partizane. Te kthesa e rrugës ishte një burim. Atje të rinjtë u ulën të pushojnë dhe Ademi u foli për Osmën Beshirin. Kur ai tregonte, mua më shkonte mendja te kënga e njohur:

*Ç'amanet i le rinisë?
Osmën, o lule.
Bukë e paqe puntorisë
Osmën, o lule...*

Edhe Osmën Beshiri ishte djalë i vetëm i në-nës. Ai u vra duke luftuar si luan në Buallar. Ademi tregoi edhe për dëshmoren Rakibe Dervishi. Ajo ka qenë vajzë shumë e re. Shikoieni nortretin e saj në muzeumin e Vlorës. Të kujton Tanushën

1) Xhepi — pseudonimi i tradhëtarit Sadik Premti.

e «Ciklit të Veriut». Ademi tregoi edhe për të tjerë. Këta partizanët e vjetër kanë qindra kujtime, secili ka historitë e tij.

Pas bisedës duhet të nisemi. Ecim. Jo shumë larg është Velça. Fshati është në një kodër të vogël. Ne ecim rrëzë kodrës. Poshtë janë taracat, që ngjajnë si një amfiteatër i madh në këmbë të fshatit. Ja edhe shpellat e Velçës, por s'mund t'i shohim. Po bie nata. Ecim. Mendja më shkon tek ajo nëna e Kallararit, tek nëna e Osmën Beshirit, tek nënat tona. Që të mos e ndiejnë veten vetëm ato, ne ecim nëpër natë me pushkë në krahë. Kam në krahë oficerin Bexhet Sabriun. Ai është i shqetësuar. Kërkon varrin e babait që s'e ka njohur kurrë. Të atin, Sabri Peli-vanin, e vranë në shkurt të motit 1943. Bexheti lindi disa muaj më vonë. Edhe i ati i Bexhetit po në këto rrethana kish lindur. Interesant! Të njëjtat fate. Gjetëm vendin ku ishte vranë babai i shokut tonë. Atje ishte vranë edhe Hysni Hate. Varret i kishin pasur midis dy shkëmbinjsh. Sikur Atdheu ua kishte lënë amanet t'i ruanin. Ne qëndruam pranë varreve. Nga sytë e shumë të rinjve rrodhën pika loti. Shtrënguam pushkët dhe ecëm drejt Kotës. Duke ecur ja morrëm një kënge labe.

*«Ç'ju kish rritur nëna për një botë të re,
Lule, more trima, që ratë për Atdhe».*

Ecim dhe këndojmë. Duke kënduar, i afrohemi qafës së Dushkut. Tregojnë se edhe këtu partizanët kanë luftuar kundër gjermanëve dhe ballistëve. Armiqtë këtu kanë lënë armët, tallaganët dhe kokat e

tyre. Ne ecim. Yjet na duken sikur pikojnë rreze mbi kokat tona. «E çuditëshme!» — thotë një shoku im, — «qielli i kësaj krahine sikur paska shumë yje»... Unë e kuptoj ku e ka fjalën shoku im. Ai flet me figura. Po! Qielli në këtë krahinë ka shumë yje: yje partizane. Ne ecim. Dikush numuron yjet. Nëpër rrjeshtat këngë. Në zemra entuziazëm. Dikujt i dhëmbin këmbët e ndalet. Shokët e ndihmojnë. Rrjeshti ndalon pak dhe pastaj ecën me zhurmë xhadesë. Dalim në qafë. Ja dhe Kota. Një grup niset për në Mavrovë. Ecim xhadesë pastaj fillojmë e ngjitim kodrën. Këtu lart, tregojnë, janë bërë shumë luftra, ashtu siç këndon edhe kënga:

*«Njëzet e ca shokë se ç'u bënë pre
Lule, more trima, që ratë për atdhe».*

Këtu u vranë partizanët Mustafa Asllani dhe Veis Mema. Këtu u vra djali i partizanit të vjetër, Jaho Gjolitikut, Mitat Gjoliku, zëvendës komisar i batalionit «Baba Abaz». Po atë ditë në Rëzomat e Delvinës u vra djali tjetër, Aliu, njëzetedyvjeçar, komisar kompanie. Kjo kodër të djegëka këmbët. Ndofta është zjarri i luftrave. Gjithë toka jonë të djeg kështu.

Asnjërit nuk i flas për lodhjen. Ndofta të tjerët janë edhe më keq. Dhe heshtin. Era sikur fryn e nxehtë. Më zë frymën. Më duket sikur po përtyp pluhur. Vërtet. Edhe uria më ka marrë. Kam që mbrëmë pa ngrënë. Tashti ora është 23.30. «Më duket që bëjmë gabim e u trokasim fshatarëve kaq vonë» tha një shok. «Pse? — tha një tjetër — ne

jemi njerëzit e tyre!» Dhe ja shtëpia që kërkonim. Është mezi i natës. Dërguam një shok të trokasë.

Në mëngjes u kthyem në Kotë. Morëm vesh se një pjesë më e madhe kish fjetur përjashta, megjithatë, asnjeri nuk ishte i mërëzitur... «Shoku komandant, po sikur të bëjmë një parakalim këtu?» i thashë komandantit. Ajo copë mishi e plagës së vjetër e mbledhur në ballë i lëvizi. Me sa duket Ademin plumbi e ka shpuar në ballë në ndonjë betejë. Ndofta ndonjë ditë do të na e tregojë vetë historinë. I çeli fytyra. «Nuk është keq» tha. Dhe ashtu u bë. Brigada u rrjeshtua. Filloi parakalimi. Ai e dinte që «partizanëve» u dhimbnin këmbët, megjithatë para komandantit ata buzëqeshnin, shtrinin hapin dhe tregoheshin të guximshëm. «Hajde trima, u thërriste, të mos e turpërojmë partinë». Interesant. Këta partizanët e vjetër janë shumë të ndjeshëm, janë shumë të sinqertë. Kanë shpirt të pastër si fëmijë. Ai u entuziazmua që shkollarët, megjithëse dje ecën nga Kuçi e Kallarati gjer në Kotë, pa gjumë, sot këndojnë: «Jemi trima partizanë, vdesim për liri...». Ai shkëputet nga unë dhe ecën përpara.

Rrugës pashë si «partizani» Besnik Xhafa po ndihmonte një shok, që i qenë bërë këmbët gjak. Nuk i fola. Ai është nxënës shumë i mirë, i pëlqen dhe letërsia. Thonë që edhe shkruan. Ndofta, pranë pushkës, në xhep ka dhe bllokun e vjershave. Le t'i mësojë të dyja në një kohë! Duke menduar kështu, eca tutje. Pas pak pashë vajzën e një mjeku. Dukej që ishte e lodhur dhe çalonte. Këpucët e kishin vrrarë. Megjithatë, ecte. Ditën e parë e pati të vështirë. Unë e pashë rrugës. Sot ajo ecën e

sigurt, e qetë. Pa çka në i dhëmbin këmbët. Fytyra i është nxirë. Një kaçurelë që i del nga bustina, ja lot era. Nganjëherë ajo buzëqesh. Ndofta mendon çastin kur do të takohet me prindërit. Mوندhem të gjej Muçon. Muçua është ai burrë i shkurtër dhe energjik, që vë në lëvizje gjithë Brigadën me humorin e tij të këndshëm. Kushdo dëshëron ta ketë pranë. Kur e pyesin për vete, si ka luftuar ai vetë buzëqesh, dhe s'flet, po ecën. Kështu ma ka bërë disa herë. Dua t'i them: «More Muço, pse më bie vërdallë të shkretën. M'i thuaj ato që ke parë e ato që ke bërë, se na duhet t'ja themi rinisë. Kurse ai buzëqesh, sikur më thotë: «Pse, ore, mua më gjete ti? Ka pasur burra më të mirë dhe luanë të tjerë kjo lufta që shkoi. Pyeti ata. Unë s'kam bërë asgjë» dhe buzëqesh. «Megjithatë, more Muço, unë do të të thyej. «Shoku Adem, iu drejtova unë, me qënë se po i afrohem i Drashovicës, dua të di ky Muço memeci, kur luftonin partizanët për Drashovicën, mos luante gjë cingël, apo flinte me ndonjë përrallë? . . . ». Muçua prapë buzëqeshi. Pastaj, për çudi, u mvrejt. «Siç duket po thyhet,» mendova. Iu kujtuan shokët e vrrarë e të plagosur në këto anë. «Jo, Muçua ka qënë ujk në kohën e luftës. Nuk përmbahej. Ai, kur u vra Fejzo Gjomemua nga ana e përtejme, zbriti këtej së bashku me shokun Hysni Kapo dhe një partizan tjetër. Shkuan nëpër lumë. Kur u plagos shoku Hysni, Muço Gjoka e ngriti në krahë, megjithëse ishte më i vogël nga trupi. Ja, ky Muçua, i shkurtëri. Të tjerat le të t'i tregojë vetë . . . ». Muçua tashti ishte mvrejtur. Siç duket i kujtohej ai çast, kur mendonte si të shpëtonte komisarin e tij nëpër ujë, mes plumbave, kur vde-

kja ishte aq pranë. Po edhe Muçua ishte i fortë. Me pak fjalë ai më tregoi si e kishte çuar shokun Hysni në një pyll dhe kishte vrapuar të lajmëronte shokët. «Keni dëgjuar ju për zemërimin partizan? — m'u drejtua ai. — Partizanët nuk kanë qënë trima të marrë, por të mençur dhe të bindur, ata luftonin dhe mbroheshin sepse e donin shumë jetën, por në Drashovicë partizanët s'e peshuan fare vdekjen. Ke dëgjuar ti për Fejzo Gjomemon? Ishte udhëheqës politik i krahinës së Dukatit. Ç'thoshte, bënte. Ja, këtu në Drashovicë ai vdiq për të mos vdekur kurrë...» Muçua nuk mundi të vazhdonte më. Unë u ula, diku aty afër shkollës, ku brigada po bënte pushim. Ademi po u tregonte «partizanëve» për luftën e Drashovicës. Fliste për dëshmorët. S'di si më shkoi mendja tek Ismet Çakërrri. E dini? Kush s'e ka njohur, nga fotografia që është në muze të Vlorës mund të krijojë një ide. Duhet të ketë qënë çapkën dhe sherret. Sherreti trim që donte aq shumë nënën, vrau marshallin e S.I.M.-it Lombardon që kishte pikëlluar aq nëna vlonjate. Marshall Lombardua ishte shumë i rrezikshëm. Dinte shumë giuhë. Shqipen e fliste po aq mirë sa italishten. Njësitit gueril kishte vendosur që ta zhdukte. Kishin marrë me vete edhe Ismetin, sa për të ruajtur. Shokët e njësitit prisnin të dilte marshalli në rrugë. Ismeti sa e pa, e qëlloi dhe e la top në vend. Vrasja e marshall Lombardos bëri bujë. Armiqtë u tmeruan. Kështu Ismeti doli ilegal. La nënën vetëm dhe iku maleve. Këtu në Drashovicë ai u dallua në të gjitha luftimet. Dhe ra te çezma e Zonjës si shqiponjë e plagosur, «sherreti» i nënës, që u bë lavdia e çetës.

Dikujt, pak më tej, se si i shkrepri të qëllojë me automatik. E prapë mendja ime thërret pranë heronj të tjerë të Drashovicës. Më bëhet se dëgjoj mitrolozin e Fadil Dautit, se dëgjoj klithmat e armiqve. Dëgjoj sokëllimat e Fadilit: «Hej, hej, shihni si bien kopukët!..»

Dëgjoj si sulmon çeta e rinisë me komisar Kastriot Muçon në krye. 20 ditë rresht populli fukara luftoi kundër gjermanëve të armatosur gjer në dhëmbë, po aty ku 23 vjet më parë kishte luftuar kundër imperialistëve italianë. Dy epope të lavdishme, po i njëjti qëllim; për lirinë e vendit. Ranë këtu në Drashovicë 11 dëshmorë dhe u plagosën 45 partizanë. Ai lumë që rrjedh, atje poshtë, dhe ajo fushë, pak më lart, do të jenë dëshmitarë të përjetshëm të lavdisë partizane. Ne e dashurojmë dhe përunjemi para lavdisë partizane. Prandaj përshkuam qafa, male, lumenj që t'i njohim shtigjet e kuqe partizane. Ne përshkuam shumë pak nga ajo rrugë e gjatë dhe e lavdishme që ka bërë Brigada e V S. Rruga e saj i kalon kufitë e tokës sonë gjer në Pripolje. Brigada e V sulmuese, përveç dëmeve materiale, i ka shkaktuar armikut humbje të mëdha në njerëz, që arrijnë rreth në 5000 të vrarë. Ajo i dha çlirimit të vendit 225 dëshmorë...

Ashtu të rënduar nga kujtimet, iu nisëm së përpjetës. Kaluam Qishbardhën. Ja dhe Qafa e Koçiut, që këndon kënga. Këtu Selam Musai zuri topin italian nga gryka, që Vlora të ishte vetëm jona dhe jo e italianëve, që Vlora të ishte e lirë... Prandaj të rinjtë këndonë:

«Ja të bëhet Vlora jonë.

Ja të bëhet shkrumb e hi...»

Ndalojmë afër spitalit. Rregullojmë rreshtat. Nisemi. Në të hyrë të qytetit bie bori e Brigadës. Më kujtohet dita kur hyri në Vlorë Brigada XII. Ne, fëmijët, vraponim këmbëzbathur pas partizanëve. Partizanët na merrnin pranë, na përqafojnë. Dikush më dha dy yje. Kujtimet e fëmijërisë nuk harrohen kurrë. Ja po më kujtohen dhe tashti. Fëmijët na ndjekin pas. Hyjnë nëpër rreshta. Unë nuk u flas. Më kujtohet fëmijëria ime. Vetëm se këta nuk janë këmbëzbathur. Janë të veshur mirë. Le të vijnë. Kur ecnim rrugës, dëgjova një nënë dëshmori, që e njihja, tek u thoshte vajzave tona: «Partizankat e nënës, stolitë e maleve...»

Arritëm në Sheshin e Flamurit. U mblodh populli. Përreth na vështronin njerëz të emocionuar. Partizanëve u kujtonim shtigjet e dikurshme. Nëna u kujtonim bijtë e rënë. Prandaj shkuam në marshim që kujtimet partizane të mos vdesin kurrë. Që po ta dojë Atdheu, ta mbyllim jetën si heronj. Që R.P. e Shqipërisë të mbetet për shekuj e pamposhtur.

(«Zëri i Rinisë» prill — maj 1966)

40/40

LIOTEKA T ...
...
PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Shënime për ushtar Hekuranin (K. Jakova)	3
Biri për shpirt i Tozharit (N. Nezha)	55
Tregime për heroin (L. Dibra)	63
Komunistet e reja heroike të Mirditës (P. Tase)	85
Për atë që ra në kufi (V. Koreshi)	105
Heronjtë e rinj të legjendës së lashtë (F. Kraja)	127
Marshimi i madh (V. Koreshi)	165
Në gjurmët e freskëta (I. Bregu)	217